



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 708 Akti

Nr. 740 Vendimi
Tiranë, më 8.3.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja Kryesuese
Brunilda Bekteshi Relatore
Lulzim Hamitaj Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 4.3.2024, ora 10:00 dhe në datën 6.3.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Pranvera Stafa (Selita)**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.3.2024, nga avokati F.L, me nr. licence ***.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit,

për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa (Selita), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ish-DSIK; Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa (Selita), do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Brunilda Bekteshi dhe Etleda Çiftja. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Pranvera Stafa (Selita), si dhe caktoi kryesuese të trupit gjykues komisioneren Etleda Çiftja. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, në datën 29.1.2021 ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 31.1.2024, Komisioni, me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa (Selita), për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda datës 15.2.2024 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 1.2.2024, subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën barrës së provës. Në datën 2.2.2024, subjekti u njoh dhe u pajis me kopje të dokumentacionit të dosjes. Në datën 15.2.2024, subjekti paraqiti kërkesë për shtyrje afati për dorëzimin e përgjigjeve, kërkim ky që u pranua nga trupi gjykues i Komisionit, duke caktuar afat të ri të dërgimit të tyre datën 20.2.2024. Po në këtë datë, subjekti dërgoi në rrugë elektronike dhe zyrtare shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Në datën 21.2.2024, vëzhguesi ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit paraqiti *Gjetjen* nr. ***, datë 20.2.2024, për subjektin e rivlerësimit në lidhje me procesin e rivlerësimit të saj.

9. Komisioni, në datën 22.2.2024, me vendimin nr. 3, vendosi: (i) të pranojë *Gjetjen* e vëzhguesit ndërkombëtar sipas pikës 10 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; (ii) të riçelë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa, si rrjedhojë; (a) e *Gjetjes* së përcjellë nga vëzhguesi ndërkombëtar në Komision, pas dërgimit të rezultatit të hetimit; (b) konstatimit të bërë nga Komisioni për çështjen që i përket ankesës nr. *** të vitit 2018, të shtetases N (N) D, pas njohjes me shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar prej saj në prapësime. Në datën 23.2.2024, subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me vendimin e trupit gjykues: (i) për riçeljen e hetimit, duke i komunikuar gjithashtu edhe rezultatet e hetimit shtesë, me qëllim paraqitjen e pretendimeve të saj brenda datës 27.2.2024; (ii) për njohjen me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative. Në datën 27.2.2024, subjekti dërgoi në rrugë elektronike dhe zyrtare shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ pas rihapjes së tij, të cilat u administruan në dosjen e subjektit.

10. Komisioni, në datën 28.2.2024, me vendimin nr. 4, vendosi të mbyllë hetimin administrativ, duke e ftuar subjektin e rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa (Selita), në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 28.2.2024, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 4.3.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë. Në datën 5.3.2024, subjekti u njoh me shkresën kthim përgjigjeje datë 4.3.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa (Selita), e mbajtur në datën 4.3.2024, u shty, për shkak të pranimin nga trupi gjykues të kërkesës së subjektit për t'u përfaqësuar, sipas prokurës së posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.3.2024, nga avokati F.L, me nr. licence ***. Trupi gjykues vendosi që seanca dëgjimore të mbahet në datën 6.3.2024. Seanca dëgjimore e datës 6.3.2024 me subjektin e rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa (Selita), u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs. Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi ligjor i subjektit, z. F.L, shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit përmes përfaqësuesit të saj ligjor kërkoi konfirmimin në detyrë.

12. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa (Selita). Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 6.3.2024, për të rifilluar më 8.3.2024 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Znj. Pranvera Stafa (Selita) ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas krerëve IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese¹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar nr. *** prot., datë 30.3.2018, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa (Selita), në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ku më parë subjekti, në datën 28.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë, ky institucion ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar

¹ Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

Vetting; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas mbylljes së hetimit administrativ; (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

17. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

18. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 28.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

19. Bashkëpronare në pasurinë nr. *, të llojit apartament me sip. 65 m²**, i ndodhur në lagjen “****”, Elbasan, z. k. ***, vol. ***, f. ***, pasuri e blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesa sipas kontratës së shitjes banesa nr. ***, datë 13.5.1993, në vlerën 15.750 lekë. Bashkëngjitur dokumentacioni i marrë nga ZVRPP-ja Elbasan. Pjesa takuese: 25%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente².

19.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Elbasan.*

19.2 Nga verifikimi i deklaratave të administruara në dosjen e ILDKPKI-së rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në DPV-në e vitit 2003 me të njëjtën sipërfaqe, adresë, pjesë takuese (1/4) dhe me burim krijimi ligjin për privatizimin e banesave shtetërore (viti 1992).

19.3 Nga dokumentacioni i administruar³ rezultoi se ZQRPP-ja, me shkresat nr. *** prot., datë 9.10.2017 dhe nr. *** prot., datë 31.8.2017, ka bashkëlidhur përgjigjet e ZVRPP-së Elbasan, të cilat konfirmojnë se shtetasja Pranvera Stafa figuron bashkëpronare në pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, të llojit apartament me sip. 65 m², ndodhur në lagjen “****”, Elbasan.

19.4 Sipas kontratës së shitjes së banesës nr. ***, datë 13.5.1993, me palë shitëse Ndërmarrjen Komunale Banesa dhe palë blerëse F.S (babai i subjektit të rivlerësimit dhe pjesëtarët madhorë V, I dhe Pranvera Selita), konfirmohet shitja e një banese në lagjen “****”, pallati nr. ***, apartamenti nr. ***, të përbërë 2 + 1, të cilën blerësi e zotëron në bazë të kontratës nr. *** dhe mandatarkëtimit nr. ***, kundrejt vlerës 12.600 lekë dhe 2.050 lekë trualli.

² Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.10.2016, e ZVRPP-së Elbasan, ku konfirmohet se shtetasja Pranvera Stafa figuron bashkëpronare në pasurinë nr. *** të llojit apartament me sip. 65 m², ndodhur në lagjen “****” z. k. ***, Elbasan. Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, apartament me sip. 65 m², lagjja “****”, z. k. 8521, Elbasan, regjistruar në emër të shtetasve F.S, V.S, I.S dhe Pranvera Selita. Shuma e paguar: 14.650 lekë. Kontratë shitjeje e banesës nr. ***, datë 13.5.1993, me palë shitjeje Ndërmarrja Komunale Banesa dhe palë blerëse F.S, të një banese në lagjen “****”, pallati nr. ***, apartamenti nr. ***, të përbërë 2+1, të cilën e zotëron në bazë të kontratës nr. *** dhe mandatarkëtimit nr. ***. Këtë banesë shitësi ia ka shitur blerësit F.S dhe pjesëtarëve madhorë V, I dhe Pranvera Selita kundrejt vlerës 12.600 lekë dhe 2.050 lekë trualli. Praktika për privatizimin e banesës (aneks nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së).

³Aneks nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

19.5 Sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme, kjo pasuri konfirmohet e regjistruar me të njëjtat të dhëna, nr. ***, apartament me sip. 65 m², ndodhur në lagjen “***”, z. k. ***, Elbasan, regjistruar në emër të shtetasve F.S, V.S, I.S dhe Pranvera Selita. Shuma e paguar: 14.650 lekë.

19.6 Nga verifikimi i dokumentacionit në tërësi, Komisioni konstatoi se pasuria ka si origjinë ligjin nr. 7652/1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Sipas certifikatës personale rezultoi se subjekti ka qenë madhor në kohën e privatizimit të banesës shtetërore dhe, si e tillë, ka përfituar në të në pjesë të barabarta. Mbi faktet konstatuese të dala gjatë hetimit, Komisioni nuk evidentoi problematika në lidhje me origjinën dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

20. Depozitë bankare në llogarinë nr. * pranë BKT-së Elbasan**, në emër të znj. Pranvera Stafa, në vlerën 5.246 euro, e hapur në datën 1.2.2006, e cila është shtuar në principal me vlerën 1.245 euro. Në datën 20.1.2017, vlera e depozitës është 8.250,97 euro, nga të cilat 6.492 euro principal dhe 1.759,97 euro interes bankar. Kjo depozitë është krijuar me kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës të marra ndër vite. Bashkëngjitur është edhe dokumentacioni i detajuar i lëshuar nga BKT-ja Elbasan. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴.

20.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.*

20.2 BKT-ja⁵ informon se znj. Pranvera Stafa ka depozitë pranë kësaj banke.

20.3 Komisionit, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, i rezultoi se kjo depozitë është çelur në datën 1.2.2006, me vlerë fillestare 5.246 euro. Në vite, kjo depozitë është shtuar me disa depozitime *cash*, të kryera nga bashkëshorti i subjektit, si dhe nga interesat e gjeneruar.

20.3.i Depozitimet janë kryer në datat dhe vlerat e pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

Data	Vlera në euro	Përshkrimi
31.7.2008	334	Cash deposit, shtesë B.S
30.7.2010	461	Cash deposit, shtesë dep. Pranvera Stafa, derdhur nga B.S
31.7.2013	450	Cash deposit, derdhje nga B.S
TOTAL	1,245	

20.4 Komisioni, duke konstatuar faktin se subjekti i rivlerësimit ka pasur kursime *cash*, të cilat mund të kenë shërbyer për këto depozitime, pasi burim krijimi për këtë depozitë ka deklaruar kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës të marra ndër vite, si dhe për shkak të vlerave jo shumë të larta, vlerësoi të mos kryejë analizë të veçantë për secilin depozitim.

20.5 Analiza financiare për këtë depozitë nga momenti i çeljes, viti 2006, deri në momentin e deklaramit u krye vjetore, sikurse do të arsyetohet në vijim në rezultatin final financiar.

⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga Banka Kombëtare Tregtare, ku konfirmohet se znj. Pranvera Stafa, e cila është kliente e bankës prej datës 11.6.2004, me anë të një depozitë dyemërore me z. B.S, hapur në vlerën 5.000 euro dhe shtuar në datën 1.2.2006, në vlerën 5.000 euro. Depozita totale me vlerë 10.246 euro është ndarë në dy depozita: në depozitën në emër të z. B.S, me vlerë 5.000 euro dhe në depozitën me vlerë 5.246 euro në emër të znj. Pranvera Stafa. Depozita në emër të znj. Pranvera Stafa, me vlerë 5.246 euro, është shtuar në principal me vlerën 1.245 euro dhe në datën 20.1.2017 vlera e depozitës është 8.250,97 euro, nga të cilat 6.492 euro janë principal dhe 1.759,97 euro janë interes bankar; lëvizjet bankare të depozitës në emër të B.S ose Pranvera Stafa pranë Bankës Kombëtare Tregtare, për periudhën 11.6.2004 – 1.2.2006; lëvizjet bankare të depozitës në emër të znj. Pranvera Stafa pranë Bankës Kombëtare Tregtare, për periudhën 1.2.2006 – 6.8.2015 (dokumentacion i pasqyruar në aneksin nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

20.6 Lidhur me deklarin e kësaj depozite, Komisioni gjatë hetimit konstatoi se ajo nuk ishte deklaruar nga subjekti në vitin 2006, por ishte deklaruar në DPV-në e vitit 2004, me përshkrimin “Depozitë bankare pranë BKT-së Elbasan në shumën 10.039 euro”, data e krijimit 11.6.2004.

20.6.i Komisioni i ka kërkuar⁶ subjektit të depozituar dokumentacion provues për çeljen e kësaj depozite, si dhe të deklaronte dhe dokumentonte burimin e krijimit të saj. Mbi kërkimin e Komisionit, subjekti ka sqaruar se: “*Depozita pranë BKT-së është hapur në datën 11.6.2004, në vlerën 5.000 euro. Në datën 14.6.2004, në këtë depozitë është shtuar vlera 1.000 euro. Në datën 17.11.2004 është bërë shtesë tjetër depozite në vlerën 4.000 euro dhe interesat e përfutur deri në këtë datë kanë qenë 39,62 euro*”. Subjekti ka sqaruar se në datën 17.11.2004 totali i depozitës ishte 10.039,62 euro.

20.6.ii Për të provuar çeljen e depozitës, subjekti ka depozituar kopje të librezës së BKT-së në emër të B.S ose Pranvera Stafa, me nr. depozite ***.

20.7 Lidhur me burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar se: “*Si burim për krijimin e këtyre të ardhurave kanë shërbyer:*

a) *Kursime familjare nga të ardhurat nga puna e bashkëshortit tim B.S në vitet 1984 – 1993, i cili në këtë periudhë ka punuar mësues dhe drejtor shkolle.*

b) *Kursime familjare nga të ardhurat nga puna në emigrim e bashkëshortit tim B.S në vitet 1993 – 1995, i cili në këtë periudhë ka qenë emigrant ekonomik në shtetin turk.*

c) *Kursime familjare nga të ardhurat nga puna e bashkëshortit tim B.S në vitet 1995 – 2001, i cili në këtë periudhë ka ushtruar aktivitet privat në qytetin e Elbasanit në fushën e tregtimit me shumicë dhe pakicë.*

d) *Kursime familjare nga të ardhurat nga puna e bashkëshortit tim B.S në vitet 2002 – 2004, i cili në këtë periudhë ka punuar mësues.*

e) *Kursime familjare nga të ardhurat nga puna ime si prokurore në vitet 1989 – 2004, periudhë gjatë së cilës kam ushtruar detyrën pranë Prokurorisë Elbasan.*

f) *Pension invaliditeti dhe kujdestarie për djalin R.S në vitet 1999 – 2004”.*

20.8 Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, Komisioni konstatoi se depozita e deklaruar në deklaratën *Vetting* e ka zanafillën prej vitit 2004.

20.8.i Rezultoi se në llogarinë dyemërore B.S ose Pranvera Stafa janë kryer veprimet e mëposhtme:

- në datën 11.6.2004 është depozituar shuma 5.000 euro;
- në datën 14.6.2004 është depozituar shuma 1.000 euro dhe po në këtë datë totali i shumave prej 6.000 euro (5.000 + 1.000) është investuar në depozitë;
- në datën 17.11.2004 është depozituar shuma 4.000 euro dhe po në këtë datë totali i akumuluar në llogari prej 10.039,62 euro (nga depozitimet dhe interesat) është investuar në depozitë;
- në datën 1.2.2006, shuma e akumuluar prej 10.246 euro është transferuar 5.000 euro në llogarinë e z. B.S dhe 5.246 euro në llogarinë e znj. Pranvera Stafa.

20.8.ii Meqenëse depozita e deklaruar në deklaratën *Vetting*, me datë çeljeje 1.2.2006, vjen si rezultat i transfertës nga depozita dyemërore, Komisioni vlerësoi të kryejë analizën financiare prej zanafillës së krijimit, që është viti 2004, duke analizuar fillimisht ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj.

⁶ Pyetësor nr. 3, datë 12.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

20.9 Lidhur me burimin e krijimit, që ka shërbyer për çeljen e depozitës në vitin 2004

20.9.i Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, në rubrikën e të ardhurave, se ka përfituar të ardhura nga emigracioni dhe ushtrimi i aktivitetit privat. Më konkretisht, ai ka deklaruar: “*Periudha pas datës 31.8.1993 deri në fillimviti 1995, unë kam shkuar si emigrant ekonomik në Turqi, ku kam punuar në punë të ndryshme dhe jam marrë me tregti. Fillimisht kam qëndruar në Izmir dhe më pas kam jetuar dhe punuar në Stamboll-Turqi deri në vitin 1995. Në Turqi kam udhëtuar me pasaporta të nxjerra në atë periudhë, por aktualisht nuk i disponoj më këto pasaporta për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar që nga viti 1993. Lidhur me lëvizjet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në atë kohë, për shkak emigrimi ekonomik, unë kam kërkuar konfirmim pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, pikave të kalimit kufitar Rinas dhe Qafë-Thanë, Komisarariatit të Policisë Pogradec, por përgjigjet janë negative për atë periudhë. Në vitet 1995 deri në fund të vitit 2002 kam punuar në tregti në Durrës dhe Elbasan; në Elbasan kam pasur 2 dyqane të marra me qira, ku tregtoheshin pije, artikuj ushqimorë me shumicë dhe pakicë. Kam punuar në sektorin privat, pjesërisht në informalitet, për shkak të periudhës dhe kohës për të cilën bëhet fjalë. U kam marrë dyqane me qira shtetasve D.Q dhe I.Q, dyqane të cilat ndodheshin në vendin e quajtur “***”, Elbasan. Për shkak të ndryshimeve urbanistike këto dy dyqane nuk ekzistojnë më. Kam punuar dhe bashkëpunuar gjatë aktivitetit tim tregtar me shumë firma të ndryshme apo shtetas, si firma “C. C”, E.K, Elbasan, firma “***”, Durrës, me shtetasin H.P Durrës, L.M, Rr. etj. Për të vërtetuar këtë fakt, në mungesë të dokumentacionit për aktivitetin privat për shkak të kohës së largët, nga ana jonë janë kërkuar informacione nga institucionet përkatëse, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, Zyra e QKR-së, Bashkia Elbasan, por përgjigjet janë negative për atë periudhë, nuk disponohen të dhëna. Po kështu kanë lëshuar deklarata disa nga personat me të cilët kam pasur marrëdhënie në fushën e tregtisë, në furnizimet me pije e mallra të ndryshme ushqimore. Të ardhura të krijuara në periudhën e viteve 1993 – 2002, periudhë që përfshin emigracionin ekonomik dhe aktivitetin tregtar, në kushtet e mungesës së dokumentacionit për shkak të kohës së largët, në mënyrë të përafërt janë mbi 6.000.000 lekë. Për shkak të mungesës së dokumentacionit provues, këtë shumë nuk po e vendos në kolonën përbri”.*

20.9.ii Lidhur me këtë deklaram, Komisionit nga hetimi i kryer⁷ i rezultoi se z. B.S ka qenë i regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 29.10.1997. Ai figuron si ortak në shoqërinë “I” sh.p.k., me objekt “Shitje me shumicë dhe pakicë, eksport-import etj.”.

Ky është i vetmi dokument i administruar lidhur me këtë çështje, pasi Drejtoria e Përgjithshme Tatimore nuk konfirmon asnjë të dhënë apo të ardhura të përfituara nga ky aktivitet.

20.9.iii Sa i përket të ardhurave nga emigracioni dhe aktivitetit privat të bashkëshortit të subjektit, Komisioni nuk i mori ato në konsideratë në fazën e hetimit, për shkak të mungesës së dokumentacionit provues, si dhe për faktin se ato nuk janë deklaruar në DPV-në e vitit 2003 si kursime të mundshme *cash*, me burim krijimi nga emigracioni dhe aktiviteti privat.

20.9.iv Komisioni kreu analizën financiare në datën 14.6.2004, për vlerën 6.000 euro, për shkak të kohës shumë të afërt të dy depozitimeve, konkretisht 5.000 euro në datën 11.6.2004 dhe 1.000 euro në datën 14.6.2004. Analiza financiare është kryer duke nisur nga data 1.1.2004, duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e përfituara nga punësimi gjatë kësaj periudhe për të dy bashkëshortët.

20.9.v Gjithashtu, Komisioni kreu analizën financiare edhe në datën 17.11.2004, kur është kryer depozitimi i shumës 4.000 euro. Gjatë periudhës së analizuar, 15.6.2004 – 17.11.2004,

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021, e përcjellë nga QKB-ja, administruar në dosjen e Komisionit.

bashkëshorti i subjektit ka investuar edhe në depozita të tjera, konkretisht shumën 10.000 USD në Intesa Sanpaolo Bank dhe shumën 700.000 lekë në ProCredit Bank. Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me burimin e krijimit që ka shërbyer për këto dy depozita dhe në përgjigje ajo ka deklaruar se *është i njëjti burim si ai i pasqyruar në pikën 20.7, ku të ardhurat e përfituara nga emigracioni dhe aktiviteti privat gjatë fazës së hetimit nuk janë marrë në konsideratë.*

20.9.vi Komisioni kreu analizën financiare në datat 14.6.2004 dhe 17.11.2004, pasi ka konstatuar se pas datës 17.11.2004 nuk ka pasur më depozitime, pra shtesa të depozitës. Rezultoi se depozita në llogarinë dyemërore është ndarë në vitin 2006 në dy depozita individuale, konkretisht 5.246 euro në emër të subjektit të rivlerësimit dhe 5.000 euro në emër të bashkëshortit të saj, z. B.S.

20.10 Nga faktet e analizuara më sipër dhe përlllogaritjet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të dhënë shpjegime dhe depozituar dokumentacion, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se dukej se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 347.142 lekë të çelte depozitën 6.000 euro në datën 14.6.2004, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; (ii) nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 1.795.804 lekë të shtonte depozitën në BKT, të investonte në depozita të tjera, si dhe të përballonte shpenzimet familjare për periudhën 15.6.2004 – 17.11.2004.

20.11 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit paraqiti pretendimet e saj, si në vijim:

20.11.1 Depozitën bankare pranë BKT-së Elbasan, në shumën 10.039 euro, e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2004, porse nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume. Për të deklaruar burimin e krijimit të depozitës së krijuar në BKT, sipas kronologjisë së derdhjeve të kryera në vitin 2004, konkretisht në datën 11.6.2004 është depozituar shuma 5.000 euro, në datën 14.6.2004 është depozituar shuma 1.000 euro dhe po në këtë datë totali i shumave prej 6.000 euro (5.000 + 1.000) është investuar në depozitë. Në datën 17.11.2004 është depozituar shuma 4.000 euro dhe po në këtë datë totali i akumuluar në llogari prej 10.039,62 euro (nga depozitimet dhe interesat) është investuar në depozitë. Subjekti ka sqaruar se ka paraqitur informacion shtesë në ILDKPKI për të dhënë më shumë informacion në lidhje me depozitën e krijuar. Në sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI-së, subjekti ka shpjeguar se burimi i krijimit të depozitës bankare, i deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004, kanë qenë kursimet familjare ndër vite dhe të depozituara njëherësh në bankë në vitin 2004.

20.11.2 Sipas subjektit, metodologjia e ndërtimit të analizës financiare në datën 14.6.2004, moment kur ishte depozituar shuma 6.000 euro (5.000 + 1.000), dhe në datën 17.11.2004, është bazuar vetëm në të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e kryera, duke filluar nga data 1.1.2004. Subjekti ka theksuar se Komisioni nuk ka përfshirë në analizë financiare kursimet nga paga e saj dhe e bashkëshortit përpara vitit 2004, me argumentin se nuk është deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit 2003.

20.11.3 Për deklaratimet e saj për gjendjen *cash*, subjekti pranon pasaktësinë e mosdeklarimit të kursimeve *cash* në deklaratën e interesave privatë të vitit 2003, për rrjedhojë edhe në vitin 2004, duke pohuar se ky mosdeklarim ka ardhur si rrjedhojë e deklarimit për herë të parë, mungesës së informacionit, eksperiencës dhe trajnimit që duhet të ishte bërë, për të bërë të mundur plotësimin me saktësi të deklaratave periodike.

20.11.4 Për këtë mosdeklarim, subjekti ka parashtruar se ajo ka depozituar pranë ILDKPKI-së deklaratë sqaruese në vitin 2004, përmes së cilës ka korrigjuar burimin e krijimit dhe rrjedhimisht

edhe deklaratën e interesave privatë të vitit 2003, e cila ka vlerën e provës dhe sipas jurisprudencës së Kolegjit⁸ duhet të konsiderohet si pasaktësi e korigjuar. Për këtë arsye, subjekti ka kërkuar që Komisioni të shtrijë analizën financiare për burimin e krijimeve edhe në vitet e mëparshme, kryesisht në periudhën 2001 – 2003. Subjekti ka deklaruar se të ardhurat e krijuara në periudhën 1.1.2004 – 17.11.2004 janë gjithsej në shumën 1.255.930 lekë (678.403 lekë + 577.527 lekë), ndërsa depozita 10.000 euro ekuivalentuar në lekë është në shumën 1.267.400 lekë. Sipas subjektit, fakti se për këtë depozitë kursimi shërbyen si burim krijimi kursimet nga të ardhurat, tregon se të ardhurat kanë qenë disa herë më të larta se vlera e depozitës, ku pasi janë zbritur shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera të kryera kanë mbetur kursimet, të cilat u depozituan në bankë.

20.11.5 Subjekti ka kërkuar që Komisioni analizën financiare për burimin e krijimeve duhet ta shtrijë kryesisht në periudhën 2001, nga ku rezulton se ajo dhe familja e saj ka pasur mundësi financiare për të përballuar me të ardhura të ligjshme krijimin e depozitës në shumën 10.000 euro pranë BKT-së, duke kërkuar që në këtë analizë të përllogariten:

- të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit për vitet 2001 – 2003;
- të ardhurat e pensionit të invaliditetit për djalin e ndjerë vetëm për vitin 2001, pasi sipas subjektit të ardhurat e përfituara në vitet 2002 e 2003 janë ruajtur që, së bashku me kursimet e saj dhe të bashkëshortit, i ka depozituar në bankë në vitin 2005;
- për dy shumat e derdhura pranë Intesa Sanpaolo Bank në vlerën 10.000 USD dhe pranë ProCredit Bank në vlerën 700.000 lekë, subjekti ka pretenduar se ato kanë si burim krijimi të ardhurat nga puna e bashkëshortit në emigrim, si dhe të ardhurat nga puna nga aktiviteti privat, kohë përpara se të rikthehej arsimtar, dhe se është në kushtet e pamundësisë objektive për t'i provuar, sipas pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.

20.11.6 Sipas subjektit, duhet vlerësuar fakti që bashkëshorti i saj për periudhën që deklaroi ka qenë i regjistruar për ushtrim aktiviteti privat, si dhe ka përfutur të ardhura nga ky aktivitet dhe se të ardhurat nga emigracioni dhe aktiviteti privat, po t'u shtohen të ardhurave të tjera, provojnë tej çdo dyshimi se burimi i të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e depozitave në vitin 2004 është tërësisht i justifikuar. Për të vlerësuar pamundësinë për të siguruar dokumentacion, subjekti gjithashtu parashtron se duhen mbajtur në konsideratë: lëvizjet migratore pas vitit 1990, informaliteti i ekonomisë shqiptare në këto vite; të ardhurat nga jashtë shtetit në nivele të larta, të pashoqëruara me burime legale të pagesës nga punëdhënësit dhe të pataksuara në Shqipëri; ballafaqimi me konceptin e taksimit mbi të ardhurat në një mënyrë të plotë vetëm pas miratimit të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998; deklarata e integruar e të ardhurave personale, e zbatuar vetëm pas vitit 2012; licencimi i së parës bankë të nivelit të dytë në vitin 1999; pagesat e pagave nëpërmjet sistemit bankar vetëm pas vitit 2002.

20.11.7 Në seancën dëgjimore⁹ lidhur me këtë çështje, përfaqësuesi ligjor i subjektit parashtrori se veç rrethanave që kanë parashtruar për të ardhurat nga emigrimi apo veprimtaria e subjektit privat, dokumentacioni nga institucionet përkatëse për periudhën 1.9.1989 – 31.12.2004 pasqyron që vetëm subjekti i rivlerësimit nga paga e saj ka përfutur të ardhura në vlerën 4.963.626 lekë. Sipas përfaqësuesit ligjor, duke e ndarë këtë të ardhur vetëm të subjektit të rivlerësimit, dhe duke përcaktuar një koeficient në raportin 30% apo 50 %, sipas praktikës që ka mbajtur Komisioni dhe Kolegji, për sa i përket llogaritjeve të të ardhurave dhe shpenzimeve, pa përfshirë këtu të ardhurat e pjesëtarëve të tjerë, diferenca negative që rezulton në vitin 2004 është tërësisht e justifikuar. Sipas tij, pasaktësia në deklarimin e viteve 2003 e 2004, është e shëruar me korigjimin e

⁸ Vendimi nr. 37/2021; vendimi nr. 33/2021; vendimi nr. 35/2022.

⁹ Referojuni procesverbalit të seancës dëgjimore.

deklaratave, ku me të ardhurat e dokumentuara për vitet 1989 – 2004, subjekti ka pasur burim të ardhurash për të justifikuar vlerën e depozitave të vendosura në vitin 2004.

20.11.8 Lidhur me qartësimin e periudhës për të cilën kërkohet të kryhet analiza financiare, përfaqësuesi ligjor parashtrori se në analizën e tyre i janë referuar viteve 2001 – 2016, për shkak sepse në çmuarjen e tyre dhe në analizën që bën eksperti i fushës këto të ardhura janë të mjaftueshme për të mbuluar atë diferencë të konstatuar nga Komisioni në vitin 2004. Në kuadrin e një vlerësimi objektiv, për sa kohë Komisioni nuk vlerëson për shkak të paprovueshmërisë të ardhurat nga emigracioni apo nga veprimtaria tregtare, por me dokumentacionin e sjellë nga institucioni provohet që të ardhurat nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me bashkëshortin e saj, janë të matshme e të prekshme dhe kjo e bën më të besueshëm subjektin e rivlerësimit, që duke iu shtuar kësaj analize financiare që kanë parashtruar nga viti 2001 deri në vitin 2016, edhe këto të ardhura të mëparshme me atë nivel që ka qenë për kohën ku pagat kanë qenë më të ulëta, familja e subjektit ka pasur mundësi kursimi me burime të justifikuara në vitin 2004.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

20.12 Trupi gjykues, në analizë të fakteve të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti në prapësime lidhur me këtë çështje, arsyeton si vijon:

20.12.1 Lidhur me pretendimin e subjektit se mosdeklarimi i gjendjes *cash* në DPV-në e vitit 2003, apo edhe në fund të vitit 2004, është pasaktësi, trupi gjykues evidenton faktin se ligji nr. 9049/2003 ka parashikuar detyrim të qartë për subjektet deklaruese, përfshirë subjektin e rivlerësimit, për të pasqyruar çdo ndryshim të gjendjes *cash*¹⁰ në çdo deklaram periodik, në gjendjen që ishte në 31 dhjetor të vitit të mëparshëm. Referuar këtij parashikimi, trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit vetëm për pasaktësi të saj në këtë deklaram duhet të vlerësohen në rrethanat konkrete të çështjes dhe në raport me nivelin e provueshmërisë së krijimit të këtyre likuiditeteve.

20.12.2 Lidhur me depozitën në shumën 10.000 euro pranë BKT-së, trupi gjykues, duke konstatuar se kjo depozitë është deklaruar në deklaratën periodike vjetore, për të cilën subjekti ka depozituar dokumentin deklaratë sqaruese në vitin 2004 pranë ILDKPKI-së, për të qartësuar burimin e krijimit të saj të deklaruar “kursime ndër vite”, vlerësoi të çmojë pretendimin e subjektit për pasaktësi të gjendjes *cash* në raport me mundësinë e kursimit dhe ligjshmërisë së tyre, duke përfshirë në këtë mënyrë në analizën financiare për periudhën 2001 – 2003 të gjitha të ardhurat e siguruara nga familja me burime të ligjshme, për të parë kështu mundësinë e kursimit të tyre.

20.12.3 Trupi gjykues çmon se në situatën faktike të kësaj çështjeje nuk mund të merret në konsideratë pretendimi i subjektit që në analizën financiare për periudhën 2001 – 2003 të mos përfshijë të ardhurat e djalit nga pensioni i invaliditetit për vitet 2002 e 2003, me pretendimin se subjekti i ka ruajtur ato duke i depozituar në bankë në vitin 2005 së bashku me kursimet e tjera, pasi ky kërkim duket si përpjekje e subjektit për të rregulluar situatën financiare, e cila nuk përputhet me deklaramet e saj për gjendjen *cash*. Gjithashtu, trupi gjykues vërejt se edhe nëse do të merret në konsideratë ky pretendim atëherë nga përlogaritjet financiare konstatohet se përmirësohet gjendja financiare e vitit 2005, ku subjekti ka rezultuar me balancë negative në shumën 327.113 lekë, porse do të passjellë efekt negativ në vitin 2004, duke krijuar pamundësi financiare në kursimin e depozitës 10.000 euro në BKT.

20.12.4 Lidhur me pretendimin e subjektit për mospërfshirje në analizë financiare të shumave të derdhura në vitin 2004 pranë Intesa Sanpaolo Bank në vlerën 10.000 USD dhe pranë ProCredit

¹⁰ Neni 4 parashikon: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

Bank në vlerën 700.000 lekë, pasi burimi i tyre i krijimit kanë qenë të ardhurat nga puna e bashkëshortit në emigrim, si dhe të ardhurat nga puna nga aktiviteti privat, për të cilat subjekti pretendon se gjendet në pamundësi objektive, trupi gjykues çmon të mos e pranojë pretendimin e subjektit, pasi në këtë çështje konstaton problematika si më poshtë arsyetuar:

➤ Në drejtim të deklarimit, ku përgjatë hetimit ka rezultuar se:

- i) këto shuma nuk janë deklaruar në deklaratën periodike të kohës të vitit 2004;
- ii) nuk është qartësuar burimi i tyre kur subjekti ka depozituar në ILDKPKI informacion shtesë/deklaratë sqaruese;
- iii) nuk janë deklaruar kursimet *cash* në vitin 2003.

➤ Në drejtim të provueshmërisë së vlerës së përfituar dhe ligjshmërisë së të ardhurave të pretenduara prej emigracionit dhe aktivitetit privat të bashkëshortit të saj rezultoi se subjekti nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive sipas pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me provueshmërinë e këtyre të ardhura, trupi gjykues konstatoi se:

20.13 Sa i takon të ardhurave të përfituara nga emigracioni rezulton se si gjatë hetimit, ashtu edhe në prapësime, subjekti nuk ka depozituar prova për përfitimin e tyre në vitet 1993 – 1995. Trupi gjykues çmon se ndërtimi i një analize financiare për periudhën 1999 – 2003 apo 2001 – 2003, sikurse pretendon subjekti, nuk impaktohet nga provueshmëria e të ardhurave nga emigracioni.

20.14 Lidhur me të ardhurat e pretenduara të përfituara nga aktiviteti tregtar i ushtruar nga bashkëshorti i subjektit për vitet 1995 – 2001, rezulton se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion për të provuar të ardhurat e përfituara. Po ashtu, Komisionit gjatë hetimit nuk i janë konfirmuar nga Drejtoria Tatimore deklarime të kryera nga bashkëshorti i subjektit për aktivitetin e tij privat apo bilance të depozituara, për më tepër që aktiviteti tregtar ka qenë i regjistruar në formën juridike “sh.p.k.”. Në këtë drejtim evidentohet fakti se subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se bashkëshorti i saj ka punuar në sektorin privat, pjesërisht në informalitet, për shkak të periudhës dhe kohës për të cilën bëhet fjalë.

20.15 Komisioni konstaton se edhe pse rezulton se bashkëshorti i subjektit ka qenë i regjistruar për ushtrim aktiviteti privat, subjekti nuk provoi vlerën e përfituar ndër vite si rezultat i ushtrimit të aktivitetit privat. Gjithashtu as Drejtoria e Tatimeve nuk konfirmoi të ardhura nga ky aktivitet, të cilat duken se rezultojnë të përfituara në informalitet.

20.16 Lidhur me pamundësinë objektive të provueshmërisë së këtyre të ardhurave, trupi gjykues, referuar rrethanave konkrete të çështjes, por edhe jurisprudencës së Kolegjit¹¹, çmon se subjekti nuk gjendet në këtë situatë, për sa kohë është pranuar edhe nga vetë ajo që aktiviteti tregtar i bashkëshortit është ushtruar pjesërisht në mënyrë informale. Trupi gjykues çmon se nuk jemi në kushtet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi bashkëshorti i subjektit, edhe pse i regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), nuk rezulton të ketë kryer deklarime mbi aktivitetin e

¹¹ Vendimi nr. 39, datë 25.9.2023, pika 9.2: “Për sa kohë, si organet tatimore, ashtu dhe subjekti i rivlerësimit nuk kanë sjellë prova ligjore për të provuar një pjesë të qirave për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, ligjshmëria e tyre mbetet e paprovuar. Mungesa e të dhënave në sistemin elektronik nuk mund të konsiderohet si një situatë e parashikuar nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë DRT-ja nuk përcakton ndonjë nga situatat që shkaktojnë pamundësi objektive për të gjetur pagesat”. Rrjedhimisht, edhe për shkak të kësaj analize, krahas asaj që lidhet me dijeninë/ndërgjegjësimin për mospagimin e detyrimeve tatimore, subjekti gjendet në kushtet kur nuk arriti të vërtetojë se dokumentacioni mbi ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga qiraja është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër ligjore; si dhe në pikën 19.5. të këtij vendimi, ku Kolegji arsyeton: “Trupi gjykues e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e subjektit se Komisioni në mënyrë të padrejtë ka refuzuar kërkesën e saj për ta vlerësuar atë në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, pasi nëse tatimet do të ishin paguar rregullisht për të ardhurat e gjeneruara nga qiradhënia e pasurive të prindërve, nga sistemi tatimor do të disponoheshin të dhëna të cilat do të reflektoheshin në shkresat kthim përgjigjeje të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës”.

tij pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe, për rrjedhojë, ky institucion nuk mund të gjenerojë të dhëna apo t'i gjurmtojë ato në sistem, ose minimalisht të konfirmojë fitim nga ky aktivitet.

20.17 Në këtë drejtim, trupi gjykues nuk konstaton as ndërmarrjen e veprimeve të deklarimit të tyre pranë administratës tatimore, në raport me arsyet që subjekti ka paraqitur për të provuar pamundësinë objektive, që sipas saj ishin edhe arsyet se ballafaqimi me konceptin e taksimit mbi të ardhurat në një mënyrë të plotë, bërë vetëm pas miratimit të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, si dhe deklarata individuale vjetore e të ardhurave është zbatuar vetëm pas vitit 2012.

20.18 Sipas vlerësimeve të mësipërme, Komisioni kreu analizën financiare lidhur me verifikimin e mundësive financiare për periudhën 2001 – 2003, ku pas përllogaritjeve konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kursejë shumën 1.007.452 lekë. Këtë shumë Komisioni e ka mbartur në analizën e kryer në datat 14.6.2004 dhe 17.11.2004.

Nr.	Përshkrimi	2001 – 2003	14.6.2004	17.11.2004
1	TË ARDHURA	2,486,092	1,685,855	1,237,837
	Të ardhura nga paga, subjekti	1,746,050	486,473	405,394
	Të ardhura nga paga, bashkëshorti	350,000	112,730	93,942
	Të ardhura nga pensioni i invaliditetit (PAK), djali	390,042	79,200	66,000
	Të ardhura nga interesat		-	12,192
	Të ardhura nga periudha e mëparshme		1,007,452	660,310
2	SHPENZIME	1,478,640	215,105	195,550
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	1,478,640	215,105	195,550
3	PASURI	-	810,440	2,177,852
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme			
	Apartament 2 + 1, sip. 66 m ² , Elbasan (1/4) (3.3.2004)		50,000	-
	BKT (5,000 + 1,000)		760,440	
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>		-	2,177,852
	DIFERENCA (1-2-3)	1,007,452	660,310	-1,135,564

20.19 Për sa më sipër analizuar/vlerësuar, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit: (i) ka pasur mundësi financiare të çelë depozitën 6.000 euro në datën 14.6.2004, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare; (ii) nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 1.135.564 lekë të investojë në depozitat, përkatësisht në shumën 10.000 USD të derdhur pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe në shumën 700.000 lekë të derdhur në ProCredit Bank, si dhe të përballojë shpenzimet familjare për periudhën 15.6.2004 – 17.11.2004.

Në funksion të një qasje garantiste Komisioni kreu përllogaritjet edhe për periudhën 1999-2003, sipas pretendimit të subjektit në seancë dëgjimore, dhe konstatoi se edhe sipas këtij varianti, subjekti gjendet në pamundësi financiare në shumën 903.600 lekë, të investoj në depozitat respektive pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe ProCredit Bank⁸, si dhe të përballojë shpenzimet familjare për periudhën 15.06.2004 -17.11.2004.

Në këtë çështje objekt vlerësimi, trupi gjykues konstatoi se subjekti ka pretenduar edhe që analiza financiare të shtrihet sipas dokumentacionit provues të depozituar prej saj për të gjithë të ardhurat e përfituara, nga data 01.09.1989-31.12.2004. Në vlerësim të trupit gjykues, edhe nëse merret në konsideratë ky pretendim i subjektit, analiza do të shtrihet për periudhën 1994-2003, pasi të ardhurat e përfituara për periudhën 1989-1993¹² janë në një masë të tillë që nuk mund të krijojnë

¹² Referuar vendimit të KPA-së nr.15, datë 18.06.2022.

kursime. Nga analiza financiare e kryer, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet nga viti 1994-2003, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj gjenden sërish në balancë negative.

20.20 Në përfundim, trupi gjykues, pas vlerësimit të situatës faktike në raport me pretendimet e subjektit, çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja të ligjit nr. 84/2016, çmuarje e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesin e rivlerësimit në tërësi.

21. Kartë krediti “Prima Gold” nr. * pranë BKT-së, në emër të znj. Pranvera Stafa, në vlerën 150.000 lekë**

21.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.*

21.2 BKT-ja¹³ informon se znj. Pranvera Stafa ka kartë krediti pranë kësaj banke, me limit 150.000 lekë, duke konstatuar kështu faktin e përputhshmërisë së deklarimit të subjektit me përgjigjen e ardhur nga kjo bankë.

Në analizë të të dhënave të përfituara, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

22. Gjendje e llogarisë rrjedhëse pranë Credins Bank në datën 24.1.2017, në vlerën 0 (zero) lekë

22.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga Credins Bank.*

22.2 Credins Bank¹⁴ informon se znj. Pranvera Stafa ka llogari pranë kësaj banke, në të cilën i kreditohet paga. Gjendja e llogarisë në datën 28.1.2017 është 0 (zero) lekë. Në analizë të të dhënave të përfituara, Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga Credins Bank.

23. Kursime familjare, gjendje cash, ku përfshihen kursimet familjare dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit me targë *. Vlera totale: 750.000 lekë.**

23.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Të ardhurat e realizuara justifikojnë gjendjen cash të deklaruar.*

23.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet e saj familjare në deklaratat periodike vjetore prej vitit 2006 e në vazhdim. Komisioni e ka pyetur¹⁵ subjektin lidhur me gjendjen cash në fund të çdo viti, nga ku ajo ka dhënë sqarimet përkatëse.

23.2.i Duke ndjekur logjikën e subjektit duket se në deklarime i referohet gjendjes në fund të çdo viti kalendarik, duke eliminuar termin *shtesë* për vitet 2007 dhe 2008.

23.3 Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur deklaratimet periodike të subjektit, deklarimi gjatë hetimit, si dhe vlerësimi i Komisionit mbi gjendjen cash në fund të çdo viti.

23.4 Komisioni në analizë të deklarimeve të subjektit ka vlerësuar që në vitet ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “kursime familjare”, ajo shumë është konsideruar gjendje në fund të vitit. Në vitet që ka deklaruar “kursime familjare shtesë”, ajo shumë i është shtuar kursimeve të vitit të

¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 1.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Me pyetësin nr. 3, datë 12.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

mëparshëm. Ndërsa në vitin që nuk ka pasur deklaram gjendja e kursimeve *cash* është marrë 0 (zero).

Viti	Përshkrimi sipas subjektit në deklaratat periodike	Vlera e deklaruar në DPV	Shuma në 31 dhjetor deklaruar në pyetësor	Shuma e akumuluar sipas Komisionit
2006	Kursime familjare	700,000	700,000	700,000
2007	Kursime familjare shtesë	200,000	200,000	900,000
2008	Kursime familjare shtesë	575,000	575,000	1,475,000
2009	Kursime familjare	450,000	450,000	450,000
2010	Kursime familjare	200,000	200,000	200,000
2011	Kursime familjare	600,000	600,000	600,000
2012	Kursime familjare	600,000	600,000	600,000
2013	Nuk ka deklaram		Nuk kemi pasur gjendje <i>cash</i>	-
2014	Kursime familjare	400,000	400,000	400,000
2015	Kursime familjare	300,000	300,000	300,000
2016	Kursime familjare gjendje <i>cash</i> , ku përfshihen kursimet familjare dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit me targë ***	750,000	750,000	750,000

23.5 Ndërsa lidhur me të ardhurat nga shitja e automjetit me targë ***, DPSHTRR-ja¹⁶ informon se me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2016, shtetasi B.S (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) i ka shitur shtetasit I.S automjetin tip “Seat Alhambra”, me targë ***, në çmimin 400.000 lekë. Ky mjet është blerë në datën 19.6.2007 me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., me palë shitëse shtetasin P.A.A dhe palë blerëse B.H.S, në vlerën 7.700 euro.

Për sa kohë që këto të ardhura burojnë nga një kontratë e rregullt shitblerjeje automjeti, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë.

23.6 Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2016, vit në të cilin janë krijuar kursimet, si dhe është shitur automjeti. Nga përlllogaritjet e kryera prej Njësisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare të kursejë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit

24. Pronar i pasurisë nr. * e llojit apartament me sip. 66 m², ndodhur në lagjen “****”, z. k. ***, Elbasan, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 3.3.2004.** Kjo pasuri është përfituar fillimisht sipas kontratës së shitjes banesa nr. ***, datë 27.8.1993, ku shitës është Ndërmarrja Komonale Banesa Elbasan. Pasuria është blerë në shumën 15.705 lekë dhe ka qenë me 4 bashkëpronarë, H.S, A.S, B.S dhe E.S. Me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.2.2004, shtetasit H.S, A.S, B.S dhe E.S ia kanë shitur pjesët e tyre shtetasit B.S kundrejt vlerës 50.000 lekë, duke u bërë ky i fundit pronar i vetëm i kësaj pasurie. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹⁷.

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.10.2016, nga ZVRPP-ja Elbasan, ku konfirmohet se shtetasi B.S figuron pronar i pasurisë nr. ***, e llojit apartament me sip. 66 m², ndodhur në lagjen “****”, z. k. ***, Elbasan, aneks nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së; kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, apartament me sip. 66 m², lagjja “****”, z. k. ***, Elbasan, regjistruar në emër të shtetasve H.S, A.S, B.S dhe E.S. Shuma e paguar: 17.575 lekë. Në seksionin e përshkrimit të veçantë evidentohet rivlerësimi i pasurisë në shumën 2.263.061 lekë; kontratë shitjeje banesa nr. ***, datë 27.8.1993, me palë shitëse Ndërmarrja Komonale Banesa dhe palë blerëse H.S, të një banese në lagjen “****”, pallati nr. ***, apartamenti nr. ***, të përbërë 2+1, të cilën e zotëron në bazë

24.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Elbasan.*

Hetimi i Komisionit

24.2 Nga verifikimi i deklaratave të administruara në dosjen e ILDKPKI-së rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në DPV-në e vitit 2003 në emër të bashkëshortit të saj, me të njëjtën sipërfaqe, adresë, pjesë takuese (1/4) dhe me burim krijim ligjin për privatizimin e banesave shtetërore (viti 1992).

24.3 Në deklaratën për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar lidhjen me bashkëshortin e saj, si dhe pasurinë e regjistruar në emër të tij (në rubrikën përkatëse të kësaj deklarate, të titulluar “Pjesëtarë të familjes me pasuri të regjistruar në emrin e vet”). Subjekti në këtë deklaratë ka deklaruar pasurinë apartament në emër të bashkëshortit të saj, me vlerë 50.000 lekë, në të njëjtën adresë sikurse ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në pjesë takuese 100%.

24.4 Sipas praktikës së përcjellë nga ASHK/Drejtoria Vendore Elbasan¹⁸, konfirmohet se shtetas B.S është pronar në pasurinë nr. ***, z. k. ***, lloji apartament me sip. 66 m², ndodhur në lagjen “****”, Elbasan.

24.5 Sipas kontratës së shitjes¹⁹ nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.2.2004, me palë shitëse H.S, A.S e E.S dhe palë blerëse B.S, të një apartamenti me nr. pasurie ***, me adresë në lagjen “****”, pallati nr. ***, rezultoi se shitësit i kanë shitur pjesën e tyre prej ¾ të pasurisë blerësit të vetëm B.S kundrejt vlerës 50.000 lekë, shlyer totalisht jashtë zyrës noteriale.

24.6 Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore, më konkretisht sipas regjistrimit nr. ***, datë 3.3.2004, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasit B.S pasuria nr. ***, një hyrje (2+1), pallati nr. ***, me sip. 68 m², në adresën lagjja “****”. Praktika ka të bashkëlidhur edhe hartën treguese të regjistrimit, nga verifikimi i së cilës konfirmohet e njëjta pasuri.

24.7 Sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 27.8.1993, me palë shitjeje Ndërmarrja Komunale Banesa, rezultoi se pala blerëse H.S ka blerë një banesë në lagjen “****”, pallati nr. ***, apartamenti nr. ***, të përbërë 2+1, të cilën e zotëronte në bazë të kontratës nr. *** dhe mandatarkëtimit nr. ***.

24.8 Po sipas kësaj kontrate rezultoi se këtë banesë shitësi ia ka shitur blerësit H.S, me pjesëtarë madhorë A.S, B.S dhe E.S kundrejt vlerës 14.060 lekë dhe 1.605 lekë trualli.

24.9 Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore, konkretisht regjistrimit nr. ***, datë 27.8.1993, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasve H.S, A.S, B.S e E.S pasuria nr. ***, një hyrje (2+1), pallati nr. ***, me sip. 68 m², në adresën lagjja “****”.

24.10 Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me përfitimin e kësaj pasurie.

të kontratës nr. *** dhe mandatarkëtimit nr. ***. Këtë banesë shitësi ia ka shitur blerësit H.S me pjesëtarë madhorë A.S, B.S dhe E.S kundrejt vlerës 14.060 lekë dhe 1.605 lekë trualli; praktika për privatizimin e banesës; kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.2.2004, me palë shitëse H.S, H.S e E.S dhe palë blerëse B.S, të një apartamenti me nr. pasurie ***, me adresë në lagjen “****”, pallati nr. ***. Shitësit i shesin pjesën e tyre prej ¾ të pasurisë blerësit të vetëm B.S kundrejt vlerës prej 50.000 lekësh, shlyer totalisht jashtë zyrës noteriale; vërtetim nga dokumentet hipotekore, ku sipas regjistrimit nr. ***, datë 3.3.2004, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasit B.S pasuria nr. ***, një hyrje (2+1), pallati nr. ***, me sip. 68 m², në adresën lagjja “****”; harta treguese e regjistrimit; kërkesë për informacion drejtuar ZVRPP-së Elbasan. Dokumentacion i pasqyruar në aneksin nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁸ Nr. *** prot., datë 14.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit, por edhe nga praktika e administruar në dosjen e ILDKPKI-së (aneks nr. 28), ku ZQRPP-ja, me shkresat nr. *** prot., datë 9.10.2017 dhe nr. *** prot., datë 31.8.2017, ka bashkëlidhur përgjigjet e ZVRPP-së Elbasan.

¹⁹ Administruar po në këtë praktikë.

25. Depozitë bankare në llogarinë nr. * pranë BKT-së Elbasan, në emër të shtetasit B.S,** hapur në datën 1.2.2006, në vlerën 5.000 euro. Depozita është shtuar në principal në vlerën 1.511 euro. **Gjendja e depozitës në datën 20.1.2017 është 8.251,49 euro,** nga të cilat 6.511 euro principal dhe 1.740,49 euro interes bankar. Kjo depozitë është krijuar me kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës së marra ndër vite. Bashkëngjitur është edhe dokumentacioni i detajuar i lëshuar nga BKT-ja Elbasan. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁰.

25.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarami i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.*

25.2 BKT-ja²¹ informon se shtetasi B.S ka depozitë pranë kësaj banke.

25.3 Komisionit nga verifikimi i dokumentacionit të administruar i rezultoi se kjo depozitë është çelur në datën 1.2.2006, me vlerë fillestare 5.000 euro. Në vite, kjo depozitë është shtuar me disa depozitime *cash*, të kryera nga bashkëshorti i subjektit, si dhe nga interesat e gjeneruara.

25.3.i Depozitimet janë kryer si më poshtë referuar:

Data	Vlera në euro	Përshkrimi
31.7.2008	600	Cash deposit, shtesë B.S
30.7.2010	461	Cash deposit, shtesë B.S
31.7.2013	450	Cash deposit, derdhje nga B.S
TOTAL	1,511	

25.4 Komisioni e ka trajtuar këtë depozitë, zanafillën e saj, burimin e krijimit dhe mundësinë financiare të krijimit të saj, në deklarinë e subjektit, përshkruar në pikën 20 e në vijim të këtij vendimi. Edhe kjo depozitë është krijuar me kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës. Për shkak se pasqyrohen të njëjtat fakte dhe konkludime, Komisioni vlerëson të mos bjerë në përsëritje.

26. Depozitë bankare në llogarinë nr. * në BKT-në Elbasan, në emër të shtetasve B.S dhe I.S.** Depozita është hapur në datën 7.1.2011 në emër të B.S ose I.S në vlerën 50.000 lekë dhe është shtuar në principal në vlerën 275.000 lekë. Gjendja e depozitës bankare në datën 20.1.2017 është 366.938,07 lekë, nga të cilat 325.000 lekë janë principal dhe 41.938,07 lekë interes.

Shtesë depozite bankare në interesa në llogarinë nr. *** në BKT-në Elbasan në emër të shtetasve B.S dhe I.S deri në datën 20.1.2017. Kjo depozitë është krijuar me kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës së marra ndër vite. Bashkëngjitur është edhe dokumentacioni i detajuar i lëshuar nga BKT-ja Elbasan. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²².

26.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarami i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.*

²⁰ Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së/vërtetim nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga Banka Kombëtare Tregtare, ku konfirmohet se shtetasi B.S është klient i bankës prej datës 1.2.2006, me depozitë në vlerën 5.000 euro. Depozita është shtuar në principal në vlerën 1.511 euro. Vlera e depozitës është 8.251,49 euro, nga të cilat 6.511 euro janë principal dhe 1.740,49 euro janë interes bankar. Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së. Lëvizjet bankare të depozitës në emër të shtetasit B.S pranë Bankës Kombëtare Tregtare, për periudhën 1.2.2006 – 2.8.2013.

²¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

²² Vërtetim nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga Banka Kombëtare Tregtare, ku konfirmohet se shtetasja I.S është kliente e bankës prej datës 7.1.2011, me depozitë në vlerën 50.000 lekë dhe është shtuar në principal në vlerën 275.000 lekë. Vlera e depozitës në datën 20.1.2017 është 366.938,07 euro, nga të cilat 325.000 lekë janë principal dhe 41.938,07 lekë interes. Lëvizjet bankare të depozitës në emër të B ose I.S pranë Bankës Kombëtare Tregtare, për periudhën 7.1.2011 – 12.1.2015. Kontrata e rinovimit të depozitës I.S, datë 12.1.2017. Aneks nr. 4/2 dhe nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

26.2 BKT-ja²³ informon se shtetasi B.S ka depozitë dyemërore me shtetasen I.S (vajza) pranë kësaj banke.

26.3 Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se në datën 7.1.2011 është kryer depozitimi i shumës 50.000 lekë, e cila është investuar në depozitë në datën 10.1.2011. Në vite ajo është shtuar për shkak të depozitimeve, si dhe interesave të përfituar.

26.3.i Depozitimet ndër vite janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Data	Vlera në ALL	Përshkrimi
7.1.2011	50,000	Çelje TIM DEP nga B.S
28.6.2011	50,000	Cash deposit, derdhje në TIM DEP 12M nga B.S
6.1.2012	50,000	Cash deposit, shtesë dep. B.S
10.1.2013	100,000	Cash deposit, derdhje në TIM DEP nga B.S
10.1.2014	25,000	Transfertë B.H.S kaluar në TIM DEP te B ose I.S
12.1.2015	50,000	Cash deposit, B.S
TOTAL	325,000	

26.4 Komisioni kreu analizën financiare vjetore për këtë depozitë nga momenti i çeljes, viti 2011, deri në momentin e deklarimit dhe nuk i rezultuan problematika.

27. Depozitë bankare në llogarinë nr. * në BKT-në Elbasan, në emër të shtetasve B.S dhe E.S.** Depozita është hapur në datën 7.1.2011 në emër të B.S ose E.S në vlerën 50.000 lekë dhe është shtuar në principal në vlerën 275.000 lekë. Gjendja e depozitës bankare në datën 20.1.2017 është 366.938,07 lekë, nga të cilat 325.000 lekë janë principal dhe 41.938,07 lekë interes.

Shtesë depozite bankare në interesa në llogarinë nr. *** në BKT-në Elbasan në emër të shtetasve B.S dhe E.S deri në datën 20.1.2017. Kjo depozitë është krijuar me kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës të marra ndër vite. Bashkëngjitur është edhe dokumentacioni i detajuar i lëshuar nga BKT-ja Elbasan. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁴.

27.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.*

27.2 BKT-ja²⁵ informon se shtetasi B.S ka depozitë dyemërore me shtetasin E.S (djali) pranë kësaj banke.

27.3 Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se në datën 7.1.2011 është kryer depozitimi i shumës 50.000 lekë, e cila është investuar në depozitë në datën 10.1.2011. Në vite ajo është shtuar për shkak të depozitimeve, si dhe interesave të përfituar.

27.3.i Depozitimet ndër vite janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Data	Vlera në ALL	Përshkrimi
7.1.2011	50,000	Çelje TIM DEP nga B.S
28.6.2011	50,000	Cash deposit, derdhje në TIM DEP 12M nga B.S
6.1.2012	50,000	Cash deposit, shtesë dep B.S

²³ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁴ Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së, ku janë administruar: vërtetimi nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga Banka Kombëtare Tregtare, ku konfirmohet se shtetasi E.S është klient i bankës prej datës 7.1.2011, me depozitë në vlerën 50.000 lekë dhe është shtuar në principal në vlerën 275.000 lekë. Vlera e depozitës në datën 20.1.2017 është 366.938,07 euro, nga të cilat 325.000 lekë janë principal dhe 41.938,07 lekë janë interes/aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së; lëvizjet bankare të depozitës në emër të B ose E.S pranë Bankës Kombëtare Tregtare, për periudhën 7.1.2011 – 12.1.2015; kontrata e rinovimit të depozitës E.S, datë 12.1.2017.

²⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

10.1.2013	100,000	Cash deposit, derdhje në TIM DEP nga B.S
10.1.2014	25,000	Transfertë B.H.S kaluar në TIM DEP te B ose I.S
12.1.2015	50,000	Cash deposit, B.S
TOTAL	325,000	

27.4 Komisioni kreu analizën financiare vjetore për këtë depozitë nga momenti i çeljes, viti 2011, deri në momentin e deklarimit dhe nuk i rezultuan problematika.

28. Depozitë bankare në llogarinë nr. * ALL në FiBank, në emër të shtetasit B.S, në shumën 2.000.000 lekë,** hapur në datën 13.8.2015, me afat depozite 24 muaj, me përqindje interesi 3.5 në bazë vjetore. Kjo depozitë është krijuar me kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës të marra ndër vite. Subjekti ka sqaruar se fillimisht kjo depozitë është hapur në Alpha Bank në vitin 2005, në shumën 600.000 lekë, me nr. llogarie ***. Në vitet 2007 - 2008 - 2009 ka pasur vetëm shtesa në interesa bankarë, në shumat respektive 50.236 lekë, 49.764 lekë dhe 41.161 lekë. Në vitin 2010 është bërë shtesë depozite në shumën 240.000 lekë dhe shtesa në interesa ka qenë 19.185 lekë. Në vitin 2011 është bërë shtesë depozite në shumën 39.000 lekë dhe shtesa në interesa ka qenë 61.200 lekë. Në vitin 2012 shtesa në interesa ka qenë 64.634 lekë dhe në datën 25.7.2012 është bërë mbyllja e kësaj depozite. Në datën 25.7.2012 është hapur depozite tek FiBank, me nr. llogarie ***, në shumën 1.200.000 lekë, nga të cilat 1.163.000 lekë vinin nga depozita e mbyllur në Alpha Bank dhe është bërë shtesë depozite në vlerën 37.000 lekë. Në vitin 2013 është bërë shtesë depozite në vlerën 220.000 lekë dhe shtesa në interesa ka qenë në vlerën 79.943 lekë. Në vitin 2014 është bërë shtesë depozite në vlerën 216.300 lekë dhe ka pasur shtesë në interesa në vlerën 83.710,09 lekë. Në vitin 2015 është bërë shtesë depozite në vlerën 156.500 lekë dhe shtesa në interesa ka qenë në vlerën 43.409 lekë. Në vitin 2016 është marrë interesi në vlerën 59.300 lekë. Bashkëngjitur dokumentacioni përkatës që disponojnë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁶.

28.1 FiBank²⁷ informon se shtetasi B.S ka depozitë pranë kësaj banke me vlerë 2.000.000 lekë, në datën 28.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*.

28.2 Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se kjo depozitë është çelur në datën 25.7.2012, me vlerë fillestare 1.200.000 lekë. Në vite ajo është shtuar për shkak të depozitimeve, si dhe interesave të përfituar.

28.2.i Depozitimet janë kryer sipas datave të mëposhtme:

Data	Vlera në ALL	Përshkrimi
25.7.2012	1,200,000	Derdhje në llogari për hapje depozite
25.7.2013	300,000	Derdhje në llogari
13.8.2014	216,300	Shtim në depozitë
13.8.2015	156,500	Derdhje në llogari

²⁶ Aneks nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së, ku janë administruar: lëvizjet bankare të llogarisë në emër të shtetasit B.S pranë First Investment Bank; mandatet e depozitimit pranë FiBank për komisionet e nxjerrjes së *statement*-it; vërtetimet nga Alpha Bank për B.S, lidhur me vlerën e likuiditeteve që ka disponuar pranë bankës ndër vite; lëvizjet e depozitës në FiBank në emër të shtetasit B.S gjatë periudhës 3.1.2012 – 31.12.2013, si dhe lëvizjet e depozitës për periudhën 3.1.2013 – 13.8.2014; lëvizjet e llogarisë në FiBank në emër të shtetasit B.S gjatë periudhës 3.1.2015 – 31.12.2015, shoqëruar me mandatet bankare, ku evidentohet depozitimi *cash* i shumës 156.500 lekë në depozitë; kalimi i depozitës ekzistuese në shumën 1.843.419 lekë në depozitë të re dyvjeçare, me vlerë 2.000.000 lekë, tërheqja *cash* e interesave bankare në shumën 59.300 lekë, si dhe kërkesa për mbylljen e llogarisë; kontratë për çelje depozite me afat 24 muaj.

²⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

28.3 Në DPV-në e vitit 2012, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar mbylljen e depozitës në Alpha Bank dhe hapjen e depozitës në FiBank në vlerën 1.200.000 lekë.

28.4 Lidhur me historikun e kësaj depozite në Alpha Bank dhe transferimin e saj në FiBank

28.4.i Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2005 librezë kursimi në Alpha Bank, në shumën 600.000 lekë.

28.4.ii Ish-Alpha Bank, sot OTP, ka informuar²⁸ se shtetasi B.S ka çelur në datën 15.7.2005 depozitë me afat në vlerën 600.000 lekë. Kjo depozitë është shtuar për shkak të depozitimeve, si dhe interesave të përfituar.

28.4.iii Depozitimet janë kryer sipas datave të mëposhtme dhe në datën 25.7.2012 është tërhequr i gjithë fondi. Po në këtë datë është depozituar në FiBank shuma 1.200.000 lekë, që korrespondon me deklarinimin e subjektit, i cili pas tërheqjes së shumës 1.163.000 lekë nga Alpha Bank ka shtuar edhe 37.000 lekë dhe ka hapur depozitën në FiBank.

Data	Vlera në ALL	Përshkrimi
15.7.2005	600,000	Depozitë me afat
21.7.2010	240,000	Cash deposit, derdhje nga B.S
21.7.2011	39,000	Cash deposit, derdhur nga B.S në llog.
25.7.2012	- 1,163,000	Tërheqje nga B.S

28.4.iv Komisioni e ka pyetur²⁹ subjektin e rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit të shumës 600.000 lekë, të depozituar në Alpha Bank në datën 15.7.2005. Subjekti ka deklaruar se: *“Burim për çeljen e kësaj libeze janë të ardhurat nga puna të B.S, Pranvera Stafa dhe pensioni i invaliditetit për R.S”*.

28.5 Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2005 – 15.7.2005, kur është çelur depozita, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara dhe pas përllogaritjeve të kryera dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 327.113 lekë të investojë në depozitë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës.

28.6 Komisioni nuk ka kryer një analizë të detajuar për çdo depozitim, pasi në momentin që janë kryer ato subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kanë pasur gjendje *cash* nga viti i mëparshëm në shuma të mjaftueshme për të mbuluar depozitimet e kryera. Komisioni kreu analizën vjetore për këtë depozitë në Alpha Bank nga momenti i çeljes deri në vitin 2012, si dhe nga transferimi i saj në FiBank dhe deri në momentin e deklarinimit, sikurse trajtohet në vijim në rubrikën “Rezultati i analizës financiare”.

28.7 Mbi konstatimin e Komisionit për pamundësinë financiare për të investuar në këtë depozitë, në qëndrimin e saj subjekti ka pranuar pasaktësinë në mosdeklarimin e gjendjes *cash* në vitin 2003 dhe në fund të vitit 2004, por kjo pasaktësi sipas subjektit ka ardhur nga padijenja për deklarim, ndaj dhe në atë periudhë ka dërguar letrën sqaruese pranë ILDKPKI-së për deklaratën e interesave privatë periodikë për vitin 2004 dhe gjatë vitit 2005 shprehet se i ka kërkuar bashkëshortit të depozitonte edhe kursimet e djalit, duke qenë transparent për të gjitha kursimet e tyre, të cilat kanë pasur pasaktësi në deklarim gjatë kësaj periudhe.

²⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁹ Pyetësor nr. 3, datë 12.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

28.8 Sipas subjektit, nëse bëhet një përlllogaritje e thjeshtë matematikore, referuar të ardhurave dhe shpenzimeve nga data 1.1.2005 deri më 15.7.2005, do të rezultoni: (a) të ardhura paga e subjektit të rivlerësimit 553.746 lekë + paga e bashkëshortit B.S 161.286 lekë + pension invaliditeti 95.200 lekë + interesa 36.516 lekë = gjithsej 846.388 lekë; (b) shpenzime jetese 319.541 lekë + depozitë bankare 600.000 lekë = gjithsej 919.541 lekë; (c) diferenca të ardhura 846.388 – shpenzime 919.541 = -73.154 lekë. Kjo diferencë minimale në vlerën -73.154 lekë është e papërfillshme.

28.9 Subjekti ka pretenduar që në analizën financiare të kryer nga Komisioni në datën 15.7.2005 duhet të përfshihen kursimet e ruajtura nga pensioni i invaliditetit të djalit, për periudhën nga viti 2002 e në vijim.

28.10 Komisioni ka arsyetuar më sipër në pikën 20.14 lidhur me mosmarrjen në konsideratë si gjendje *cash* të ardhurat e pensionit të invaliditetit të djalit të saj, për faktin se ato nuk janë deklaruar si të tilla dhe, për rrjedhojë, rezultati financiar negativ në shumën 327.113 lekë nuk ndryshon, duke e vendosur subjektin në kushtet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, çmuarje e cila po ashtu është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit në tërësi.

29. Depozitë bankare në llogarinë nr. * tek Union Bank, në emër të shtetasit B.S, në shumën 14.103,17 euro**, me datë fillimi 26.10.2016, depozitë me afat 14-mujor. Kjo depozitë është krijuar me kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës të marra ndër vite. Subjekti ka sqaruar se fillimisht kjo depozitë është hapur në datën 10.12.2007 me nr. llogarie *** dhe principal 125.000 lekë në emër të shtetasve B.S dhe R.S. Në vitin 2008 është bërë shtesë depozite në shumën 225.000 lekë. Në vitin 2009 ka pasur shtesë në interesa në shumën 24.885 lekë. Në datën 6.10.2009 është mbyllur llogaria nr. ***, gjithsej në shumën 374.885 lekë, dhe në datën 7.10.2009 është hapur depozitë e re në emër të shtetasve B.S dhe R.S po në Union Bank, në vlerën 6.000 euro (3.000 euro të konvertuara nga depozita në lekë 374.885 lekë dhe shtuar depozita në vlerën 3.000 euro). Në vitin 2010 në këtë depozitë është bërë shtesë depozite në vlerën 2.746 euro dhe është marrë interes në shumën 253,8 euro.

Në vitin 2011, në këtë depozitë është bërë shtesë depozite në vlerën 522,58 euro dhe shtesa në interesa ka qenë 477,42 euro. Në vitin 2012 në këtë depozitë është bërë shtesë depozite në vlerën 595,60 euro dhe është marrë interes në shumën 404,40 lekë. Në vitin 2013 depozita kalon vetëm në emër të shtetasit B.S. Këtë vit në këtë depozitë është marrë interes në vlerën 199,36 euro dhe është bërë shtesë depozite në vlerën 800,65 euro. Në vitin 2014 në këtë depozitë është marrë interes në shumën 499,71 euro dhe është bërë shtesë depozite në vlerën 500,29 euro. Në vitin 2016 është bërë shtesë depozite në vlerën 1.000 euro dhe vlera e depozitës aktualisht është 14.103,17 euro. Shuma e interesit për vitin 2016 në këtë depozitë është 103,17 euro. Interesat e marrë ndër vite në këtë depozitë janë investuar po në këtë depozitë. Bashkëngjitur dokumentacioni përkatës që disponojnë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁰.

³⁰ Aneks nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së/kontrata e hapjes së depozitës me afat në emër të shtetasit B.S në Union Bank, datë 26.10.2017, në shumën 14.103,17 euro, me afat 1 vit e 3 muaj, shoqëruar me lëvizjet e llogarisë gjatë periudhës 26.10.2016 – 20.1.2017. Lëvizjet e llogarisë në emër të shtetasve B.S dhe R.S në Union Bank gjatë periudhës 1.10.2006 – 17.10.2016, ku evidentohet çelja fillestare e depozitës në datën 10.9.2007, në shumën 50.000 lekë. Në datën 7.10.2009 është tërhequr shuma 374.865 lekë. Kontrata e hapjes së depozitës me afat në emër të B.S – R.S në Union Bank, datë 10.6.2008, në shumën 350.000 lekë, afat 1 vit, shoqëruar me lëvizjet e llogarisë gjatë periudhës 1.1.2010 – 31.12.2010. Lëvizjet e depozitave në emër të shtetasve B.S dhe R.S në Union Bank, me gjendje të depozituar ndër vite: në datën 16.3.2010, në shumën 6.000 euro; në datën 18.8.2010, në shumën 9.000 euro; në datën 20.10.2011, në shumën 10.000 euro; në datën 19.12.2012, në shumën 11.000 euro; në datën 25.7.2013, në shumën 12.000 euro; në datën 25.9.2014, në shumën 13.000 euro; në datën 24.3.2015, në shumën 15.009 euro. Lëvizjet e llogarisë në emër të shtetasit B.S gjatë periudhës 25.7.2013 – 27.8.2015. Në datën 27.8.2015 debitohet llogaria në shumën 13.000 euro për hapje depozite me afat.

29.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Union Bank.*

29.2 Union Bank³¹ informon se shtetasi B.S ka depozitë pranë kësaj banke me vlerë 14.103,17 euro, në datën 28.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*.

29.3 Nga analizimi i *statement*-it rezulton se kjo depozitë është çelur në datën 25.7.2013, në vlerën fillestare 12.000 euro. Kjo shumë vjen si rezultat i transfertës së brendshme mes llogarive, konkretisht llogaria në emër të shtetasve B dhe R.S po në Union Bank për kalimin e shumës 11.199,35 euro në datën 25.7.2013 dhe depozitimim e shumës 800,65 euro nga shtetasi B.S.

29.4 Nga momenti i çeljes kjo depozitë është shtuar si rezultat i dy depozitimeve të kryera në vitet 2014 dhe 2016, si dhe interesave të përfituar. Depozitimet e kryera janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Emri i llogarimbajtësit	Data	Vlera	Monedha	Përshkrimi
B	25.7.2013	11,199.35	EUR	Transfertë e brendshme B.S
B	25.7.2013	800.65	EUR	Depozitim në <i>cash</i> B.S
B	25.9.2014	600	EUR	B.S derdhje
B	26.10.2016	1,000	EUR	B.S derdhje

29.5 Komisioni nuk ka kryer një analizë të veçantë për secilin depozitim, jo vetëm për shkak të vlerave të ulëta, por edhe për faktin se subjekti i rivlerësimit ka pasur kursime *cash*, të cilat mund të kenë shërbyer për këto depozitime, pasi burim krijimi për këtë depozitë ka deklaruar kursime familjare dhe interesat e vetë depozitës të marra ndër vite.

29.6 Nga analiza financiare për këtë depozitë nga momenti i çeljes, viti 2013, deri në momentin e deklarimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika.

29.7 Lidhur me historikun/zanafillën e kësaj depozite

29.7.i Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2007 depozitën bankare tek Union Bank, në vlerën 125.000 lekë, të hapur në datën 10.12.2007 në emër të B.S – R.S.

29.7.ii Union Bank ka informuar³² se B.S – R.S kanë çelur në datën 10.9.2007 depozitë me afat 3 muaj, me vlerë fillestare 50.000 lekë. Më pas, në datën 10.12.2007 është çelur depozitë me afat në vlerën 125.000 lekë, e cila korrespondon edhe me deklarimin periodik të kryer.

29.7.iii Kjo depozitë pas shtesave për shkak të depozitimeve, si dhe interesave të përfituar ka arritur në vlerën 374.865,97 lekë, e cila është tërhequr në datën 7.10.2009, si më poshtë pasqyruar:

Emri llogarisë	Data	Vlera	Monedha	Përshkrimi
B.S ose R.S	10.9.2007	50,000	ALL	Depozitim në <i>cash</i> B.S, derdhje dep. 3-mujore
B.S ose R.S	10.12.2007	74,522.39	ALL	Depozitim në <i>cash</i> B.S, derdhje dep. 3-mujore
B.S ose R.S	10.3.2008	75,000	ALL	Depozitim në <i>cash</i> B.S, derdhje
B.S ose R.S	10.6.2008	60,000	ALL	Depozitim në <i>cash</i> B.S, derdhje
B.S ose R.S	6.10.2008	83,584	ALL	Depozitim në <i>cash</i> B.S, derdhje

³¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

³² Me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

B.S ose R.S	7.10.2009	-374,865.97	ALL	Tërheqje në cash B.S tërheqje, mbyllje depozite 12-mujore
-------------	-----------	-------------	-----	---

29.8 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2009 mbylljen e kësaj depozite në emër të B.S – R.S në monedhën lekë, duke e tërhequr të gjithë shumën dhe hapjen e një depozite të re në Union Bank po në emër të B.S – R.S, në monedhën euro, në vlerën 6.000 euro. Depozita në vlerën 6.000 euro është çelur në datën 7.10.2009.

29.8.i Komisioni e ka pyetur³³ subjektin lidhur me burimin e krijimit të depozitës në vlerën 6.000 euro. Në përgjigje, subjekti ka sqaruar se: “...vlera 6.000 euro është bashkim i shumës 374.865,97 lekë, të cilat bashkëshorti im i ka kthyer në monedhën euro jashtë dyerve të Union Bank dhe më pas ka shtuar diferencën e mbetur në euro, duke krijuar shumën totale 6.000 euro dhe duke bërë derdhjen në bankë.

Lidhur me këtë depozitë sqaroj se nga ana jonë është shtuar vetëm diferenca, pasi shuma 374.865,97 lekë ka qenë në llogarinë ekzistuese, që është mbyllur në datën 7.10.2009. Burimi i krijimit të kësaj llogarie kanë qenë kursimet familjare të vitit paraardhës (viti 2008), si dhe të ardhura nga paga ime, e bashkëshortit, si dhe pensioni i invaliditetit i djalit”.

29.9 Komisioni kreu analizën financiare në datën 7.10.2009, kohë kur është çelur depozita në vlerën 6.000 euro dhe nuk i rezultuan problematika.

29.10 Pas çeljes së depozitës 6.000 euro në emër të B.S – R.S, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer depozitime të tjera në këtë llogari, si më poshtë pasqyruar, deri në momentin e mbylljes së saj në vitin 2013.

Emri i llogarisë	Data	Vlera	Monedha	Përshkrimi
B.S ose R.S	7.10.2009	6,000	EUR	Depozitim në cash B.S, derdhje
B.S ose R.S	18.8.2010	9,000	EUR	Depozitim në cash B.S, derdhje
B.S ose R.S	7.10.2010	-6,253.80	EUR	Tërheqje në cash B.S, tërheqje, mbyllje depozite
B.S ose R.S	20.10.2011			
B.S ose R.S	1	522.58	EUR	Depozitim në cash B.S, derdhje
B.S ose R.S	19.12.2011			
B.S ose R.S	2	595.60	EUR	Depozitim në cash B.S, derdhje
B.S ose R.S	25.7.2013	-11,199.35	EUR	Transferti e brendshme B.S, kalim fondi Në CADEP me 1 emër për hapje dep. me afat ***

29.11 Nga analizimi i depozitimeve të kryera rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar në datën 18.8.2010 shumën 9.000 euro, e cila po në këtë datë është investuar në depozitë. Vihet re që kjo është një shumë e re, pasi depozita prej 6.000 euro ishte ende në llogari. Ajo është tërhequr në datën 7.10.2010, pasi është maturuar.

29.11.i Komisioni e ka pyetur³⁴ subjektin për burimin e krijimit të shumës 9.000 euro, e cila në përgjigje ka sqaruar se: “Në datën 18.8.2010 është çelur llogaria në vlerën 9.000 euro, ku si burim të ardhurash kanë qenë shuma 6.000 euro kursime të prindërve të bashkëshortit B.S dhe 3.000 euro të ardhura nga paga ime, të bashkëshortit dhe pensioni i invaliditetit të djalit R.S. U përdorën kursimet e prindërve të bashkëshortit për të hapur këtë depozitë, pasi afati i maturimit të depozitës të vitit 2009 prej 6.000 euro ishte në tetor të vitit 2010. Në momentin që është mbyllur depozita në shumën 6.000 euro, vlera u është kthyer prindërve të bashkëshortit. Dokumentacion provues nuk disponoj, pasi kanë qenë marrëdhënie shumë të ngushta, prind-fëmijë. Kjo shumë është marrë për përdorim vetëm për pak muaj. Qëllimi i hapjes së kësaj llogarie ishte me idenë e përdorimit të

³³ Pyetësor nr. 3, datë 12.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁴ Pyetësor nr. 3, datë 12.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

kësaj depozite si garanci për lëvizje jashtë shtetit, pasi problemet familjare shëndetësore të pjesëtarëve të familjes i kisha të tilla, pavarësisht se nuk u realizuan”.

29.11.ii Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2010 mbylljen e depozitës bankare tek Union Bank në emër të B.S – R.S, duke tërhequr në datën 6.10.2010 të gjithë shumën 6.000 euro së bashku me interesin e përfituar prej 253,8 euro dhe hapjen e një depozite të re po në Union Bank në emër të B.S – R.S, në monedhën euro, në datën 18.8.2010, në shumën 9.000 euro. Për hapjen e kësaj depozite nuk rezulton që ai të ketë deklaruar burimin e krijimit të kësaj shumë, sikurse ka deklaruar subjekti në pyetësorin nr. 3, ku konkretisht ka deklaruar se 3.000 euro janë nga kursimet familjare dhe 6.000 euro hua e përkohshme nga prindërit e bashkëshortit. Këtë deklaram lidhur me huan e përkohshme, subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi ta ketë konfirmuar në pyetësorin nr. 1, konkretisht në pyetjen nr. 19.

29.11.iii Nga hetimi i kryer, Komisionit i ka rezultuar³⁵ se prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë qenë në pension, konkretisht nëna e tij prej muajit maj 1991, me masë aktuale 16.219 lekë dhe babai i tij prej muajit shkurt 1992, me masë aktuale 17.367 lekë. Vlera aktuale e pensionit të të dy prindërve të bashkëshortit të subjektit duket se është në një masë që nuk arrin të mbulojë shpenzimet e jetesës. Ndërkohë, vlera e pensionit mujor në vitet e mëparshme duket të ketë qenë edhe më e ulët për shkak të ndryshimeve ligjore të masës së saj ndër vite, edhe pse Komisioni nuk i ka të konfirmuara vlerat e sakta të përfituara për secilin vit kalendarik.

29.12 Komisioni kreu analizën financiare për depozitimin e shumës 9.000 euro, datë 18.8.2010, duke mos e marrë në konsideratë deklarin e subjektit se 6.000 euro kanë qenë kursime të prindërve të bashkëshortit, pasi subjekti nuk ka depozituar dokumentacion për të provuar burimin e krijimit prej prindërve të tij.

29.12.i Në analizën financiare të kryer është përfshirë edhe gjendja *cash* deri në datën 18.8.2010, në vlerën 125.000 lekë³⁶. Meqenëse subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon për vitin 2010 shumën 200.000 lekë *cash*, ajo është ndarë në mënyrë të barabartë për secilin muaj nga Komisioni, në pamundësi për të përcaktuar vlerën e saktë.

29.13 Mbi faktet e dala gjatë hetimit dhe pas përllogaritjeve të kryera, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës, pasi konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 921.236 lekë të investojë në depozitën 9.000 euro, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare; (ii) ka mungesë dokumentacioni për krijimin e të ardhurave të prindërve të bashkëshortit të subjektit për të provuar huan 6.000 euro; (iii) ka kryer deklarin të pasaktë, pasi nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2010 burimin e krijimit të depozitës 9.000 euro.

29.14 Në qëndrimin e saj, subjekti ka parashtruar se kjo balancë negative është rrjedhojë e mospërfshirjes së shumës 6.000 euro, e cila është përdorur për pak kohë dhe i është kthyer prindërve të bashkëshortit. Sipas subjektit, duke qenë se kjo hua nuk ka qenë e pashlyer në fund të vitit 2010, nuk është deklaruar si burim, bashkëshorti ka deklaruar burimin përfundimtar që shërbeu për krijimin e depozitës 9.000 euro. Subjekti ka depozituar deklaratë noteriale të vitit 2024, të motrës së bashkëshortit, e cila deklaron se ka dijani për këtë hua.

29.15 Sipas subjektit, prindërit e bashkëshortit përveç të ardhurave që kanë pasur nga pensioni dhe puna private e ushtruar prej tyre kanë përfituar shuma monetare edhe nga bashkëshorti i subjektit

³⁵ Shkresat nr. *** prot., datë 17.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 10.8.2023, nga ISSH-ja.

³⁶ 200.000 lekë ÷ 12 muaj x 7.5 muaj.

të rivlerësimit nga të ardhurat e përfituara në emigrim dhe nga ushtrimi i aktivitetit privat tregtar, po kështu edhe nga vajza që jetonte së bashku me prindërit dhe punonte mësuese.

29.16 Subjekti pretendon se në analizën financiare të kryer nga Komisioni përveç shumës 6.000 euro të marrë hua që duhet të përfshihet në analizë duhet të mos merret në konsideratë gjendja *cash* në datën 18.8.2010, në shumën 125.000 lekë, me argumentin se gjendja *cash* krijohet proporcionalisht gjatë vitit. Në pretendimin e subjektit, nuk qëndron vlerësimi i Komisionit se gjendja *cash* krijohet në mënyrë proporcionale, pasi mund të ndodhë që gjendja *cash* të krijohet edhe ditët e fundit të vitit, duke tërhequr shuma monetare nga banka. Sipas subjektit, përfshirja në analizë e gjendjes *cash* në shumën 125.000 lekë është rast që përputhet me qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit në vendimin nr. 37/2021, se pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

29.17 Trupi gjykues, në analizë të fakteve të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti në prapësime lidhur me këtë çështje, arsyeton si vijon:

29.18 Në lidhje me pretendimin e subjektit se në kursimet e prindërve të bashkëshortit si burim i krijimit të huas duhet të përfshihen të ardhurat në emigrim dhe nga paga e shtetases E.S (kunata) si mësuese, si dhe të ardhurat që bashkëshorti i saj kishte dorëzuar në familje gjatë kohës që ishte në emigrim dhe ushtronte aktivitet privat tregtar, trupi gjykues çmon se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, për arsye se:

i. Gjatë hetimit, lidhur me burimin e krijimit të kësaj huaje, subjekti ka deklaruar se janë përdorur kursimet e prindërve të bashkëshortit dhe për këtë nuk depozitoi dokumentacion justifikues. Ndërsa në prapësime, veç këtij deklarimi, subjekti ka pretenduar edhe të ardhura të tjera për çdo anëtar të familjes së bashkëshortit, por pa u shoqëruar me dokumentacion justifikues, pretendim i mbetur vetëm në nivel deklarativ. Trupi gjykues në këtë çështje objekt vlerësimi evidenton faktin se përgjatë procesit u provuan vetëm të ardhurat nga pensionet e prindërve të bashkëshortit, për të cilat Komisioni konstatoi se vlera e tyre në periudhat përkatëse rezultonte në masën që nuk arrin të mbulojë shpenzimet e jetesës.

29.19 Lidhur me pretendimin e subjektit se bashkëshorti i saj kishte dorëzuar të ardhura në familje gjatë kohës që ishte në emigrim dhe ushtronte aktivitet privat tregtar, trupi gjykues çmon se për sa kohë të ardhurat nga aktiviteti tregtar nuk janë marrë në konsideratë, pasi nuk u provua përmbushja e kriterëve ligjorë të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 (arsyetuar më sipër në këtë vendim), ky pretendim nuk qëndron dhe, për rrjedhojë, nuk merret në konsideratë.

29.20 Lidhur me pretendimin e subjektit se gjendja *cash* nuk mund të ndahet në mënyrë të barabartë, trupi gjykues, duke qenë para rrethanës ku as vetë Komisioni nuk mund të saktësojë se sa ka qenë vlera e kursyer në datën që kryhet analiza, kundrejt një standardi garantist, çmon ta marrë në konsideratë këtë pretendim të saj. Në këtë çështje objekt analize, Trupi gjykues, nisur nga deklarimi i subjektit se për vitin 2010 dispononte 200.000 lekë *cash*, verifikoi nëse pas muajit gusht subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kishin mundësi ta krijonin këtë shumë. Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare për periudhën gusht – dhjetor 2010, nga ku rezultoi se subjekti ka pasur mundësi ta krijojë gjendjen *cash* të deklaruar.

29.21 Në përfundim, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu përlllogaritjet, siç pasqyrohen në tabelën e mëposhtme, nga ku rezultoi se përsëri subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi financiare në

shumën 796.236 lekë për të investuar në depozitën 9.000 euro, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

Nr.	Përshkrimi	18.8.2010
1	TË ARDHURA	1,449,479
	Të ardhura nga paga, subjekti	640,211
	Të ardhura nga paga, bashkëshorti	329,753
	Të ardhura nga pensioni i invaliditetit (PAK), djali	271,200
	Të ardhura nga interesat	208,315
2	SHPENZIME	487,326
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	455,400
	Shpenzime TIMS	31,926
3	PASURI	1,758,389
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	1,758,389
	DIFERENCA (1-2-3)	-796,236

29.22 Në përfundim, trupi gjykues, pas vlerësimit të situatës faktike, në raport me pretendimet e subjektit, çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenit 33, pika 5, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016, çmuarje e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit në tërësi.

30. Automjet tip “Volkswagen Sharan” me nr. shasie ***, me targë ***, në emër të shtetasit R.B.S, blerë sipas kontratës së shitjes datë 15.5.2015. Vlera e automjetit: 900 euro. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁷.

30.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.*

Hetimi i Komisionit

30.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit u konstatua se ky automjet është deklaruar për herë të parë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në DPV-në e vitit 2015, në emër të djalit R.S, me përshkrimin “Automjet, marka “VW Sharan” me nr. shasie ***, me targë ***. Çmimi i blerjes 900 euro”.

30.3 Nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR-në³⁸, kjo e fundit ka informuar se shtetasi R.S ka të regjistruar në pronësi të tij mjetin me targë ***.

30.3.i Nga dokumentacioni i përcjellë nga ky institucion konfirmohet se mjeti me targë *** është blerë në shtetin italian në datën 15.5.2015 nga pala shitëse C.L dhe blerës R.S, në vlerën 900 euro. Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti rezulton se zhdoganimi për mjetin me targë *** është kryer në datën 27.6.2015 dhe është paguar TVSH në doganë në vlerën 132.810 lekë. Më pas mjeti ka marrë targën ***.

³⁷ Fatura e blerjes së automjetit tip “Volkswagen Sharan”, në datën 15.5.2015, në shtetin italian, me palë shitëse C.L dhe blerës R.S, në vlerën 900 euro, përkthyer nga gjuha italiane; praktika e plotë e dokumentacionit ligjor të automjetit në pronësi të shtetasit C.L dhe zhdoganimi në tij në Shqipëri datë 15.5.2015; certifikata e pronësisë së mjetit rrugor tip “Volkswagen Sharan” me targë ***, në pronësi të shtetasit R.S. Aneks nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

30.3.ii Subjekti i rivlerësimit ka lëshuar prokurën e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015, e cila emëron si përfaqësues të saj bashkëshortin B.S, ku i jep tagër të plotë për blerjen e automjetit jashtë Shqipërisë.

30.4 Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton që bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë në datën 13.5.2015 nga pika kufitare e Portit të Durrësit dhe ka hyrë në datën 16.5.2015 me mjetin me targë ***.

30.5 Komisioni e ka pyetur³⁹ subjektin lidhur me burimin e krijimit që ka shërbyer për blerjen e mjetit, pasi nuk rezultonte që të ishte deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në atë periodike. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje ka deklaruar se: “Në datën 15.5.2015, në Bari, Itali, bashkëshorti im ka blerë nga shtetasi L.C automjet autoveturë, marka “VW Sharan”, me çmimin 900 euro. Sqaroj se burimi i krijimit të vlerës 900 euro, që ka shërbyer për blerjen e këtij automjeti, është nga kursimet familjare të miat, të bashkëshortit, si dhe nga të ardhurat që merrte djali im si pension invaliditeti i grupit të parë paraplegjik - tetraplegjik. Për vitin 2015 ne kemi pasur kursime familjare të mbartura nga viti paraardhës, që kanë shërbyer për këtë shpenzim”.

30.6 Komisioni nuk e ka kryer analizën financiare në datën 15.5.2015, kur dhe është investuar për këtë automjet, pasi subjekti i rivlerësimit ka pasur kursime *cash* në fund të vitit 2014 shumën 400.000 lekë, e cila është më se e mjaftueshme për blerjen e mjetit në vlerën 900 euro ose 123.885 lekë.

30.6.i Komisioni ka kryer analizën vjetore edhe për vitin 2015, kur është investuar në blerjen e këtij mjeti, dhe nuk i kanë rezultuar problematika, pasi ky vit ka rezultuar me balancë pozitive.

31. Shitur automjeti me targë ***, sipas kontratës së shitjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2016, në vlerën 400.000 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2016⁴⁰.

31.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.*

Hetimi i Komisionit

31.2 Në DPV-në e vitit 2016, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit” shitjen e automjetit me targë ***, në vlerën 400.000 lekë. Të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij mjeti janë deklaruar gjithashtu edhe si kursime në *cash*, të cilat Komisioni i ka trajtuar më sipër në këtë vendim.

31.3 Komisioni vlerësoi të analizojë aftësinë paguese të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për blerjen e këtij automjeti, që më pas u shit në vlerën 400.000 lekë.

31.3.i Nga verifikimi i deklaratave periodike rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka deklaruar blerjen e mjetit në DPV-në e vitit 2007, me përshkrimin “Automjet monovolum tip “Seat Alhambra”, 4+1, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.6.2007, në Durrës, në vlerën 7.700 euro (me shkrim monedha pasqyrohet e shkruar në lekë), me burim krijimi kursimet familjare, në pjesë zotëruese 50%”.

31.4 Nga korrespondenca e Komisionit me DPSHTRR-në, kjo e fundit informon⁴¹ se shtetasi B.S ka pasur të regjistruar në pronësi të tij mjetin me targë *** (***)⁴². Kjo drejtori ka vendosur në

³⁹ Me pyetësin nr. 3, datë 12.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁰ Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴² Ndryshuar targa dhe marrë targë të re.

dispozicion dosjen e plotë të mjetit, ku konstatohet se ai është blerë nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.6.2007, me palë shitëse shtetasin P.A.A dhe palë blerëse B.H.S, në vlerën 7.700 euro.

31.5 Komisioni kreu analizën financiare në datën e blerjes së mjetit, 19.6.2007, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara.

31.5.i Për vitin 2007, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se ka përfituar të ardhura nga lojërat e fatit në shumën 400.000 lekë. Komisioni e ka pyetur⁴³ subjektin për këto të ardhura, ligjshmërinë e tyre, si dhe të depozitonte dokumentacion justifikues. Në përgjigje, subjekti ka sqaruar se: *“Lidhur me të ardhurat e krijuara nga lojërat e fatit, nuk është ruajtur mandati i përfitimit të kësaj shume, pasi kanë kaluar 15 vjet dhe nuk e kemi menduar se do të na duhej, pasi shuma e përfituar nuk ishte e madhe. Për shkak të mbylljes së aktivitetit të lojërave të fatit me ligj, nuk ekziston as qendra ku organizohej ky aktivitet për të marrë të dhëna apo dokumentacion. Sqaroj se bashkëshorti im ka luajtur lojëra fati të kategorisë baste sportive (parashikim ndeshje futbollit). Subjekti ka referuar nenin 10⁴⁴ të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000, “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar ndër vite”.*

Subjekti ka sqaruar se: *“Referuar dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi për lojërat e fatit të tipit baste sportive, praktika e ndjekur ka qenë që në momentin kur parashikimi i bastit sportiv ishte i saktë dhe gjendej rezultati i ndeshjes, dorëzohej bileta fituese tek organizatori dhe në këmbim merrej pagesa për parashikimin. Ky parashikim ishte i shënuar paraprakisht në biletë. Biletat fituese nuk i disponojmë.*

Referuar tatimit në burim, subjekti ka sqaruar se tatimi paguhej nga ana e organizatorit të basteve sportive në përputhje me dispozitat në fuqi të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet” dhe ligjit nr. 8438, datë 25.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

31.5.ii Komisioni nuk i mori në konsideratë këto të ardhura gjatë fazës së hetimit, pasi ato mbetën në nivel deklarativ dhe nuk provohej me dokumentacion vlere të përfituar dhe koha kur janë disponuar. Për sa i takon zbatueshmërisë së ligjit nr. 8438, datë 25.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në nenin 8 të tij përcaktohen të ardhurat e tatueshme dhe konkretisht të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë përfshihen në të ardhurat e tatueshme.

31.5.iii Lidhur me likuiditetet, në analizën financiare është përfshirë gjendja *cash* deri në datën 19.6.2007, e përlloritur në vlerën 412.500 lekë⁴⁵. Meqenëse nga akumulimi i gjendjes *cash* për vitin 2007 subjekti i rivlerësimit disponon shumën 900.000 lekë *cash*, është vlerësuar ndarja e saj në mënyrë të barabartë për secilin muaj, në pamundësi të Komisionit për të përcaktuar vlerën e saktë.

31.6 Nga faktet e analizuara më sipër dhe përlloraritjet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të

⁴³ Pyetësor nr. 3, datë 12.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁴ “1. Tatimfitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 25.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. 2. Të ardhurat, që përfitohen nga lojtarët apo fituesit, që marrin pjesë në lojërat e fatit dhe kazinotë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat... 4. Detyrimet tatimore janë: organizatori, për çdo lojë, duhet t’u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë; (b) për lojërat e fatit, sportive: (i) organizatori i konkurseve të parashikimeve sportive paguan tatim mbi lojërat e fatit 20 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave. Organizatori, për çdo konkurs, duhet t’u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë; (ii) organizatori i basteve sportive paguan tatim mbi lojërat e fatit me kuotë fikse, si më poshtë: 1.000.000 lekë çdo muaj për shoqërinë; 40.000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së parë; 30.000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së dytë; 20.000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së tretë”.

⁴⁵ 900.000 lekë ÷ 12 muaj x 5.5 muaj.

Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 480.615 lekë të investojë në blerjen e automjetit, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

31.7 Lidhur me këtë konstatim, subjekti në funksion të barrës së provës ka kontestuar përlllogaritjet e Komisionit mbi gjendjen *cash* në fund të vitit 2007, pasi sipas subjektit gjendja *cash* në fund të vitit 2007 nuk është në shumën 900.000 lekë sa është përlllogaritur nga Komisioni, por në shumën 200.000 lekë. Subjekti ka parashtruar se në DIPP-në e vitit 2007 ajo ka deklaruar shtesë të kursimeve *cash*, duke mbajtur në konsideratë se gjendja nga viti 2006 në shumën 700.000 lekë ishte shpenzuar për blerjen e automjetit tip “Seat” dhe se kursimet *cash* gjatë vitit 2007 nuk i shtohen atyre të vitit 2006, pasi logjika e deklarimit ka qenë se pasi ato ishin shpenzuar u krijua një gjendje e kursimeve shtesë në shumën 200.000 lekë. Sipas subjektit, analiza financiare në datën e blerjes së automjetit, pa përfshirë këto të ardhura, paraqitet me mungesë burimesh në shumën - 68.115 lekë, e cila është e vogël dhe jo materiale.

31.8 Subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të përfshihet shuma 400.000 lekë, pasi sipas saj kemi të bëjmë me të ardhura të përfituara në kuadër të një veprimtarie të ushtruar në mënyrë të ligjshme dhe që përfitimin e kësaj të ardhure ajo e ka deklaruar rregullisht. Lidhur me ligjshmërinë e kësaj të ardhure, subjekti ka parashtruar se dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 25.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, *deri në vitin 2010 nuk i klasifikonin fitimet në lojëra fati si burim të ardhurash që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat*. Neni 4 i këtij ligji (ka deklaruar subjekti) ka ndryshuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010, Fletorja Zyrtare nr. 159, datë 3.12.2010. Pas këtyre ndryshimeve të ardhurat nga lojërat e fatit klasifikoheshin si të ardhura të tatueshme.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

31.9 Trupi gjykues, në analizë të fakteve të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti në prapësime lidhur me këtë çështje, arsyeton si vijon:

31.10 Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga lojërat e fatit, çmon se ato nuk duhet të merren në konsideratë, pasi provueshmëria e shumës dhe koha e përfitimit të saj mbeti në nivel deklarativ. Përveç këtij konstatimi, evidentohet fakti se në këtë rast nuk arrihet të provohet edhe shuma që mund të jetë shpenzuar përpara përfitimit të tyre.

31.11 Lidhur me verifikimin e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në raport me pretendimin e subjektit se këto të ardhura në kohën e përfitimit të tyre, viti 2007, deri në vitin 2010, nuk klasifikoheshin fitimet në lojëra fati si burim të ardhurash që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat, pasi neni 4 i këtij ligji ka ndryshuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010, trupi gjykues në analizë të kuadrit ligjor çmon se ky pretendim nuk qëndron. Në këtë çështje trupi gjykues konstaton se subjekti ka deklaruar këto të ardhura në DPV-në e vitit 2007. Ligji nr. 8438, datë 25.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në nenin 8 “Të ardhurat e tatueshme”, shkronja “e” përcakton qartësisht se: *“Të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë përfshihen në të ardhurat e tatueshme”*. Mbi argumentin ligjor të subjektit se neni 4 i ligjit nr. 8438, datë 25.12.1998 (i ndryshuar), ka ndryshuar në vitin 2010, duke i përfshire këto të ardhura si burim që i nënshtrohen tatimit, trupi gjykues vlerëson se ky ndryshim lidhet me faktin se ligjvënësi ka përcaktuar/plotësuar në vitin 2010 (të ardhurat) nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, por neni 8, shkronja “e” e ligjit nr. 8438, datë 25.12.1998 (i ndryshuar), ka pasur parashikimin ligjor që të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë i nënshtrohen tatimit. Në konkluzion për këtë çështje, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka

shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të tyre dhe, për pasojë, ka vlerësuar të mos i marrë ato në konsideratë në përlllogaritjet e kryera.

31.12 Lidhur me pretendimin se gjendja *cash* nuk mund të ndahet në mënyrë të barabartë, trupi gjykues, duke konstatuar se edhe Komisioni nuk mund të saktësojë se sa ka qenë vlera e kursyer në datën që kryhet analiza, çmon ta marrë në konsideratë këtë pretendim. Në këtë çështje objekt analize konstatohet se viti 2006 rezulton se është mbyllur me gjendje *cash* në vlerën 700.000 lekë, shumë kjo që mund të jetë shpenzuar dhe pas muajit qershor të ketë filluar kursimi për gjendjen e deklaruar në vitin 2007, e cila ka rezultuar në shumën 900.000 lekë.

31.13 Lidhur me pretendimin e subjektit se gjendja në vitin 2007 ka qenë 200.000 lekë, trupi gjykues konstaton se ky pretendim nuk qëndron, pasi deklarimi i kryer prej subjektit në DPV-në e vitit 2007 është “Kursime familjare shtesa” e, për rrjedhojë, referuar kërkesës ligjore që subjektet në deklaratat periodike deklarojnë shtesa e pakësime të këtyre likuidimeve, kjo shumë i është shtuar kursimeve të vitit të kaluar. Nga ana tjetër, trupit gjykues në këtë çështje i rezulton se edhe nëse merret në konsideratë pretendimi për të mos u përfshirë gjendja *cash* në datën e investimit, përmirësohet rezultati në datën e investimit, por analiza vjetore e pasqyruar në tabelën e mëposhtme rezulton me balancë negative në vlerën 519.084 lekë.

Nr.	Përshkrimi	2007
1	TË ARDHURA	1,665,618
	Të ardhura nga paga, subjekti	1,004,167
	Të ardhura nga paga, bashkëshorti	352,780
	Të ardhura nga pensioni i invaliditetit (PAK), djali	226,200
	Të ardhura nga interesat	82,471
2	SHPENZIME	743,555
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	683,100
	Shpenzime TIMS	60,455
3	PASURI	1,441,147
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Automjet tip “Seat Alhambra” (19.6.2007), me targë *** (***)	931,007
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>510,140</i>
	DIFERENCA (1-2-3)	-519,084

31.14 Në përfundim, trupi gjykues, pas vlerësimit të situatës faktike, në raport me pretendimet e subjektit, çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016, çmuarje e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes, që janë përcaktuese në procesin e rivlerësimit në tërësi.

32. Gjendja e lekëve në llogarinë rrjedhëse të shtetasit B.S pranë BKT-së, në datën 24.1.2017, në vlerën 10.370,65 lekë. Gjendja në llogari në shumën 10.370,65 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës⁴⁶ lëvizjet e llogarisë së pagës në emër të shtetasit B.S pranë BKT-së, gjatë periudhës 5.1.2016 – 20.1.2017.

⁴⁶ Aneks nr. 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së.

32.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.*

Hetimi i Komisionit

32.2 BKT-ja⁴⁷ informon se shtetasi B.S ka llogari pranë kësaj banke me vlerë 10.370,65 lekë, në datën 28.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*. Në këtë llogari depozitohet paga çdo muaj. Komisioni konstaton se konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

Deklarimi i pasurive të vajzës së subjektit të rivlerësimit – I.S

33. Depozitë bankare në llogarinë nr. * në BKT-në Elbasan,** në emër të shtetasve B.S dhe I.S. Gjendja e depozitës në datën 20.1.2017 është në vlerën 366.938,07 lekë, nga të cilat 325.000 lekë janë principal.

Shtesë depozite bankare në interesa në llogarinë nr. *** në BKT, në emër të shtetasve B.S dhe I.S, deri në datën 20.1.2017, në shumën 41.938,07 lekë. Kjo depozitë është trajtuar/arsyetuar më sipër në këtë vendim.

Deklarimi i pasurive të djalit së subjektit të rivlerësimit – E.S

34. Depozitë bankare në llogarinë nr. * në BKT-në Elbasan,** në emër të shtetasve B.S dhe E.S. Gjendja e depozitës në datën 20.1.2017 është në vlerën 366.938,07 lekë, nga të cilat 325.000 lekë janë principal.

35. Shtesë depozite bankare në interesa në llogarinë nr. *** në BKT, në emër të shtetasve B.S dhe E.S, deri në datën 20.1.2017, në shumën 41.938,07 lekë. Depozita dhe shtesa e saj janë trajtuar më sipër në këtë vendim.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

36. Analiza financiare gjatë hetimit për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të në periudhën 2003 – 2016 dukej se evidentonte tregues të: (a) pamundësisë financiare në shumën 2.766.279 lekë për vitet 2004 – 2005 dhe vitin 2007, për të cilën subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës; (b) pamundësisë financiare në datat apo periudhat e caktuara, të analizuar në vlerën 3.871.980 lekë, për të cilat subjekti paraqiti qëndrimin e saj, trajtuar/vlerësuar nga trupi gjykues rast pas rasti në këtë vendim.

37. Gjatë hetimit, në analizën financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, për periudhën 2003 – 2016, Komisioni, përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor, paraqiti/përfshiu të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre është vlerësuar mjaftueshmëria e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

38. Në përfundim të procesit, në rezultatet e analizës financiare u konsideruan dhe u përpunuan të dhënat për pasuritë e realizuara dhe likuiditetet nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të pasqyruara në vitin e kryerjes së investimit me vlerën e përcaktuar në dokumentacionin përkatës (të përfitimit), të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, bashkëngjitur deklaratës *Vetting* dhe, në përgjigje të pyetësorëve, gjendja e likuiditeteve,

⁴⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

shpenzimet jetike, shpenzimet e tjera të evidentuara përgjatë hetimit, të cilat u rishikuan kur ato rezultuan të bazuara mbi dokumentacion provues dhe u vlerësuan bindëse nga rrethanat dhe faktet e provuara.

39. Për sa më sipër trajtuar, për çdo çështje specifike, trupi gjykues, në rezultatin financiar gjithëpërfshirës konstatoi se subjekti dhe personat e lidhur me të rezultojnë me balancë negative sipas datave të investimit, në shumën 2.327.028 lekë, që së bashku me balancën negative për periudhën e mbetur për vitin 2007, arrin në shumën 2.777.997 lekë. Kundrejt qasjes garantiste, trupi gjykues, duke kryer analizë financiare për periudhën 1999 – 2003, konstatoi se balanca negative rezulton në shumën 2.546.033 lekë.

40. Pas vlerësimeve të kryera, trupi gjykues konstatoi se situata e mësipërme e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016.

41. Në konkluzionin përfundimtar, trupi gjykues çmon se në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë dhe çështjes në tërësi duhet të mbahen në konsideratë në mënyrë integrale e në harmoni me njëra-tjetrën disa rrethana:

i. Rezultoi se në çështjen objekt vlerësimi, pamjaftueshmëria financiare e lidhur me krijimin e likuiditeteve të familjes është cenuar për shkak të mosdeklarimit të saktë e korrekt të tyre/likuiditeteve në vitet 2003 dhe 2004, por mungesa e këtyre deklarimeve nuk është e shoqëruar me ndonjë sjellje të subjektit për të fshehur të ardhurat, pasi rezultoi e provuar nga hetimi administrativ se ato janë depozituar në sistemin bankar.

ii. Nga hetimi u provua që personi i lidhur i subjektit ka pasur të regjistruar aktivitet, por subjekti dështoi të provojë vlerën e fitimit dhe pagimin e detyrimeve tatimore.

iii. Këto rrethana, të gërshetuara edhe me faktin se në çështjen konkrete kërkohet të provohen të ardhura kur ligji nr. 9049/2003 nuk ishte miratuar, për të cilën subjekti ka pretenduar edhe paqartësinë e saj për deklarimin e likuiditeteve *cash*, ka depozituar në ILDKPKI edhe deklarata sqaruese në vitin 2004, nuk vlerësohen nga trupi gjykues si *shkaqe që prodhojnë në mënyrë autonome situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016*, por elementet e këtyre mangësive të deklarimit, si dhe nivelit të mosprovueshmërisë së tyre janë çmuar në drejtim të parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në referencë të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

42. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 2.12.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 8.8.2023, të KDZH-së, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës së subjektit Pranvera Stafa.

Hetimi i Komisionit

42.1 Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse

të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

42.2 Më tej, pas kërkesës së Komisionit⁴⁸ për përditësimin e informacioneve, AKSIK-ja ka dërguar informacion ku konfirmon se nuk kanë rezultuar të dhëna të tjera lidhur me kontrollin e kriterit të figurës.

42.3 Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

42.4 Për sa më sipër, trupi gjykses vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Stafa (Selita), ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

43. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi” ka miratuar këtë raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

43.1 Raporti⁴⁹ është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur prej saj; (iii) 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore⁵⁰, sektori i protokoll - arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

⁴⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁹ Për më shumë të dhëna e detaje subjekti mund t'i referohet raportit të vlerësimit profesional nr. *** prot., datë 9.5.2023, të përgatitur nga KLP-ja, dokument i cili administrohet në dosjet e hetimit administrativ të Komisionit.

⁵⁰ Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 10.8.2020, të KLP-së, administruar në raportin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me analizën e gjetjeve⁵¹ në raport

43.2 Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurorja Pranvera Stafa, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Prokurorja Pranvera Stafa shfaq aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Ajo përdor arsytim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret të hetimit. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale. Ajo shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të akteve që normojnë fushën e ndërtimit, institucioneve përgjegjëse në këtë fushë, si dhe detyrave përkatëse të çdo punonjësi të këtyre institucioneve. Subjekti shfaq njohuri të plota në drejtim të kuptimit të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret për procedimet për të cilat janë ndjekur nga prokurori. Kështu, menjëherë pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se prokurorja identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme, bën interpretim sistematik dhe logjik të normës ligjore në raport me faktin e referuar dhe konkludon në një zgjidhje ligjore të rastit. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorja Pranvera Stafa, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale në cilësinë e prokurorit, ajo është vlerësuar “shumë mirë”.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë prokurori dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti i rivlerësimit Pranvera Stafa shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej saj kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregon kujdes që konkluzionet e tij përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtuara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsytimeve. Në arsyetimet ligjore prokurori bën analizë të normave të ligjeve përkatëse në fushën e lojërave të fatit dhe Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej saj të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkimore dhe etike. Konstatohet se në 8 aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, nga ana e saj bëhet analizë mbi rrethanat e faktit, analizë e zgjeruar e provave të mbledhura, provat e paraqitura nga mbrojtja, si dhe kërkesat dhe pretendimet e mbrojtjes, duke shprehur qëndrimin e saj logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje.

43.3 Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës prokurorja ka trajtuar 713 çështje.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 20.9.2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit qershor 2014 – tetor 2016, rezulton se nga ana e prokurores Pranvera Stafa tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve

⁵¹ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Raporti konkretizon edhe kohëzgjatjen⁵² e trajtimit të çështjeve që lidhen me dosjet 1, 2, 3, 4 dhe 5. Në analizë të të dhënave konstatohet se subjekti Pranvera Stafa ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrit total të çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Prokurorja Pranvera Stafa kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet se nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve.

Gjithashtu vihet re se qëndrimi i prokurores në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e saj të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurorja ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

43.4 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë prokurorja, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga ana e subjektit të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Pranvera Stafa dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurores Pranvera Stafa. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5

⁵² Dosja 1 – Kallëzimi penal nr. ***, viti 2013, me datë regjistrimi 14.10.2013 dhe datë mosfillimi 22.10.2013, kohëzgjatja 8 (tetë) ditë. Dosja 2 – Procedimi penal nr. ***, viti 2014, me datë regjistrimi 16.1.2014 dhe datë pushimi 15.6.2015, kohëzgjatja 4 (katër) muaj 29 (njëzet e nëntë) ditë. Dosja 3 – Procedimi penal nr. ***, viti 2013, me datë regjistrimi 10.10.2013, datë pushimi 21.2.2014, kohëzgjatja 4 (katër) muaj 11 (njëmbëdhjetë) ditë. Dosja 4 – Procedimi penal nr. ***, viti 2014, me datë regjistrimi 24.11.2014, datë dërgimi për gjykim 14.1.2015, kohëzgjatja 1 (një) muaj e 20 (njëzet) ditë. Dosja 5 – Procedimi penal nr. ***, viti 2015, me datë regjistrimi 21.12.2014, datë dërgimi për gjykim 15.6.2016, kohëzgjatja 6 (gjashtë) e muaj 24 (njëzet e katër) ditë.

dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

43.5 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga 3 dokumentet ligjore të vetë përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e përzgjedhura në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Pranvera Stafa për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “Shumë mirë” edhe për aftësitë e bashkëpunimit.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Pranvera Stafa rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë programit formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

C/1. RIVLERËSIMI PROFESIONAL NGA KOMISIONI

43.6 Në analizë të 3 dokumenteve⁵³ të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni konstatoi se:

a. Për vendimin e mosfillimit të procedimit penal datë 21.5.2014 (dokument 1) nuk është ushtruar ankim⁵⁴.

b. Për kërkesën për vleftësimin e arrestit, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. ***, viti 2015 (dokument 2), çështja ka kaluar për gjykim dhe për vendimin e gjykatës nuk është ushtruar ankim⁵⁵.

i. Lidhur me këtë çështje vëzhguesi ndërkombëtar (në vijim vëzhguesi), bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 49, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur mendimin e tij nr. ***prot., datë 18.12.2023.

ii. Lidhur me këtë çështje, vëzhguesi ka analizuar raportin e vlerësimit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit Pranvera Stafa (nr. *** prot., datë 9.5.2023). Depozitimi i këtij mendimi synon të mbrojë të drejtat, parimet dhe vlerat kushtetuese që janë thelbësore në procesin e rivlerësimit, si dhe të mbështesë hetimin për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Pranvera Stafa (Selita).

iii. Kërkesa për vleftësimin e arrestit, caktimi i masës së sigurimit dhe gjykimi i shkurtuar, procedimi penal nr. ***, viti 2015, ndaj shtetasit I.C – janë të justifikuara, duke pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi që rregullonte caktimin e masave të sigurisë dhe rrethanat e çështjes përkatëse.

⁵³ 1. Vendim për mosfillimin e procedimit penal, datë 21.5.2014. 2. Kërkesë për vleftësimin e arrestit, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. ***, viti 2015, në ngarkim të shtetasit I.C. 3. Vendim për pezullimin e hetimeve, datë 22.12.2016, për procedimin penal nr. ***, viti 2016.

⁵⁴ Vërtetim datë 16.12.2020 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, depozituar në raportin profesional të subjektit.

⁵⁵ Të dhëna nga dokumentacioni i depozituar në raportin e vlerësimit profesional të subjektit.

iv. Rregullat për caktimin e masave të sigurimit përcaktohen në titullin V, kreu 1, seksioni 1 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, në veçanti nenet 228⁵⁶, 229⁵⁷ dhe 230⁵⁸ të Kodit të Procedurës Penale. Dispozitat e cituara theksojnë se masat e sigurimit duhet të vendosen vetëm kur plotësohen kriteret ligjore të parashikuara në to dhe se masat e sigurimit duhet të jetë gjithmonë të përshtatshme dhe në proporcion me rëndësinë e veprës. Arresti në burg në veçanti, duke pasur parasysh ashpërsinë e tij, duhet të caktohet vetëm kur masat e tjera konsiderohen të pamjaftueshme “për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit” (neni 230 i Kodit të Procedurës Penale).

v. Kushte të ngjashme strikte për caktimin e arrestit në burg janë përcaktuar në nenin 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ). Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përmes jurisprudencës së saj, në shumë raste ka theksuar se arresti në burg sipas nenit 5 të KEDNJ-së duhet të udhëhiqet nga parimet e sundimit të ligjit, sigurisë juridike, proporcionalitetit dhe mbrojtjes nga arbitrariteti⁵⁹.

vi. Në këtë kontekst, rrethanat e çështjes të referuara në Dokumentin Ligjor 2 të raportit të vlerësimit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit Pranvera Stafa – kërkesa për vleftësimin e arrestit, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykim të shkurtuar në procedimin penal nr. ***, viti 2015, kundër shtetasit I.C – shtron çështjen e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit të urdhrat të arrestit/arrestit në burg ndaj këtij shtetasi. Çështja në fjalë kishte të bënte me veprën penale “Vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, e cila nuk është veprë aq e rëndë. I dyshuari në këtë çështje, shtetasi I.C, e ka pranuar fajin menjëherë dhe në mënyrë të përsëritur. Vendbanimi i tij është përcaktuar dhe është i martuar me dy fëmijë të vegjël. Këto rrethana tregojnë pa dyshim se nuk kishte ndonjë rrezikshmëri të veçantë arratisjeje, pengim hetimesh apo përsëritje të veprës nga ana e shtetasit I.C, *gjë që ngre dyshime nëse kërkesa për vleftësimin e ligjshmërisë së arrestit të tij në flagrante delicto dhe caktimit të masës së sigurimit personal të arrestit në burg, të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit Pranvera Stafa, është e bazuar për këtë çështje.* Përkundrazi, nga faktet e çështjes do të rezultonte se hetimet penale mund të ishin kryer edhe me masa të tjera parandaluese, më pak të rënda, d.m.th. pa iu drejtuar arrestit në burg. *Si e tillë, kjo ngre pikëpyetje në lidhje me aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të interpretuar dhe zbatuar saktë ligjin dhe për të kryer hetime duke respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.*

vii. Komisioni nga verifikimi i dokumentit të hartuar nga subjekti konstatoi se subjekti i rivlerësimit në kërkesën për vleftësimin e masës së arrestit dhe po ashtu edhe gjykata në vendimin e saj nr. ***, datë 30.10.2015, kanë konfirmuar se *shtetasi C ka qenë i dënuar më parë, por në përmbajtje të arsyetimeve duket se nuk jepen të dhëna për këtë dënim.*

⁵⁶ Neni 228, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale/3: “Masat e sigurimit personal vendosen: a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vëjnë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit; b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”.

⁵⁷ 1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal. 3. Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh interesin e tij më të lartë dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

⁵⁸ 1. Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.

⁵⁹ Shihni vendimin e GJEDNJ-së në çështjen *Simons v. Belgium*, 2012, paragrafi 32.

viii. Po në këtë kërkesë nuk jepen të dhëna lidhur me gjendjen shëndetësore të këtij shtetasi, vetëm se përmendet se ai është invalid dhe as lidhur me faktin se ai ishte i papunë, tregues këto që gjithashtu duket se nuk janë vlerësuar e konsideruar në këtë çështje, në raport me masën e kërkuar.

b/1. Sipas konstatimeve të mësipërme, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte dhe depozitonte vërtetimin e gjendjes gjyqësore të këtij shtetasi, si dhe të dokumentonte lidhur me invaliditetin dhe papunësinë e tij.

b/2. Në qëndrimin e saj, subjekti ka parashtruar se nga ana e saj është bërë zbatim dhe interpretim i saktë i ligjit për kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, si dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ku kërkimet e prokurorisë janë vlerësuar të drejta nga ana e gjykatës. Parimi i të drejtës kërkon që kur flet gjykata palët heshtin. Kodi i Procedurës Penale parashikon se masat e sigurimit nuk përcaktohen nga prokuroria (pasi kjo e fundit vetëm paraqet kërkesë), por nga gjykata.

b/3. Lidhur me kërkimet e saj drejtuar gjykatës, subjekti ka parashtruar se ligjvënësi shqiptar veprën penale “Vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal, e ka ndryshuar në vitet 2008 dhe 2014. Ndërhyrjet nga ligjvënësi në këtë parashikim të Kodit Penal janë bërë për shkak të rëndësisë së faktit që kishte ndërprerja e këtij fenomeni të paligjshëm në Shqipëri. Ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin elektrik, me qëllim vjedhjen e energjisë elektrike, kishin përhapje të madhe. Dëmi që vinte ishte aq i madh sa që ndërhyrja në Kodin Penal është parë si një interes i lartë publik nga ana e ligjvënësit shqiptar. Kjo bëri që kjo veprë penale nga kundërvajtje penale të kthehet në krim. Politika penale në të gjitha prokuroritë dhe gjykatat shqiptare në këtë periudhë, në lidhje me këtë veprë penale, për shkak të rëndësisë së faktit dhe shkallës së rrezikshmërisë që paraqitnin personat që konsumonin këtë veprë penale, ishte e tillë ku hetimet zhvilloheshin me masë sigurimi që kufizonte lirinë ndaj këtyre personave. Në lidhje me këtë fenomen ka pasur një fushatë sensibilizuese për gjithë opinionin publik, që të ndalej vjedhja e energjisë elektrike dhe përsëri këta persona bënë ndërhyrje të paligjshme në rrjetin e energjisë elektrike duke e vjedhur atë, rrethana këto që janë mbajtur në konsideratë në momentin e paraqitjes së kërkesës për vleftësimin e arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit për shtetasin I.C.

b/4. Sipas subjektit, në këtë çështje është mbajtur në konsideratë jo vetëm fakti i arratisjes së personit apo pengimi i hetimeve, por edhe mundësia e përsëritjes së veprës penale, si dhe ekzekutimi eventual i dënimit në funksion të realizimeve të qëllimit të dënimeve, parandalimi i posaçëm dhe i përgjithshëm, mundësia e përsëritjes së vjedhjes së energjisë elektrike, përsëritja e të njëjtës veprë penale ka qenë e pranishme. Subjekti ka shpjeguar se referuar dëshmisë së penaltetit të këtij shtetasi, ai rezultonte i dënuar tri herë më parë. Referuar pamjeve të vendit të ndërhyrjes në matës, ajo ka sqaruar se kishin të bënin me një ndërhyrje të rrezikshme, lidhje mes telash jashtë çdo standardi, ku mundësia për rrezikim jete ishte e dukshme, fakt të cilin e pohonte edhe vetë shtetasi I.C.

b/5. Subjekti ka parashtruar se në këtë periudhë prokurorët pranë Prokurorisë së Rrethit Elbasan, si në të gjitha prokuroritë e vendit, për autorët e kësaj veprë penale kërkonin masë sigurimi “Arrest në burg” dhe çështja kalonte në gjykim me procedurën e gjykimit të drejtpërdrejtë. Subjekti ka depozituar edhe statistika për vitet 2014 – 2015 të Prokurorisë së Rrethit Elbasan, në lidhje me kërkimet e kësaj Prokurorie mbi masat e sigurimit dhe gjykimet e drejtpërdrejta për autorët e veprës penale të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal.

b/6. Në lidhje me masën e dënimit të kërkuar nga prokuroria, subjekti ka shpjeguar se janë mbajtur në konsideratë rrethanat lehtësuese të përmendura në përmbajtje të kërkimit dhe në vlerësim total të rrezikshmërisë së veprës penale, rrezikshmërisë së personit, si dhe rrethanave lehtësuese, sa

parashikon neni 47 i Kodit Penal, mbi individualizimin e dënimit, duke vlerësuar se ajo masë dënimi e kërkuar i shërben qëllimit të dënimit.

b/7. Lidhur me këtë çështje, në vlerësimin e trupit gjykues, përmbushja e kushteve dhe kriterëve në caktimin e masave të sigurimit përcaktohet nga faktet dhe rrethanat konkrete të çështjes, të udhëhequra nga parimet e sundimit të ligjit, sigurisë juridike, proporcionalitetit, si dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, sikurse Gjykata Evropiane ka nënvizuar se: *“Arrestin në burg i një individi është një masë kaq e rëndë saqë justifikohet vetëm kur masa të tjera më pak të rënda janë konsideruar dhe janë gjetur të pamjaftueshme për të mbrojtur individin ose interesin publik që mund të kërkojë që personi në fjalë t’i caktohet masa “Arrestin në burg”. Kjo do të thotë se nuk mjafton që heqja e lirisë të jetë në përputhje me legjislacionin e brendshëm, por duhet të kërkojë edhe nga rrethanat⁶⁰”.*

b/8. Në analizë të çështjes konkrete, trupi gjykues konstatoi se subjekti në kërkesën e saj nuk ka arsyetuar mjaftueshëm mbi përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e vendosjes së masës më ekstreme, në raport me rrethanat e dala nga kjo çështje, që tregojnë se shtetasi I.C ka qenë i papunë, invalid i grupit të dytë dhe me dy fëmijë të vegjël (pa ndonjë rrezikshmëri sociale, shkak largimi për të shmangur drejtësinë apo mundësi për të prishur provat) dhe parimet e sundimit të ligjit, në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mangësi e cila është vlerësuar në tërësi në çështjen e rivlerësimit të subjektit.

43.6.1 Në vijim të trajtimit të 3 dokumenteve të depozituara nga subjekti, për vendimin për pezullimin e hetimeve, datë 22.12.2016, për procedimin penal nr. ***, viti 2016, nga raporti i administruar nuk rezultuan të dhëna lidhur me ecurinë e mëtejshme të kësaj çështjeje. Komisioni i kërkoi subjektit⁶¹ të qartësojë dhe dokumentojë statusin aktual të çështjes së pezulluar prej saj.

c. Subjekti në përgjigjen e dhënë ka deklaruar se për këtë procedim të regjistruar në datën 20.1.2016, për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, pas kryerjes së veprimeve hetimore është vendosur pezullimi në datën 22.2.2016 dhe çështja ka kaluar DVPolicisë për zbulimin e autorit. Më tej, në datën 30.9.2021, Komisioni i Policisë Elbasan ka dërguar procedimin penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të afateve të parashkrimit bazuar në nenin 66/ç të Kodit Penal.

c/1. Subjekti ka deklaruar se në datën 6.2.2022 është vendosur rifillimi i hetimeve dhe është paraqitur kërkesë pranë gjykatës për pushimin e hetimeve, bazuar në nenin 329/a të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti ka deklaruar se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 21.7.2022, ka pranuar kërkesën e organit të akuzës, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 30.8.2022.

c/2. Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 15.12.2023, vendimin nr. ***, datë 21.7.2022, etj.

c/3. Lidhur me këtë çështje, Komisioni i kërkoi subjektit: (i) të deklaronte arsyet e mbajtjes së çështjes pa veprime nga data 30.9.2021 deri në datën 6.2.2022 (sikurse dukej deri në këtë fazë të hetimit), kohë kur deklaronte se është vendosur rifillimi i hetimeve; (ii) të qartësojë dhe dokumentonte veprimet hetimore që janë kryer nga data 6.2.2022 deri në dërgimin e kërkesës në gjykatë, për pushimin e çështjes; (iii) të depozitonte kërkesën e organit të akuzës drejtuar gjykatës.

c/4. Në qëndrimin e saj subjekti ka parashtruar se në këtë rast vendimi për rifillim hetimi dhe kërkesa për pushimin e çështjes nuk mund të konsiderohen në kuptim të nenit 324/4 të Kodit të

⁶⁰ Shihni vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Enhorn v. Sweden, 2005, paragrafi 36.

⁶¹ Me pyetësin nr. 3, datë 12.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

Procedurës Penale si veprime hetimore, por si akte procedurale të prokurorit. Subjekti ka sqaruar se kërkesa për pushimin e çështjes penale në gjykatë, për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit, nuk lidhet me afate procedurale, pasi nuk kërkon kryerje veprimesh hetimore, por përbën ndërmarrjen e aktit procedural përkatës për arkivin e dosjes.

c/5. Sipas subjektit, kjo çështje nuk është mbajtur pa veprime, nga data 30.9.2021 deri në datën 6.2.2022, pasi në momentet e plotësimit të afatit të parashkrimit hetimet nuk vazhdojnë më, pasi autori i veprës penale nuk mund të merret më në përgjegjësi penale edhe sikur të identifikohet. Ajo ka deklaruar se kërkesa në gjykatë për pushimin e çështjes për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit është paraqitur në atë datë, për arsye të ngarkesës në punë dhe se pas plotësimit të afatit të parashkrimit nuk mund të vazhdohet me kryerje veprimesh hetimore, pasi afati i parashkrimit detyron pushimin e çështjes (neni 328 i Kodit të Procedurës Penale, shkronja “d”). Subjekti ka sqaruar se Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon afate për paraqitjen e kërkesave të kësaj natyre.

c/6. Trupi gjykues, vlerësoi shpjegimet e subjektit për moskryerje të veprime të mëtejshme hetimore, për shkak se referimi i policisë cilësonte moszbulimin e autorit dhe kalimin e afateve të parashkrimit. Në rrethanat e dala, vendimi i subjektit për rifillim hetimi, duket se thjesht dhe vetëm ka formalizuar aktin procedural, konkretisht kërkesën drejtuar gjykatës dhe nuk i referohet ndonjë veprimi procedural për kryerje të veprimeve hetimore. Pas qartësimit të rastit, në tërësi për këtë çështje, nuk evidentohet ndonjë problematikë.

43.7 Në analizë të 5 dosjeve⁶² të shortuara në mënyrë rastësore, për subjektin e rivlerësimit:

a. Në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal për materialin hetimor nr. ***, datë 14.10.2013 (dosja 1), nuk rezultuan të dhëna nëse është bërë ankim dhe, në këto kushte, Komisioni i kërkoi subjektit⁶³ të sqarojë dhe dokumentojë statusin aktual të kësaj çështjeje.

a/1. Subjekti, në përgjigjen e dhënë ka konfirmuar se ndaj vendimit të saj datë 22.10.2013, me të cilin është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal për materialin hetimor nr. ***regj., datë 14.10.2013”, nuk është ushtruar ankim. Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 15.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila konfirmon këtë fakt.

a/2. Për dy vendimet *për pushimin e çështjes* (dosjet 2 dhe 3) duket se ka tejkalim të afatit ligjor për hetimin e tyre. Në dosjen 2 rezultoi se hetimi ka zgjatur 1 vit e 5 muaj dhe jo 4 muaj e 29 ditë, siç pasqyrohet në raportin profesional të KLP-së për subjektin e rivlerësimit. Në dosjen 3 rezultoi se hetimi ka zgjatur 4 muaj e 11 ditë.

a/3. Për këto tejkalime të afateve ligjore duket se subjekti nuk është shprehur në arsyetim, në vendimmarrjet e saj. Lidhur me këto konstatime, Komisioni i kërkoi subjektit⁶⁴ të shpjegojë dhe

⁶² Dosja nr. 1 – Dokumenti ligjor “Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2013”, akt i datës 22.10.2013, mbi kallëzimin penal nr. ***, datë 14.10.2013, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Dosja nr. 2 – Dokumenti ligjor “Vendim për pushimin e çështjes nr. ***, viti 2014” akt i datës 15.6.2015, si dhe procedimin penal nr. ***, datë 16.1.2014, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Dosja nr. 3 – Dokumenti ligjor “Vendim për pushimin e çështjes nr. ***, viti 2013” akt i datës 21.2.2014, si dhe procedimin penal nr. ***, datë 10.10.2013, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Dosja nr. 4 – Dokumenti ligjor “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014”, si dhe procedimin penal nr. ***, datë 24.11.2014, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Dosja nr. 5 – Dokumenti ligjor “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2015” akt i datës 15.06.2016, si dhe procedimin penal nr. ***, datë 24.12.2015, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁶³ Me pyetësin nr. 3, datë 12.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁴ Me pyetësin nr. 3, datë 12.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

dokumentoje të kundërtën, pasi duket se është cenuar afati tremujor për hetimin e çështjes, mbi të cilën është vendosur pushimi i secilës prej tyre.

a/4. Subjekti, në përgjigjen e dhënë për çështjen penale që i përket dosjes nr. 2, ka deklaruar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më 16.1.2014 ka bërë regjistrimin e procedimit penal nr. *** për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Kallëzimi është bërë nga shtetasi G.K. Po në këtë datë është nxjerrë urdhri për kryerjen e veprimeve hetimore, duke u caktuar si oficer i policisë gjyqësore z. K.ZH, që i ushtronte funksionet e tij pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan. Procedimi penal është regjistruar pa emër personi që i atribuohet vepra penale, është regjistruar vetëm për veprën penale. Subjekti ka deklaruar se edhe pse është ngulmuar në kryerjen e veprimeve hetimore në kohë dhe në vazhdimësi, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, ndoshta edhe për shkak të ngarkesës, si dhe natyrës së punës së tyre, veprimet hetimore për këtë procedim penal janë kryer në një shtrirje kohore prej gati një viti. Kjo vërtetohet, është shprehur subjekti, me shkresat dhe me veprimet hetimore që ndodhen në aktet e dosjes së këtij procedimi. Subjekti ka deklaruar se edhe pas një viti, duke qenë se nga OPGJ-ja sërish nuk ishin përfunduar hetimet, pas sinjalizimit prej saj, nga ana e drejtuesit të prokurorisë të asaj kohe, më 5.2.2015 është disponuar me vendim për zëvendësimin e oficerit të policisë gjyqësore, duke u caktuar një tjetër oficer që ushtronte detyrën e tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Subjekti ka deklaruar se pas vazhdimit të veprimeve hetimore të shtrira në kohë, nga OPGJ-ja tjetër dhe në momentin kur është disponuar me relacion, ajo ka vendosur “Pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2014”. Subjekti ka deklaruar se veprimet hetimore për këtë çështje kanë qenë dinamike, në vazhdimësi dhe me përfundimin e të gjitha veprimeve, në kuadër të planit hetimor është dhënë edhe zgjidhja përfundimtare e çështjes. Subjekti ka qartësuar se vendimi i saj është gjetur i rregullt nga ana e drejtuesit të prokurorisë së asaj kohe. Po kështu, ky procedim është kontrolluar edhe nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Task-Forcë Tiranë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 15.12.2015, pas shqyrtimit të akteve mbi bazën e ankimit të shtetasve G dhe R.K ka konstatuar se nga ana e kësaj prokurorie janë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe të duhura hetimore, nuk ka vend për të kryer ndonjë veprim tjetër hetimor dhe se vendimi i pushimit është i bazuar në ligj, përfundim me të cilin janë njohur edhe ankuesit. Subjekti ka konfirmuar se ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim. Për të mbështetur këtë konfirmim, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 15.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe njëkohësisht si në rastet e tjera të trajtuara lidhur me çështje që janë regjistruar pa autor, subjekti ka deklaruar se nuk është detyrim vendimmarrja për shtyrjen e afatit të veprimeve hetimore, duke referuar në këtë rast nenin 323/2 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe faktin se për këto çështje nuk ka afat për përfundimin e hetimeve dhe mbarimin e afateve tre muaj. Sipas shkresës nr. *** prot., datë 15.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, depozituar nga subjekti, konfirmohet fakti se ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim.

a/5. Nga të dhënat e administruara në dosjen nr. 2 konstatohet se subjekti i rivlerësimit në të njëjtën datë që ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal, 16.1.2014, ka urdhëruar edhe kryerjen e veprimeve hetimore me afat, për t’u kryer brenda datës 16.3.2014, ndërkohë që pas kësaj date, sikurse ka deklaruar edhe vetë subjekti, ajo ka sinjalizuar vetëm në shkurt të vitit 2015 për vonesat e ardhura në kryerjen e veprimeve hetimore nga OPGJ-ja.

a/6. Nga të dhënat e dala nga hetimi për këtë çështje, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi dukej se moskryerja e veprimeve hetimore dhe mbajtja e çështjes nën hetim për një kohë relativisht të gjatë dukej e pajustificuar nën pretendimin e moskryerjes së veprimeve nga OPGJ-ja, pasi sipas nenit 24/1 të Kodit të Procedurës Penale *prokurori ushtron ndjekjen penale..., drejton*

dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm...

a/7. Subjekti në qëndrimin e saj ka parashtruar se procedimi penal nr. ***, viti 2014, është regjistruar pa emër personi që i atribuohet vepra penale, i regjistruar vetëm për veprën penale për të cilën kallëzohet penalisht se ishte kryer. Kallëzuesi G.K nuk referonte tek ndonjë e dhënë konkrete, por dyshonte se shtetasi A.K, duke qenë kryeplak, mund të kishte përvetësuar tokë shtet, pasi kishte bllokuar rrugën. Përfitimin e kësaj toke ai mendonte se mund ta kishte bërë nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve, por pa referuar tek ndonjë e dhënë konkrete apo veprim konkret të këtij personi. Sa parashikon Kodi i Procedurës Penale, emri i personit në regjistrin e njoftimit të veprave penale bëhet kur identifikohet autori. Për këtë, subjekti ka referuar vendimin unifikues⁶⁵ nr. 3, datë 27.9.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

a/8. Sipas subjektit, në procedimin penal nr. ***, vitit 2014, detyra e prokurorit është ushtruar plotësisht në përputhje me parashikimet e nenit 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, në aspektin e ushtrimit të ndjekjes penale, si dhe drejtimit dhe kontrollimit të hetimeve paraprake dhe veprimtarisë së oficerit të policisë gjyqësore. Në këtë rast, nuk ka pasur moskryerje veprimesh hetimore dhe mbajtje çështjesh në kohë relativisht të gjatë në dorë pa veprime hetimore, pasi çdo dy javë ka pasur nisje shkresash për institucionet dhe administrim dhe studim material nga prokurori, që do të thotë dhe kontrollim të veprimeve hetimore të oficerit të policisë gjyqësore. Oficeri i policisë gjyqësore është në dispozicion të prokurorit dhe merr urdhra nga ky i fundit me gojë dhe me shkrim. Nga ana e oficerit të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, veprimet hetimore për këtë procedim penal janë kryer në një shtrirje kohore prej gati një viti, diktuar nga natyra e hetimit, por të kontrolluara plotësisht nga prokurori. Duke qenë se hetimet ishin të shtrira në kohë, referuar natyrës së çështjes, nga ana e prokurorit është vendosur zëvendësimi i oficerit të policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë Vendore Elbasan me një oficer të policisë gjyqësore pranë prokurorisë. Kjo, pasi OPGJ-ja pranë Drejtorisë Vendore të Policisë ka varësi të dyfishtë, ndërsa oficeri i policisë gjyqësore pranë prokurorisë, duke qenë dhe pranë prokurorit mund t'i shërbente më mirë përshpejtimin të veprimeve hetimore, edhe në kuptimin e administrimit të dokumentacionit të nevojshëm nga institucionet, si dhe studimit të këtij dokumentacioni nga prokurori. Pasi janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme nga OPGJ-ja, nga ana e prokurorit është vendosur “Pushimi i hetimeve për procedimin penal nr. *** të vitit 2014”. Sikurse ka deklaruar edhe në pyetësorët e mëparshëm, veprimet hetimore për këtë çështje kanë qenë dinamike, në vazhdimësi dhe me përfundimin e të gjitha veprimeve, në kuadër të planit hetimor është dhënë edhe zgjidhja përfundimtare e çështjes. Nuk ka pasur mbajtje të çështjes penale nën hetim, në mënyrë të pajustificuar, pa veprime hetimore. Subjekti ka depozituar dokumentacionin e dosjes për të provuar kryerjen e veprimeve hetimore në vijimësi. Subjekti ka

⁶⁵ I cili shprehet se: “Në fazën e hetimeve paraprake kuptohet se ndryshon dhe gjendja juridiko-procedurale penale e autorit të mundshëm të veprës penale nga person që i atribuohet vepra penale në “person ndaj të cilit zhvillohen hetime”. Këtë emërtim e mbajnë vetëm personat që dyshohen si autorë të mundshëm të veprës penale. Edhe ky, emërtimi i dytë që merr autori i mundshëm i veprës penale gjatë hetimeve paraprake nuk mund të barazohet me termin “i pandehur”. Personi ndaj të cilit zhvillohen hetime është një figurë procedurale e përkohshme që qëndron midis asaj që Kodi i Procedurës Penale e quan “person të cilit i atribuohet vepra penale” dhe “të pandehurit”, e cila është një figurë më e avancuar procedurale dhe relativisht më e qëndrueshme, e cila ruhet e pandryshuar, në çdo gjendje dhe shkallë të procesit penal, derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose fajësisë (neni 34/2 i Kodit të Procedurës Penale). Duke përmbledhur sa u tha më sipër, arrihet në përfundimin se figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale që nga momenti i njoftimit të saj tek prokurori e deri në momentin e përfundimit të hetimeve (neni 327) evoluon nga “person të cilit i atribuohet vepra penale” në “person ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe së fundi në “i pandehur”, pavarësisht se çështja pushohet (neni 328) apo dërgohet për gjykim (neni 331). Si rregull, statusi i të pandehurit merret në përfundim të hetimeve përpara se të depozitohet fashikulli i gjykimit, por ky status mund të merret edhe më përpara. Kjo është në çmimin e prokurorit. Dhe këtë prokurori mund ta bëjë në çdo fazë të hetimit deri në përfundimin e tyre. Këtë veprim prokurori e kryen vetëm pasi të ketë siguruar të dhënat e mjaftueshme (neni 34/1 i Kodit të Procedurës Penale).

deklaruar se administrimi i përgjigjeve nga institucionet diktonte kërkim informacioni shtesë, në varësi të pretendimeve të ngritura nga kallëzuesi dhe personave të pyetur mbi rrethanat e faktit.

a/9. Subjekti ka deklaruar se ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim dhe për këtë ka depozituar disa dokumente⁶⁶.

a/10. Në çështjen objekt vlerësimi, trupi gjykues konstaton se subjekti gjatë hetimit parashtroi se edhe pse është ngulmuar në kryerjen e veprimeve hetimore në kohë dhe në vazhdimësi, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, veprimet hetimore për këtë procedim penal janë kryer në një shtrirje kohore prej gati një viti. Subjekti ka deklaruar se edhe pas një viti, duke qenë se nga OPGJ-ja sërish nuk ishin përfunduar hetimet, pas sinjalizimit prej saj, nga ana e drejtuesit të prokurorisë të asaj kohe më 5.2.2015 është disponuar me vendim për zëvendësimin të tij. Në prapësime, subjekti ka pretenduar se janë bërë shkresa çdo dy javë dhe është studiuar dosja.

a/11. Trupi gjykues, lidhur me këto pretendime të subjektit, pas verifikimit të akteve në dosje konstaton se shpjegimi i subjektit për kryerje të veprime hetimore çdo dy javë nuk përputhet me të dhënat e pasqyruara nga aktet e depozituara, konkretisht:

i) Të dhënat e pasqyruara tregojnë kërkime vetëm në intervalin 2-4 muaj me përgjigje të vonuara dhe konstatohet se ato janë kryesisht jashtë datës së caktimit nga subjekti për përfundimin e kryerjes së hetimeve në mars 2014;

ii) Konstatohet se subjekti deri në datën e caktuar për kryerjen e hetimeve, mars 2014, ka vendosur të kryhen 8 veprime hetimore, nga ku rezulton se ato nuk janë kryer brenda këtij afati;

iii) Nuk janë bindëse pretendimet e parashtruara nga subjekti se veprimet hetimore nuk u kryen nga OPGJ-ja, për shkak të ngarkesës, varësisë së dyfishtë, etj., pasi sipas nenit 24/1 të Kodit të Procedurës Penale prokurori ushtron ndjekjen penale..., drejton dhe kontrollon hetimet paraprahe dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm.

a/12. Në përfundim, nga analiza e akteve dhe rrethanave më sipër, për këtë procedim penal trupi gjykues çmon se kohëzgjatja e tij, edhe pse pa autor, në një afat prej 15 muajsh është bërë pa shkaqe të justifikuar, duke shfaqur kështu mangësi në drejtim të karakterit organizativ, përfshirë mbikëqyrjen e çështjes, si dhe mosveprimin me efikasitet në kryerjen e hetimeve sipas nenit 74, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016.

b. Për çështjen penale që i përket dosjes nr. 3, subjekti gjatë hetimit ka deklaruar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më 10.10.2013, mbi bazën e kërkesës (kallëzim) së shtetasës S.H, ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “Mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Subjekti ka deklaruar se po në atë datë është hartuar urdhri për kryerjen e veprimeve, duke ia dhënë oficerit të policisë gjyqësore për vijueshmërinë e mëtejshme të tyre. Subjekti ka shpjeguar se procedimi penal është regjistruar pa

⁶⁶ Me pyetësor - shkresën nr. *** prot., datë 15.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (në prapësime); urdhër për regjistrimin e procedimit penal; urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore; vendim për zëvendësimin e oficerit të policisë gjyqësore; kërkesë datë 21.2.2024 për ZVRPP-në Peqin; përgjigje datë 24.2.2024, shoqëruar me dokumentacion; kërkesë datë 29.4.2024 për ZVRPP Peqin, përgjigje datë 8.5.2014, shoqëruar me dokumentacion; kërkesë datë 29.4.2014 për Zyrën e Administrimit të Tokës, P; kërkesë datë 29.4.2014 për Komunën P; kërkesë datë 29.4.2014 për Ministrinë e Transportit; kërkesë datë 8.8.2014 për Drejtorinë e Arkivave; kërkesë datë 18.8.2014 për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan; përgjigjet respektive të këtyre institucioneve; Vendim për kryerje ekspertimi topografik etj., sipas akteve të përzgjedhura nga procedimi penal nr. ***.

emër të cilit i atribuohet vepra penale në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Në këtë regjistër është shënuar vetëm vepra penale për të cilën hetohej, pa autor.

b/1. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga aktet e procedimit penal, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore janë kryer veprime për hetimin e mëtejshëm duke insistuar në thirrjen dhe pyetjen e shtetasve që kanë dijeni për veprën penale me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave të faktit. Subjekti ka deklaruar se pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe sjelljes së materialit nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, prej saj, pas studimit të akteve të procedimit penal më 21.2.2014 është vendosur “Pushimi i hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2013”. Ky vendim është kontrolluar dhe është gjetur i rregullt nga ana e drejtuesit të prokurorisë së asaj kohe.

b/2. Lidhur me statusin e çështjes, subjekti ka konfirmuar se ky vendim nuk është ankimuar. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 15.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nga ku Komisioni konstatoi se provohet ky fakt. Edhe në këtë rast subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me tejkalimin e afatit të kryerjes së hetimeve, duke deklaruar se nuk është detyrim vendimmarrja (ndërmarrja e akteve) për shtyrjen e afatit të veprimeve hetimore në referencë të nenit 323/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe se për këto çështje nuk ka afat për përfundimin e hetimeve dhe mbarimin e afatit 3-mujor.

c. Për 2 kërkesat për gjykimin e procedimit penal (dosjet 4 dhe 5) rezulton se çështjet kanë shkuar për gjykim dhe për vendimet e gjykatës rezultoi se nuk ishte bërë ankim⁶⁷. Nga analiza e të dhënave në raportin e vlerësimit profesional.

43.8 Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me etikën, integritetin dhe paanësinë e subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e detyrës së saj funksionale.

43.9 Bazuar në përgjigjet e ardhura nga prokuroritë e rretheve gjyqësore për subjektin e rivlerësimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka informuar⁶⁸ se ka rezultuar kallëzimi penal nr. ***, viti 2017, regjistruar procedimi penal nr. ***, transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 23.3.2017.

a. Për këtë çështje Komisioni i kërkoi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan informacion dhe dokumentacion.

b. Pas administrimit të kopjes së fashikullit penal⁶⁹ Komisioni konstatoi si vijon:

i. Shtetasi O.M ka kallëzuar subjektin e rivlerësimit, OPGJ-në dhe një ekspert për shpërdorim detyre, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, material që, fillimisht, është regjistruar si procedimi penal nr. *** në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në kallëzimin e tij shtetasi O.M ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit dhe OPGJ-ja kanë ushtruar ndikim të paligjshëm tek eksperti, i cili nëpërmjet aktit të ekspertimit ka arritur në konkluzione të rreme. Çështja i referohet një aksidenti të ndodhur nga përplasja e dy automjeteve, më konkretisht e shtetasit O.M dhe shtetasit L.Q.

ii. Kallëzuesi ka pretenduar se babai i shtetasit L.Q është djali i dajës së subjektit dhe, për këtë shkak, hetimet kanë favorizuar me pa të drejtë shtetasin Q. Pas regjistrimit të procedimit penal në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, çështja ka kaluar për kompetencë territoriale në Prokurorinë e Rrethit Elbasan, regjistruar me nr. ***, datë 3.4.2017, për vijimin e hetimit në ngarkim të OPGJ-së, i cili

⁶⁷ Të dhëna nga dokumentacioni i depozituar në raportin profesional të subjektit.

⁶⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.9.2020, administruar në raportin profesional të subjektit të rivlerësimit.

⁶⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.11.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

(sipas kallëzuesit) ka devijuar hetimet, dhe ekspertit (i cili sipas kallëzuesit ka arritur në konkluzion të rremë nën ndikimin e subjektit dhe OPGJ-së). Në vendimin e shpalljes së moskompetencës dhe kalimin e akteve arsyetohet se prokurorja Pranvera Stafa/subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë ushtruar ndikim të paligjshëm apo të ketë konsumuar elementet e ndonjë figure tjetër vepre penale. Nga aktet në dosje rezulton se është pyetur subjekti i rivlerësimit, ka dhënë deklaramë, si dhe ka provuar që nuk ka pasur ndonjë marrëdhënie fisnore me shtetasin L.Q.

iii. Prokurori i çështjes, edhe për vijimin e kallëzimit ndaj OPGJ-së dhe ekspertit, ka vendosur në datën 13.7.2017 pushimin e saj.

43.10 Për këtë çështje Komisioni nuk konstatoi fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në rivlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

43.11 Sipas raportit, nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka rezultuar se: (i) ndaj prokurores Pranvera Stafa nuk janë dhënë masa disiplinore; (ii) në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme janë gjetur vlerësimet e Prokurorit të Përgjithshëm për prokuroren Pranvera Stafa, që i përkasin punës së saj, për vitet 2012 vlerësuar “shumë mirë”, 2013 vlerësuar “shumë mirë”, 2014 vlerësuar “shumë mirë”, 2015 vlerësuar “shumë mirë” dhe 2016 vlerësuar “shumë mirë”. Gjithashtu, në arkiva janë gjetur edhe një numër i konsiderueshëm i certifikatave të trajnimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, kryesisht organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në kuadër të veprimtarisë së trajnimit vazhdues.

43.12 Bazuar në përgjigjet e ardhura nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, për kallëzimet penale rezulton se në ngarkim të saj nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

43.13 Sipas raportit ka rezultuar se në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme, për prokuroren Pranvera Stafa janë administruar ankesat në vijim:

a. Ankesa nr. *, viti 2018, e shtetasës N.D.** Në këtë ankesë ankuesja ka pretenduar nisje të procedimit penal për veprat penale “Korrupsioni i zyrtarëve publik dhe magjistratë”, si dhe “Mashtrim”, ndaj shtetasve A.D dhe të tjerë. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2018, i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke i bërë me dije se kjo ankesë i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, sot SPAK.

a/1. Komisioni, bazuar në dokumentacionin e depozituar në raportin profesional të subjektit, vëren se pretendimet e shtetasës N.D janë ngritur mbi mosgjydhjen e një çështjeje pronësore. Shtetasja D, lindur dhe banuese në Itali, ka bërë një sërë ankesash dhe kallëzime penale për shumë subjekte të rivlerësimit si në organin e akuzës, ashtu edhe në atë gjyqësor, përfshirë edhe për subjektin e rivlerësimit. Kjo shtetase në ankesën e saj, ndër të tjera, thekson se subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar realisht asnjë nga faktet e pretenduara prej saj, duke dëmtuar në këtë mënyrë të gjithë trashëgimtarët V.

a/2. Nga informacioni i dërguar nga SPAK-u⁷⁰ nuk konfirmohet administrim apo trajtim i kësaj ankese.

a/3. Komisioni për këtë çështje i kërkoi subjektit të shpjegojë dhe dokumentojë lidhur me pretendimet e znj. D, si dhe të konfirmojë statusin aktual të çështjes.

a/4. Në qëndrimin e saj subjekti ka parashtruar se shtetasja N.D pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar realisht asnjë nga faktet e pretenduara prej saj, duke dëmtuar në këtë mënyrë të gjithë trashëgimtarët V. Prokuroria e Rrethit Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. ***, ku në përfundim të hetimeve është vendosur pushimi i çështjes, pasi ka rezultuar që jemi përpara një

⁷⁰ Me shkresën nr. *** prot. plus një CD, datë 28.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

marrëdhënieje juridiko-civile. Ndaj vendimit për pushimin e çështjes është ushtruar ankimi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila ka prishur vendimin e pushimit dhe ka urdhëruar vazhdimin e hetimeve, duke urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore, që lidhen me pasojat juridike-civile dhe jo faktin penal. Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 19.12.2018, ka prishur vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe ka vlerësuar të bazuar në prova dhe në ligj, vendimin e prokurorisë për pushimin e çështjes.

a/5. Sipas subjektit, fakti i kallëzuar është hetuar në mënyrë shteruese, por në përfundim ka rezultuar se fakti nuk përbën veprë penale, por marrëdhënie juridiko-civile. Që hetimi ka qenë i plotë e ka konfirmuar edhe Gjykata e Apelit që ka vlerësuar si të bazuar në prova dhe në ligj vendimin e prokurorisë për pushimin e çështjes.

a/6. Komisioni, lidhur me këtë çështje, pas dërgimit të prapësimeve mbi rezultatin e dërguar dhe njohjes me shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar, konstatoi se dukej se: (i) nuk ishin kryer hetime të plota⁷¹ në drejtim të ekzistencës së faktit penal e konkretisht; (ii) nuk ishte verifikuar mbi vërtetësinë e korrespondencës me postë elektronike të shtetasit A.D dhe kallëzueses përmes këqyrjes së *email*-eve dhe kryerjes së ekspertizës së teknologjisë së informacionit; (iii) nuk ishte hetuar lidhur me faktin e njoftimit të revokimit të prokurës së pretenduar nga shtetasi A.D se ai nuk ishte njohur në kohë me këtë revokim; (iv) nuk ishin pyetur persona që mund të tregonin rrethana të hetimit; (v) nuk ishte hetuar lidhur me pretendimet e kallëzueses për kryerjen e veprimeve juridike fiktive me qëllim përfitimin e të drejtave pasurore, përfshirë këtu përfitimin e ndonjë të ardhure në favor të kallëzueses e familjes V, nga shitja e pasurive apo hetime në sistemin bankar; (vi) nuk ishte administruar kontrata e shitjes e lidhur midis shtetasve A.D e O.L, veprim ky i pasqyruar për t'u kryer në urdhrin e subjektit për kryerjen e veprimeve hetimore.

a/7. Në qëndrimin e saj lidhur me konstatimet e Komisionit, subjekti parashtrroi se në përfundim të hetimeve është marrë vendim për pushimin e çështjes, duke arsyetuar se fakti nuk përbën veprë penale të mashtrimit dhe falsifikimit të dokumenteve, por jemi përpara një mosmarrëveshjeje juridiko-civile, të lindur për shkak të lëshimit të një prokure përfaqësimi, të anuluar më vonë.

a/8. Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore kanë dalë të dhëna shtesë, si dhe janë marrë prova shtesë, të cilat kanë sqaruar plotësisht faktin e kallëzuar penalisht. Administrimi i këtyre provave të reja ka bërë që të hiqej dorë nga kryerja e një pjese e veprimeve hetimore të planifikuara në urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore. Këto veprime hetimore të planifikuara janë vlerësuar të panevojshme për t'u kryer, pasi provohej se nuk kishim të bënim me konsumim të elementeve të ndonjë veprë penale, por ishim përpara një marrëdhënieje juridiko-civile. Konkretisht, gjatë hetimit është mësuar se mbi të njëjtin fakt ishte hetuar edhe nga Prokuroritë Vlorë dhe Tiranë. Nga hetimi mbi faktin, Prokurorisë Elbasan i ka rezultuar se kemi të bëjmë me akte procedurale, për të cilat pretendohet se janë kryer nga përfaqësuesi i kallëzuesit jashtë tagrave të dhëna apo pa e pasur tagrin, për shkak të revokimit të prokurës. Personi i kallëzuar penalisht ishte fakt i dukshëm që ishte pajisur me prokurë nga kallëzuesja, por që pretendohet se më vonë kjo prokurë ishte revokuar.

a/9. Në vijim, subjekti parashtron se përdorimi i një prokure të revokuar në hartimin e dokumenteve noteriale, si dhe pretendimet e palëve në lidhje me përdorimin e këtyre akteve provonin se kishim të bënim me mosmarrëveshje të natyrës civile dhe nuk rezultonte të kishim të bënim me konsumim të elementeve të figurës së veprës penale “Mashtrim” apo “Falsifikimi i

⁷¹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 i ka kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën, si dhe për të depozituar kopje të plotë të vendimit nr. ***, datë 19.12.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe kopje të akteve që pasqyrojnë veprimet hetimore të kryera nga ana juaj për këtë çështje së bashku me kopje të plotë të kërimit tuaj në gjykatë pas kryerjes së hetimeve.

dokumenteve”, konkluzion ky plotësisht në përputhje me përfundimin në të cilin kishte arritur edhe Prokuroria e Rrethit Vlorë. Duke qenë se deklaratimet e personave të pyetur dhe dokumentacioni i administruar ishin të plota për zgjidhjen e drejtë të çështjes, është hequr dorë nga pyetja e personave dhe marrja e dokumentacionit të planifikuar në urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, pasi kryerja e këtyre veprimeve hetimore ishte qartësisht e panevojshme. Është bërë verifikimi i korrespondencës me postë elektronike të shtetasës N.D me shtetasin A.D. Ata kanë pasur komunikim në datat 16.3.2010, 14.4.2010, 15.4.2010 dhe 25.4.2010. Nga përkthimi i përmbajtjes së këtyre *email*-eve rezulton se bëhet fjalë për revokim të një prokure të bërë nga znj. M.L e datës 15.3.2010. Lidhur me këto *email*-e, i kallëzuari A.D ka deklaruar se nuk i ka parë dhe nuk i ka lexuar asnjëherë më parë. Këto prova janë vlerësuar në harmoni me provat e tjera për zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

a/10. Sipas subjektit, hetimi ka provuar se marrëdhëniet e krijuara midis shtetasës N.D dhe shtetasit A.D janë marrëdhënie të posaçme të lindura mbi bazë të prokurave të lëshuara apo të dhëna nga shtetasja N.D dhe problematikat e lindura midis tyre për shkak të këtyre prokurave janë objekt i marrëdhënieve të fushës juridiko-civile, të cilat mund dhe duhet të gjejnë zgjidhje dhe kanë gjetur zgjidhje në fakt në gjykatë në rrugë civile.

a/11. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka prishur vendimin për pushimin e procedimit penal nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Elbasan, duke vlerësuar se duhet zgjidhur mosmarrëveshja lëndore, pasi mbi këtë fakt po hetonte edhe Prokuroria për Krime të Rënda. Po kështu, ka vlerësuar se duhen pyetur shtetasit O.L dhe TH.B, si dhe nuk është administruar kontrata e shitjes mes shtetasve A.D dhe O.L dhe nuk janë kryer hetime në lidhje me likuidimin e vlerave monetare apo përfitimin e të ardhurave nga trashëgimtarët V. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga Prokuroria e Rrethit Elbasan dhe të gjitha palët e interesuara në Gjykatën e Apelit Durrës.

a/12. Prokuroria ka ankimuar vendimin me arsyetimin se hetimet kanë qenë të plota dhe me provat e grumbulluara provohej tej çdo dyshimi se nuk kishim të bënim me konsumim të elementeve të ndonjë vepre penale, por ishim përpara një marrëdhënieje juridiko-civile, pasojat e së cilës zgjidheshin në rrugë gjyqësore. Detyrat e lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan në kuadër të vendimit për prishjen e vendimit të pushimit të çështjes penale nuk i shërbenin provueshmërisë së faktit nëse kemi apo jo të bëjmë me konsumim të elementeve të ndonjë vepre penale, por ishin detyra hetimore që i shërbenin vetëm zgjidhjes civile të mosmarrëveshjes, ku në fakt një zgjidhje e tillë i takonte hetimit gjyqësor në proces civil.

a/13. Me vendimin nr. ***, datë 19.12.2018, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 27.8.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Rrëzimin e kërkesës së kërkuases N.D, duke lënë në fuqi vendimin për pushimin e çështjes penale nr. ***. Gjykata e Apelit Durrës, ndër të tjera, ka vlerësuar dhe arsyetuar se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe vendimi i pushimit të çështjes nga prokurori duhet të lihet në fuqi. Kontrolli gjyqësor është i kufizuar në të drejtën për të kërkuar hetime të mëtejshme në çështje konkrete. Gjykata e Shkallës së Parë ka detyruar organin e akuzës të kryejë veprime hetimore, të cilat nuk janë në kompetencë të saj.

a/14. Trupi gjykues, pasi analizoi faktet konkrete të kësaj çështjeje në raport me pretendimet e subjektit, çmon se, në rastin konkret, nga subjekti nuk janë kryer veprime hetimore të rëndësishme dhe të logjikshme për qartësimin e rrethanave të kallëzimit penal. Në këtë çështje, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit duket se ka orientuar interpretimin e të dhënave të kallëzimit drejt një mosmarrëveshjeje civile, si dhe ka kufizuar hetimin, duke u bazuar në mosmarrëveshjet civile që palët kanë procesuar në gjykatë, me objekt pavlefshmëri të veprimeve “kontratë shitjeje

pasurish”, duke mos konsideruar ekzistencën e fakteve penale ose nevojën për ndjekje penale të faktit penal të kallëzuar të veprave penale “Mashtrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve” sipas neneve 143 e 186 të Kodit Penal, apo veprave penale të tjera, të mundshme.

a/15. Lidhur me faktin penal të kallëzuar, në rrethanat konkrete të çështjes, trupi gjykues konstaton se nga ana e subjektit nuk janë kryer hetime lidhur me faktin konstatues se pas revokimit të prokurës në datën 24.3.2010, brenda një harku kohor të shkurtër prej 8 ditësh shtetasi A.D ka disponuar një numër të madh pronash të trashëgimtareve, duke ia shitur të njëjtit person, duke përfituar si çmim për të gjitha pasuritë e shitura shumën 75.303.050 lekë, për të cilën pala kallëzuese ka pretenduar se ajo nuk ka përfituar asnjë shumë të ardhurash. Ky hetim, më së paku do të provonte/zbardhte faktin nëse veprimet e kryera ishin fiktive, me qëllim përfitimin e pasurive. Mosveprimi i subjektit në këtë moment, në vlerësimin e trupit gjykues, mbetet i pajustificuar, për më tepër kur nga përgjimet ambientale të kryera nga trashëgimtarët, i kallëzuari ka pohuar se veprimet në kontratat e shitblerjeve të pasurive janë fiktive. Nuk rezulton që nga ana e subjektit të jenë kryer veprime hetimore lidhur me faktin e përfitimit të shumave, transaksione *cash* apo me bankë, për më tepër kur hetimi i Prokurorisë së Krimeve të Rënda ka evidentuar faktin se nuk rezultonte asnjë dokument që të provonte dhënien e ndonjë shume nga paratë e përfituara në favor të trashëgimtarëve V.

a/16. Po ashtu, trupi gjykues ndan të njëjtin mendim me arsyetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan se nga ana e subjektit duhej të verifikohej nëse njoftimi i revokimit të prokurës ishte nisur me postë elektronike nga adresa e kallëzueses në datën e përcaktuar prej saj apo në datë tjetër njoftimi. Në këtë pikë, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin për të verifikuar momentin e njoftimit të revokimit të prokurës, përmes këqyrjeve të *email*-eve, marrjen e informacioneve të nevojshme përmes ekspertëve të teknologjisë së informacionit, ku më së paku do të ishte provuar vërtetësia e pohimeve/deklarimeve të shtetasve që kallëzohen apo të kallëzueses.

a/17. Në drejtim të verifikimit të njoftimit të revokimit të prokurës rezulton se subjekti nuk ka pyetur persona që tregojnë rrethana të hetimit sikurse ishte shtetasja E.T, lidhur me pohimet e saj në procedimin penal të zhvilluar në Vlorë në vitin 2014 dhe zbardhjen e vërtetësisë së këtyre pohimeve e rrethanave që deklaroheshin.

a/18. Këto hetime apo edhe përmbushja e veprimit hetimor për administrimin e kontratës së lidhur midis shtetasve A.D e O.L, të pasqyruar në urdhrin e kryerjes së veprimeve hetimore, në vlerësimin e trupit gjykues do të kishin qartësuar rrethanat e kallëzimit penal, pavarësisht rezultatit përfundimtar.

a/19. Sa i takon pretendimit të subjektit se vendimi i pushimit të saj është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, trupi gjykues çmon se kjo gjykatë⁷² nuk ka zhvilluar gjykim në themel të çështjes, sa i përket vlerësimit të veprimtarisë hetimore të subjektit.

a/20. Në përfundim, lidhur me këtë çështje, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimi:

- i. Nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin, duke mos kryer një hetim të plotë e të thelluar për të siguruar prova konkrete të cilat do të mund të konfirmonin dyshimin (e ngritur në kallëzim) apo do ta rrëzonin atë, por duke bërë qartësi mbi dinamikën e ngjarjeve – çka ka munguar

⁷² Kjo gjykatë, në këtë drejtim ka arsyetuar se ankimi i znj. N.D në gjykatë, paraqitur në kohën që ka qenë në fuqi Kodi i Procedurës Penale pa ndryshimet e vitit 2017, neni 329/6, është dispozitë jofavorizuese për ankuesit, pra, kur gjykata vendos kthimin e akteve për hetim nuk lejohet ankimi.

(pasi gjithë vlerësimi i subjektit është kanalizuar në rrafshin civil), duke passjellë pasoja konkrete në ecurinë e procedimit në fjalë.

- ii. Nuk ka kryer analizë gjithëpërfshirëse dhe në harmoni me faktet dhe nevojat hetimore të materialeve ekzistuese në dosje për të zbardhur të vërtetën, në këtë mënyrë duke shfaqur mangësi domethënëse në drejtim të përmbushjes së kriterit ligjor sipas pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet: *“Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndër marrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën”*.

b. Ankesë⁷³ e shtetases S.S. Në ankesë rezulton se ankuesja ka pretenduar se bashkëshorti i saj N.S ka braktisur fëmijët prej 5 vjetësh, si dhe ka pretenduar se kunati i saj A.S i ka pushtuar tokën. Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2013, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke i bërë me dije se ankesa e saj i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Lidhur me këtë çështje, në dokumentacionin e depozituar në raportin profesional të KLP-së për subjektin e rivlerësimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan⁷⁴ informon Prokurorinë e Përgjithshme se për ankesën nr. *** prot., datë 25.3.2013, është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 1.10.2012, i cili është dërguar për gjykim në datën 28.12.2012 me të pandehur shtetasin N.S, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal.

b/1. Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit⁷⁵: (i) të shpjegojë dhe dokumentojë pozitën e saj lidhur me çështjen e ankuar nga shtetasja S (gjithnjë nëse çështja ishte hetuar prej saj); (ii) të qartësojë dhe dokumentojë statusin aktual.

b/2. Subjekti, në përgjigjen e dhënë, ka shpjeguar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan më 1.10.2012 ka regjistruar procedimin penal nr. *** mbi bazën e materialit kallëzues të shtetases S.S dhënë në Komisaratin e Policisë Librazhd dhe materialit hetimor të referuar me nr. ***, datë 27.9.2012. Procedimi penal nr. ***, viti 2012, është regjistruar për veprën penale “Braktisja e fëmijëve të mitur”, parashikuar nga neni 124 i Kodit Penal. Po atë ditë është nxjerrë urdhër për kryerjen e veprimeve. Në datën 4.10.2012 janë përpiluar shkresat për marrje informacionesh në kuadër të detyrave të lëna. Mbi bazën e deklaramit të heqjes dorë të subjektit nga hetimi i këtij procedimi penal, bazuar në nenin 17, pika 1, shkronja “c”, nenet 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale, drejtuesi i prokurorisë i asaj kohe me vendim datë 22.10.2012 ka vendosur zëvendësimin e saj me prokuror tjetër që ushtronte funksionet në këtë prokurori, i cili, që nga ky moment ka vazhduar më tej hetimet për procedimin penal nr. ***, viti 2012. Subjekti ka deklaruar se prej saj nuk janë kryer veprime hetimore lidhur me këtë procedim penal. Shkaku i heqjes dorë prej subjektit ka qenë fakti se në vitin 2009 kjo shtetase ka paraqitur kallëzim penal për të njëjtin fakt objekt hetimi, për të cilin është regjistruar fillimisht procedimi penal nr. ***, viti 2012, ku prej saj ishte hetuar dhe ishte disponuar me një vendimmarrje përkatëse në atë kohë. Subjekti shpjegon se për këtë shkak ajo ka hequr dorë nga hetimi i procedimit penal nr. ***, viti 2012. Subjekti deklaroi se nga aktet e fashikullit rezulton se procedimi penal nr. ***, viti 2012, në datën 28.12.2012 është dërguar në gjykim me të pandehur shtetasin N.S, akuzuar për veprën penale “Keqtrajtimi i të miturve”, parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal. Ajo ka

⁷³ Nr. ***, viti 2018.

⁷⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.3.2013, administruar në raportin profesional të subjektit.

⁷⁵ Me pyetësin nr. 3, datë 12.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

konfirmuar edhe lidhur me statusin e çështjes. Subjekti ka deklaruar se me vendimin nr. ***, datë 1.4.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është vendosur “Deklarimi fajtor i këtij shtetasi për veprën penale “Keqtrajtimi i të miturve”, parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 20.5.2013. Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 15.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nga ku konfirmohet ky fakt.

b/3. SPAK-u⁷⁶, ndër të tjera të dhëna të pasqyruara në këtë material, ka konfirmuar regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 9.11.2016, në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, mbi bazën e materialit hetimor të DPPolicisë, nga përmbajtja e të cilit disponohet informacion për veprimtari të kundërligjshme në Sistemin e Drejtësisë. Procedimi është regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal dhe pa emër të regjistruar nën hetim. Pas përfundimit të hetimeve në datën 11.1.2017 është vendosur pushimi i procedimit penal. SPAK-u ka përcjellë edhe CD-në përkatëse. Nga njohja me materialin për këtë çështje rezultoi se janë kryer veprime hetimore lidhur me përgjimin e numrave të telefonit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit L.M, i cili akuzohej për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor në një aksident të ndodhur në qytetin e Elbasanit. Nga informacioni i mbledhur nuk kanë rezultuar të dhëna me interes për hetimin. Organi i akuzës i përfaqësuar në këtë çështje nga subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dënimin e këtij shtetasi me gjobë në shumën 60.000 lekë, ndërsa dyshohej se i akuzuari ka mbetur i pakënaqur nga vendimmarrja, pasi kishte mbajtur më parë kontakte me bashkëshortin e saj B.S, që ky i fundit të ndikonte tek bashkëshortja/subjekti i rivlerësimit për favorizim të tij për të pasur një tjetër vendim dhe jo atë me gjobë.

b/4. Nga analiza e rrethanave të kësaj çështjeje, Komisioni nuk konstatoi fakte apo rrethana të cilat implikonin pozitën e subjektit dhe, për pasojë, nuk konkludoi në arsye që mund të ndikojnë në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit.

c. Ankesa nr. *, viti 2018, e shtetasit P.B.** Në këtë ankesë ankuesi, i cili është administrator i një shoqërie, kishte paraqitur një kallëzim penal kundër shoqërisë “L” ndaj së cilës pretendon për moszbatim të kontratës nga kjo e fundit. Në lidhje me këtë kallëzim penal organi i prokurorisë kishte vendosur pushimin e procedimit. Për këtë shkak, ankuesi kishte paraqitur një ankesë në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 19.9.2018, i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke i bërë me dije se ankimet kundër vendimeve të prokurorit bëhen vetëm në gjykatë.

Ky rast është trajtuar më poshtë, tek denoncimet e depozituara për subjektin e rivlerësimit.

ç. Ankesa nr. *, viti 2019, e shtetasit R.B.** Në këtë ankesë ankuesi ka pretenduar se në lidhje me çështjen penale që ka qenë duke e hetuar prokurorja Pranvera Stafa, në të cilën ai ka qenë viktimë e veprës penale, ka zvarritur hetimet dhe, për këtë shkak, ka kërkuar përjashtimin e këtij prokurori dhe zëvendësimin e tij me një prokuror tjetër. Kjo kërkesë rezulton të jetë pranuar nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin e datës 20.3.2019. Ky rast është trajtuar më poshtë, tek denoncimet e depozituara për subjektin e rivlerësimit.

Në lidhje me denoncimet e depozituara në Komision, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se janë paraqitur denoncimet sa më poshtë referuar/trajtuar.

44. Denoncim⁷⁷ i shtetasit H. A. S (i përsëritur)

⁷⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁷ Nr. *** prot., datë 13.8.2021, administruar në dosjen e Komisionit; nr. *** prot., datë 12.8.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

44.1 Shtetasi H.S ankohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetim të plotë për kallëzim të veprës penale të falsifikimit dhe përdorimit të dokumentacionit të falsifikuar dhe, si pasojë, ka vendosur për mosfillimin e procedimit penal të materialit hetimor nr. *** regj., datë 29.4.2015.

44.2 Denoncuesi pretendon se me vendimin për mosfillim të procedimit penal, subjekti i rivlerësimit ka favorizuar dhe është bërë palë me personat e kallëzuar prej tij. Denoncuesi pretendon se “Vërtetimi dokumenti hipotekor” i datës 21.8.2000, dokument i lëshuar nga ish-punonjësi i ZVRPP-së Elbasan, shtetasi Z.Z, i cili përmban të dhëna për regjistrin hipotekor nr. ***, ku figuron e regjistruar prona në pronësi të shtetasit H.A.P, është i falsifikuar. Shtetasit S. dhe P. kanë kërkuar ndër vite zgjidhjen e konfliktit për pronën, duke filluar nga shkalla e parë e gjyqësorit deri tek Gjykata Kushtetuese. Vendimi i fundit gjyqësor është ai i Gjykatës Administrative të Apelit Durrës nr. ***, datë 7.5.2014, i cili ka vendosur të lërë në fuqi vendimin nr. ***, datë 2.5.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe regjistrimin e pasurisë nr. *** dhe nr. *** truall në emër të shtetasit P. dhe pajisjen e tij me certifikatë pronësie nga ZVRPP-ja Elbasan. Denoncuesi ka bashkëlidhur me denoncimin e tij disa dokumente⁷⁸.

44.3 Komisioni, në bazë të dokumentacionit të depozituar nga denoncuesi, konstatoi se çështja i përket një konflikti pronësor. Denoncuesi konteston aktet e dhëna nga hipoteka në favor të palës kundërshtare, duke pretenduar se janë false. Ai ka kallëzuar punonjës të ZVRPP-së për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar në nenin 186 të Kodit Penal. Materiali hetimor është regjistruar nga organi i akuzës me nr. *** regjistri, datë 29.4.2015. Çështja e konfliktit duket të ketë ndjekur edhe rrugët gjyqësore deri edhe në gjykatën më të lartë.

44.4 Mbi pretendimet e denoncuesit të bëra në drejtim të ish-punonjësit të ZVRPP-së Elbasan Z.Z për lëshim të dokumentacionit fals, subjekti i rivlerësimit në vendimin e saj është shprehur se nga koha kur është lëshuar ky dokument në vitin 2000 kanë kaluar 15 vjet dhe është jashtë çdo mundësie për ndjekje penale për shkak të afateve të parashkrimit për këtë veprë penale, afate të parashikuara në nenin 66 të Kodit Penal.

44.5 Konstatohet se kallëzimi i shtetasit A. S është regjistruar në datën 29.4.2015 dhe subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin për mosfillim të procedimit penal në datën 14.7.2015 (pas 75 ditësh). Sipas Kodit të Procedurës Penale vendimi për mosfillim të procedimit penal rezulton në tejkalim të afatit kohor për kryerjen e hetimit.

44.6 Komisioni e ka pyetur subjektin⁷⁹ lidhur me tejkalimin e afatit për marrjen e vendimit të mosfillimit, si dhe për statusin e çështjes. Në përgjigjen e dhënë, subjekti ka deklaruar mbi veprimet hetimore të kryera deri në datën 14.7.2015, kohë kur edhe ka marrë vendimin për mosfillimin e materialit hetimor nr. *** regj., datë 29.4.2015. Subjekti ka sqaruar se çështja kishte të bënte me një konflikt pronësor. Me qëllim verifikimin e faktit, subjekti ka deklaruar se pavarësisht se nuk kishte të dhëna për regjistrim procedimi penal, janë kryer verifikimet përkatëse, duke këqyruar dokumente dhe duke marrë dokumente, me qëllim përcaktimin e saktë nëse ishin apo jo para elementeve të ndonjë veprë penale të parashikuar nga Kodi Penal. Subjekti e ka pranuar tejkalimin e afatit, por ka theksuar se ky është një rast sporadik.

44.7 Subjekti ka sqaruar se vendimi është kontrolluar edhe nga Prokuroria e Përgjithshme mbi bazë të ankimit të shtetasit S, vendim i cili ka mbetur në fuqi me arsyetimin se nga ana e kësaj prokurorie janë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe të duhura hetimore, nuk ka vend për të

⁷⁸ Kartën e identitetit; vendimin për mosfillimin e procedimit penal datë 14.7.2015 nga subjekti i rivlerësimit; kallëzimin nr. ***, datë 29.4.2015; kallëzimin (plotësim i kallëzimit të datës 29.4.2015), si dhe dokumentacionin që i përket pasurisë objekt konflikti.

⁷⁹ Me pyetësin nr. 2, datë 10.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

kryer ndonjë veprim tjetër hetimor dhe se vendimi i mosfillimit është i bazuar në ligj, përfundim me të cilin është njohur edhe ankuesi.

44.8 Subjekti ka konfirmuar se ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim në gjykatë dhe për të provuar këtë fakt ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

44.9 Në lidhje me tejkalimin e afatit 30 ditë të marrjes së vendimit, subjekti ka sqaruar se e ka pasur të pamundur të përfundonte verifikimin brenda afatit, nisur edhe nga ngarkesa e lartë në punë, por edhe sepse për realizimin e këqyrjes duhej të bëhej në atë kohë edhe bashkërendimi me ZVRPP-në Elbasan për të pasur punonjës disponibël për kryerjen e këtij veprimi.

44.10 Subjekti ka sqaruar se volumi i lartë i kallëzimeve penale dhe mosregjistrimi i procedimit penal kur dukshëm vepra penale nuk ekziston, detyron marrjen e vendimit tej afatit 30-ditor, në detyrim për verifikimin e plotë të tij.

44.11 Subjekti ka depozituar vendim mosfillimi datë 14.07.2015, shkresat e përpiluara nga OPGJ-ja, shkresën e kërkimit të akteve nga shtetasi A.S, datë 14.4.2016, shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë nr.*** prot, datë 12.11.2015, si dhe shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

44.12 Në analizë të fakteve dhe rrethanave të rezultuara, Komisioni⁸⁰ i kaloi subjektit barrën e provës, pasi konstatoi se dukej se: (i) mbetej evident tejkalimi i afatit 30-ditor për dhënien e vendimit të mosfillimit të materialit kallëzues; (ii) në këtë rast denoncuesi pretendon qartë se dokumenti ishte përdorur nga i kallëzuari në disa procese gjyqësore ndër vite, ndërsa dukej se nga ana e subjektit nuk ishte hetuar për përdorimin e një dokumenti të falsifikuar, si pjesë e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”. Kjo moskryerje e veprimeve hetimore duket se ka sjellë mungesën e hetimit të plotë dhe zbardhjen e rrethanave të rastit dhe, për rrjedhojë, edhe mosndjekjen e duhur penale.

44.13 Në qëndrimin e saj lidhur me konstatimet e Komisionit subjekti ka parashtruar se nuk është kaluar afati 30-ditor për dhënien e vendimit mbi mosfillimin e procedimit penal, pasi prokurori brenda këtij afati ka vlerësuar se nuk ka pasur vend për regjistrimin e ndonjë procedimi penal, pasi sa pretendonte kallëzuesi ishte zgjidhur me vendim gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit. Në mënyrë që fashikulli i verifikimit të kallëzimit penal të ishte i plotë, ky fashikull është plotësuar edhe me aktet e kërkuara me shkresë në favor të këtij kallëzimi.

44.13.1 Sipas subjektit, kjo çështje nuk ka qenë në hetim, por në verifikim. Duke qenë se nuk plotësoheshin kushtet dhe kriteret ligjore për regjistrimin e procedimit penal, pasi nuk ekzistonin të dhëna për konsumim të elementeve të ndonjë figure vepre penale. Nga ana e prokurorisë, me qëllimin që verifikimi të ishte shterues, është pritur ardhja e dokumentacionit të kërkuar dhe pas mbërritjes së dokumentacionit është dokumentuar vendimi për mosfillimin e procedimit penal. Çështja kishte të bënte me një konflikt pronësor, pra ishte një marrëdhënie juridiko-civile, pasojat e së cilës zgjidhen në proces gjyqësor civil.

44.13.2 Sipas subjektit, vendimi i mosfillimit është kontrolluar nga Prokuroria e Përgjithshme mbi bazë të ankimit të shtetasit A.S. Vendimi i mosfillimit është gjetur i bazuar në ligj, përfundim me të cilin është njohur edhe ankuesi. Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim në gjykatë, provuar me shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

⁸⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Përgjithshëm Elbasan. Me vendimin gjyqësor që kishte marrë formë të prerë, pretendimet e shtetasit A.S, të ngritura në kallëzim penal, ishin gjetur të padrejta.

44.13.3 Subjekti ka shpjeguar se nëse do kishte rezultuar përdorim dokumenti të falsifikuar në proces gjyqësor civil, gjyqtari do të kishte referuar materialin në prokurori, pasi ka detyrim ligjor. Nëse do kishim të bënim me dokument të falsifikuar të përdorur në gjykatë, S, duke përmendur procesverbalin e seancës gjyqësore civile, ku ishte pasqyruar ky fakt i konstatuar nga gjykata, do e kishte sjellë për ta bërë pjesë të fashikullit hetimor. Në rastin konkret nuk jemi përpara rrethanave të tilla. Nuk ka pasur të dhëna për konsumim të veprës penale, ndaj nuk është regjistruar procedim penal.

44.13.4 Trupi gjykues, pasi analizoi rrethanat konkrete të kësaj çështjeje, si dhe pas shqyrtimit të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se shpjegimet e saj nuk janë të qarta, si dhe konstaton se subjekti duket se ka kufizuar e orientuar interpretimin e të dhënave të kallëzimit drejt një mosmarrëveshjeje civile për sa më poshtë arsyetohet:

i. Lidhur me tejkalimin e afatit për dhënin e vendimit të mosfillimit, trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit subjekti e ka pranuar këtë konstatim duke parashtruar se ajo e ka pasur të pamundur të përfundonte verifikimin brenda afatit, nisur edhe nga ngarkesa e lartë në punë, por edhe sepse për realizimin e këqyrjes duhej të bëhej në atë kohë edhe bashkërendimi me ZVRPP-në Elbasan, për të pasur punonjës disponibël për kryerjen e këtij veprimi, ndërsa në prapësime subjekti ka pretenduar se nuk është kaluar afati 30-ditor për dhënien e vendimit mbi mosfillimin e procedimit penal, pasi prokurori brenda këtij afati ka vlerësuar se nuk ka pasur vend për regjistrimin e ndonjë procedimi penal, pasi sa pretendonte kallëzuesi ishte zgjidhur me vendim gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit.

ii. Trupi gjykues vëren se vendimi i mosfillimit është marrë jashtë afatit 15-ditor të përcaktuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nga hetimi provohet që kallëzimi i shtetasit A. S është regjistruar në datën 29.4.2015 dhe se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin për mosfillim të procedimit penal në datën 14.7.2015, pra pas 75 ditësh.

iii. Trupi gjykues, referuar të dhënave të dala në këtë dosje, çmon se nga ana e subjektit nuk është hetuar për përdorimin e një dokumenti të falsifikuar, i cili është pjesë e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, nga subjekti duket se nuk janë kryer veprime hetimore të logjikshme dhe të hollësishme për zbardhjen e rrethanave të rastit përtej qëndrimit përfundimtar që do të sillnin veprimet hetimore.

iv. Bazuar në të dhënat e përfituara në këtë çështje objekt vlerësimi, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit:

a) Nuk ka hetuar në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse, për të mbërritur vërtetësinë e faktit se mbi bazën e cilit veprimi juridik u lëshua nga ish-punonjësi i ZVRPP-së Elbasan dokumenti “Vërtetim hipotekor”, datë 21.8.2000, i cili përmbante të dhëna për regjistrin hipotekor nr. ***, ku figuronte e regjistruar në pronësi të shtetasit H.A.P prona truall për sip. 405 m² në kushtet që origjina fillestare e pasurisë së z. P. rezultonte me dokumentin “Akt pjesëtimi”, ku përcaktohej se ai zotëronte 324 m² truall “në përdorim”.

b) Nuk ka hetuar lidhur me dyshimin e dokumentit të falsifikuar dhe përdorimin e tij në procesin gjyqësor në vitin 2004.

c) Nuk ka hetuar shkaqet që çuan Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të bëjë fshirjen në vitet 2009 e 2010 nga regjistri hipotekor të dokumentit “Vërtetimi hipotekor” i lëshuar në datën

21.8.2000 dhe kalimin në gjendjen e mëparshme. Moskryerja e këtij hetimi lidhur me pasqyrimin e rrethanave të vërteta ose jo ka pas sjellë përdorimin e tij në proceset gjyqësore.

ç) Nuk ka hetuar në drejtim të përdorimit të dokumentit të pretenduar i falsifikuar, i paraqitur nga shtetasi H.P në Agjencinë e ALUIZNI-t Elbasan, ku konstatohet se në dokumentin “formular i deklaramentit për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje/dhe ose shtesës së ndërtimit me leje, datë 22.1.2015”, ky shtetas ka deklaruar se ka truall në pronësi, ndërkohë këtë të drejtë e ka fituar vetëm në datën 6.3.2015 me vendimin nr.***, datë 6.3.2015 “Për tjetërsimin e sipërfaqes së oborrit në përdorim”. Në këtë rast, subjekti ka pasur të dhënën e dalë nga dokumenti relacion i regjistruarit datë 22.5.2015, ku pasqyrohet fakti se: “...kjo pasuri figuron e regjistruar në kartelën e pasurisë nr. ***, faqe 29, me sipërfaqe të përgjithshme 405 m² dhe nr. pasurie *** me pronar shtetasin H.P, e në seksionin e kartelës së kësaj pasurie ka shënimin e çregjistrimit të kësaj pasurie e anulimin e këtij regjistrimi për faktin se origjina e kësaj pasurie është truall në përdorim dhe nga ana e zyrës është bërë regjistrimi i saj në pronësi”.

d) Trupi gjykues konstaton se arsyetimi i subjektit në vendimin e mosfillimit për këtë material hetimor, i fokusuar tek marrëdhënia juridiko-civile dhe instituti i parashkrimit për veprën penale “Falsifikimi i dokumentit”, duket se cenon cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit, në raport me faktin penal të kallëzuar që konsistonte në përdorimin nga shtetasit e kallëzuar të dokumentit të falsifikuar në proceset gjyqësore nga viti 2004 e vijim. Në ndryshim nga fokusi i subjektit në hetimin e kësaj çështjeje, rrethanat e konstatuara tregojnë se nëse do të ishte konkluduar shkencërisht për falsitetin e dokumentit dhe kohën e përdorimit të tij, atëherë do të ishte i ndryshëm edhe vlerësimi i institutit të parashkrimit për këtë veprë penale.

dh) Trupi gjykues në këtë çështje objekt vlerësimi çmon se vetëm përmes hetimit për përdorimin e dokumentit të pretenduar të falsifikuar do të zbardheshin rrethanat e faktit penal të kallëzuar, në kuptim të nenit 186/1 të Kodit Penal në formën e përdorimit, ku më së paku në këtë çështje duhej se provohej përdorimi i aktit, por njëkohësisht po përmes hetimit duhej të vërtetohej se akti i përdorur përmbante ose jo të dhëna të rreme, në mënyrë që të evidentohej edhe qëllimi i fitimit apo çdolloj interesi tjetër personal nga përdorimi i këtij dokumentacioni të falsifikuar⁸¹, ose në të kundërt të konstatohej mungesa e veprave apo e përgjegjësisë penale (por pasi të ishin administruar e analizuar dokumentet përkatëse e të ishin kryer hetime të plota e gjithëpërfshirëse, të cilat kanë munguar).

e) Në përfundim për këtë çështje, trupi gjykues çmon se duket se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, të arsytimit ligjor dhe cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit dhe moskryerjes së të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme sipas parashikimeve të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 dhe, për pasojë, kjo çmuarje duhet të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

45. Denoncim⁸² i shtetasit B.Ç

45.1 Denoncuesi ankohet se është dënuar dhe po vuan dënimin pa të drejtë për veprën penale “Bashkëpunëtor në vrasje”. Me denoncimin e tij shtetasi Ç ka bashkëngjitur: vendimin nr. ***, datë 28.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; vendimin nr. ***, datë 7.7.2011, të Gjykatës së Apelit, i cili lë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; si dhe një kronologji të proceseve gjyqësore të zhvilluara për këtë çështje.

⁸¹ Shihni vendimin nr. ***, datë 16.6.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

⁸² Nr. *** prot., datë 7.11.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

45.2 Nga materiali i depozituar u konstatua se subjekti i rivlerësimit përmendet vetëm në materialin kallëzues të denoncuesit.

45.3 Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se nuk identifikohen fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, ku kryesisht duket se ankesa vë theksin në trajtimin e themelit të çështjes.

46. Denoncim⁸³ i shtetasit R.B⁸⁴

46.1 Në denoncimin pranë Komisionit, shtetasi R.B ankohet kundrejt disa subjekteve të rivlerësimit, ndër ta edhe për subjektin e rivlerësimit objekt hetimi, të cilët me veprimet apo mosveprimet e tyre kanë lënë të lirë vjedhësit e pasurisë së tij familjare.

46.2 Denoncuesi sqaron se në janar të vitit 2018 i kanë grabitur një sasi të konsiderueshme cigaresh të magazinuara në shtëpinë e prindërve të tij në P të qytetit të Librazhdit. Pas ngjarjes ai ka mundur të identifikojë autorët e grabitjes dhe në datën 11.1.2018 ka paraqitur kallëzim penal për grabitësit. Në datën 22.1.2018 është regjistruar procedimi penal për veprën penale “Vjedhja”. Në datën 16.1.2018 janë sekuestruar cigaret e vjedhura të gjendura në dyqanet e shtetasve I.B dhe L.K, si dhe janë marrë mostra për të kryer aktin e ekspertimit të tyre.

46.3 Në denoncimin e tij, shtetasi R.B ankohet se: (i) ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit informacion për aktet dhe kryerjen e veprimeve hetimore, por nuk ka marrë asnjë informacion; (ii) nga subjekti nuk është vendosur lidhur me ekspertimin teknik të USB-ve. Ai sqaron se për këto arsye nga data 26.6.2018 e në vazhdim ka kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit, kërkesë e pranuar nga prokuroria pas shumë refuzimesh, në datën 20.3.2019. Edhe me zëvendësimin e subjektit rivlerësues denoncuesi thekson se nuk ka gjetur zgjidhje.

46.4 Pranë Komisionit është depozituar vetëm ankesa e shtetasit R.B. Problematika e kësaj çështjeje është trajtuar edhe në median *online* në emisionin investigativ “****”⁸⁵.

46.5 Komisioni e ka pyetur subjektin⁸⁶ lidhur me pretendimet e denoncuesit. Në përgjigjen e dhënë subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbi bazën e vendit të ngjarjes, materialit hetimor nr. ***, datë 16.1.2018, të paraqitur në prokurori nga Komisariati i Policisë Librazhd dhe të regjistruar me nr. *** regj., datë 17.1.2018, më 22.1.2018 ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2018, për veprën penale “Vjedhje”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, pa autor.

46.6 Subjekti ka sqaruar se kërkesat e denoncuesit nëpërmjet avokatit të tij mbrojtës janë bazuar në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale, që lidhen me të drejtat e viktimës për t’u njohur me aktet dhe jo kërkesa të bëra në bazë të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, ku në rast të kërkesave memorie, sikurse e parashikon neni 110 i Kodit të Procedurës Penale, prokurori del me vendim për pranimin ose jo të kërkesave të tij. Për këtë arsye, ka shpjeguar subjekti, për këto kërkesa kallëzuesi nuk ka marrë përgjigje me shkrim.

⁸³ Nr. *** prot., datë 6.9.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸⁴ SPAK-u, me shkresën nr. *** prot., datë 28.12.2023, ka konfirmuar se pranë Prokurorisë për Krime të Rënda është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 12.7.2018, i këtij shtetasi në adresë të subjektit të rivlerësimit dhe pas verifikimeve në datën 23.7.2018 është vendosur mosfillimi i këtij procedimi. Po ashtu, SPAK-u po këtë shkresë ka konfirmuar se pranë Prokurorisë për Krime të Rënda është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 16.9.2019, i këtij shtetasi në adresë të subjektit të rivlerësimit dhe pas verifikimeve në datën 30.9.2019 është vendosur mosfillimi i këtij procedimi.

⁸⁵ https://s***.tv***.al/vjedhja***

⁸⁶ Me pyetësin nr. 2, datë 10.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

46.7 Subjekti ka deklaruar se kërkesat e denoncuesit në organin e prokurorisë janë përsëritje të njëra-tjetrës, ku vetë objekti i kërkimit është “Ripërsëritje kërkesë”, bazuar të gjitha në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale.

46.8 Subjekti ka sqaruar se veprimet hetimore të sugjeruara, të pretenduara apo të kërkuara prej tij, janë kryer plotësisht. Subjekti ka renditur veprimet hetimore të kryera si, ekspertimin doganor, analizën e tabulateve telefonike, marrjen e qelizave nga kompanitë telefonike celulare që operojnë në vendin tonë, akte ekspertimi, procesverbale deklarime, përgjime etj., veprime të cilat i ka renditur në shpjegimet e saj.

46.9 Subjekti ka sqaruar se denoncuesi është njohur në çdo kohë me aktet, pasi sa herë ai konsultohet me to shtonte sugjerime për kryerje të veprimeve të tjera hetimore. Ai është pyetur si person që tregon rrethana hetimi në kuadër të këtij procedimi penal sa herë ai ka kërkuar vetë dhe sa herë është çmuar nga hetimi, gjithsej ka dhënë deklarime në nëntë raste.

46.10 Subjekti ka deklaruar se aktet i janë vënë në dispozicion shtetasit R.B në datën 30.7.2018, kundrejt tarifës përkatëse dhe me formularin e ruajtjes së sekretit hetimor bashkëngjitur.

46.11 Subjekti konfirmon se lidhur me kërkesën për USB, nga aktet e procedimit penal rezulton se prokuroria ka disponuar në datën 15.1.2018 me sekuestrimin e dy USB-ve të dorëzuara nga shtetasi R.B (f. 131, fash. 1). Nga ana e oficerit të policisë gjyqësore është bërë sekuestrimi i dy USB-ve të dorëzuara nga shtetasi R.B.

46.12 Subjekti ka konfirmuar dhe sqaruar mbi kryerjen e aktit të ekspertimit teknik video nr. ***, datë 12.4.2018, të IPSH-së Tiranë dhe të riekspertimit Nr. ***, datë 5.6.2018.

46.13 Subjekti ka konfirmuar edhe veprimin hetimor të kryer në lidhje me sekuestrimin e pamjeve filmike të kamerave të vendosura nga ana e Ministrisë së Mjedisit, nga të cilat nuk rezultonte të kishte të dhëna lidhur me hetimin e çështjes.

46.14 Subjekti ka theksuar se pretendimi i shtetasit R.B që USB-të nuk janë marrë në konsideratë, nuk qëndron.

46.15 Subjekti ka renditur të gjitha hetimet e kryera për këtë çështje derisa ajo është zëvendësuar në këtë proces, të cilat kanë zgjatur për 14 muaj. Ajo ka theksuar se çështja ka qenë komplekse, se vetë denoncuesi herë pas herë pretendonte rrethana të reja, që ishin përkthyer në veprime hetimore, etj.

46.16 Subjekti ka sqaruar se dy kërkesat për përjashtimin e saj nuk janë pranuar nga drejtuesi i organit të akuzës, por më tej ajo është dorëhequr nga hetimi i procedimit penal nr. ***, viti 2018.

46.17 Subjekti ka sqaruar se heqja dorë nga ana e saj është bërë për të mos u dukur si njëanshmëri në kuadër të këtij hetimi.

46.18 Subjekti ka depozituar kopje të akteve të kryera për hetimin e këtij procedimi penal, duke sqaruar se *ato i përkasin periudhës që ajo ka qenë prokurore për hetimin e këtij procedimi penal, dy fashikuj, marrë nga fashikujt që i përkasin procedimit penal nr. ***, viti 2018. Fashikulli i parë fillon nga f. 15 dhe fashikulli i dytë i këtij procedimi penal.* Nga aktet e administruara Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar në datën 22.1.2018 kryerjen e veprimeve hetimore, duke përcaktuar edhe afatin e përfundimit të tyre në datën 25.3.2018.

46.19 Në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala, Komisioni⁸⁷ i kërkoi subjektit shpjegime, pasi konstatoi se dukej se: *(i) afati për përfundimin e hetimeve në datën 25.3.2018 nuk ishte zbatuar*

⁸⁷ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

dhe njëkohësisht nuk rezultonte ndonjë e dhënë për të cilën subjekti i rivlerësimit të kishte ndërmarrë veprime për moszbatimin e afatit nga OPGJ-të dhe, për pasojë, dukej se zgjatja e hetimit deri në zëvendësimin e subjektit mbetet e pajustificuar edhe pse çështja ka qenë regjistruar pa autor; (ii) në mënyrë të pajustificuar, nuk ishte regjistruar emri i personit të dyshuar për kryerje të veprës penale, pasi dukej se personat të cilëve iu atribuohet ajo (që është një kualifikim i ndryshëm nga ai nën hetim apo akuzë) ishin të qartë që në aktet e hetimit fillestar; (iii) mosregjistrimi i emrit për dyshime të kryerjes së veprës penale ka çuar në disa raste⁸⁸ ku nuk keni dokumentuar (përmes akteve të arsyeuara të shtyrjes) veprimtarinë hetimore, duke i bërë vendimet jotransparente dhe në shkelje të përsëritur të të drejtave të viktimës.

46.20 Nisur nga kërkesat e shtetasit B. për t'u njohur me aktet e procedimit penal dhe për të pasur informacion për gjendjen e procedimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ai nuk i referohej kërkit të tij sipas nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, por i referohej në mënyrë të gabuar nenit 58 të po këtij Kodi.

46.21 Komisioni, në zbatim të këtyre dispozitave, konstatoi se dukej se shtetasi B. ka drejtuar kërkesat e tij bazuar në ligj dhe jo në mënyrë të gabuar, për sa kohë ai nuk ka cilësinë e palës sikurse e kërkon neni 110 i këtij Kodi, por ka cilësinë e viktimës si kallëzues i veprës penale. Ky vlerësim duket se përkon edhe me vendimin nr. ***, datë 28.5.2022⁸⁹, të Gjykatës Kushtetuese edhe me atë të Gjykatës së Lartë nr. ***, datë 13.9.2022⁹⁰. Lidhur më këtë konstatim, Komisioni⁹¹ i kaloi subjektit barrën e provës pasi vërejti se dukej se i ka mohuar të drejtën viktimës për ta njohur atë me aktet e procedimit dhe gjendjen në të cilën ndodhej ai/ procedimi.

46.22 Në qëndrimin e saj lidhur me konstatimet e Komisionit, subjekti ka parashtruar se nga ana e saj, pasi është studiuar materiali hetimor i referuar nga prokurori, është hartuar plani hetimor, duke deleguar detyra konkrete tek oficeri i policisë gjyqësore dhe duke lënë si datë për kryerjen e veprimeve hetimore të deleguara datën 25.3.2018. Sipas subjektit, data 25.3.2018 nuk është data për përfundimin e hetimeve, por data brenda së cilës duhen përfunduar ato veprime hetimore të planifikuara për t'u kryer. Kjo pasi kryerja e veprimeve hetimore të planifikuara apo dalja e të dhënave të reja, që nuk diheshin në momentin e regjistrimit të procedimit penal, diktojnë kryerje veprimesh hetimore shtesë, në funksion të hetimit të plotë mbi faktin.

46.23 Subjekti ka shpjeguar se oficerit të policisë gjyqësore, krahas detyrave të deleguara, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale i është deleguar e drejta për të kryer edhe

⁸⁸ Si edhe në rastin e denoncueses S.T.

⁸⁹ 14. Kolegji vlerëson se kërkuesi ndodhet në pozitën e viktimës të parashikuar nga neni 58 i Kodit të Procedurës Penale, por ai nuk është palë në procesin penal në pozita të njëjta me prokurorin ose të pandehurin. Për pasojë ai nuk mund të ketë legjitimitet për të ushtruar të njëjtat të drejta që ligjvënësi ia ka rezervuar palëve të mësipërme, përfshirë edhe të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës që ka gjykuar çështjen në themel dhe ka vendosur në lidhje me fajësinë ose jo të të pandehurit.

⁹⁰ 17. Të drejtat e viktimës/kallëzuesit të veprës penale, të listuara në pikën 1 të nenit 58 mund të ndahen në dy kategori: a) të drejta potenciale, të cilat viktimë mund të zgjedhë t'i ushtrojë ose jo dhe b) të drejta të detyrueshme, ushtrimi i të cilave passjell detyrimin e organit procedues për t'i plotësuar. Konkretisht, ligjvënësi ka përzgjedhur të rendisë këto të drejta të viktimës së veprës penale ndër të cilat ajo e kërkit të ndjekjes penale të autorit të veprës penale. Kjo e drejtë e viktimës së veprës penale lidhet nga njëra anë me të drejtën e saj për të kërkuar që nga ana e organit të akuzës të ushtrohet ndjekja penale në rastet kur vepra ndiqet kryesisht, ashtu edhe me të drejtën e saj për të kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale, duke paraqitur ankim për rastet e parashikuara në ligj. 18. Viktimë e veprës penale ka të drejtë të ketë informacion mbi fatin e hetimit dhe gjykimin. Kjo e drejtë e saj është reflektuar edhe në dispozitat e tjera të Kodit të Procedurës Penale, në të cilat ligjvënësi ka përcaktuar detyrimin e organit procedues përkatës për të njoftuar viktimën mbi fillimin, vijimin dhe përfundimin e procedimit penal. Kështu, në nenin 291, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale ligji parashikon detyrimin e prokurorit për t'i njoftuar menjëherë viktimës së veprës penale vendimin e tij të mosfillimit të procedimit. Viktimë ka të drejtën të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pus huar akuzën ose çështjen. Kështu, viktimë ka të drejtë të ushtrojë ankim brenda 10 ditëve nga data e marrjes dijeni ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal sipas nenit 291, pika 2 dhe ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes në rastet e kundërvajtjeve penale sipas nenit 329, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale.

⁹¹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

veprime hetimore të tjera që do të diktoheshin në varësi të detyrave të deleguara. Delegimi i veprimeve hetimore tek oficeri i policisë gjyqësore bëhet me gojë dhe me shkrim⁹², pasi prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore janë personat përgjegjës për hetimin dhe nuk është e detyrueshme që delegimi i veprimeve hetimore të bëhet domosdoshmërisht me shkrim, pasi ky akt nuk përbën provë, por rregullon marrëdhëniet administrativisht ndërmjet personave përgjegjës për hetimin. Aktet e procedimit penal provojnë se hetimi është drejtuar, kontrolluar nga prokurorja, si dhe se oficeri i policisë gjyqësore ka kryer veprime hetimore të urdhëruara prej saj pas afatit të përcaktuar në urdhrin e delegimit të parë.

46.24 Subjekti parashtron se të gjitha aktet që u janë dërguar bashkëlidhur pyetësorëve të mëparshëm në lidhje me këtë procedim penal provojnë se veprimet hetimore kanë qenë në vijimësi dhe nuk ka pasur zvarritje hetimesh, duke evidentuar faktin që vetëm në lidhje me pamjet filmike prokurorja ka vendosur dy herë për ekspertim të pamjeve të regjistruara, me qëllim identifikimin e personave dhe mjeteve, për të cilët kamera kishte regjistruar.

46.25 Subjekti ka prapësuar konkluzionin e Komisionit se “kemi të bëjmë me mosregjistrim emri të personit nën hetim në mënyrë të pajustificuar, pasi duket se personat, të cilëve iu atribuohet vepra penale ishin të qartë që në aktet e hetimit fillestar”. Sipas saj, nuk ka pasur prova që përmbanin të dhëna për persona që u atribuohet fakti, të cilat përbëjnë provë në kuptimin procedural penal. Regjistrimi i emrit të personit në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk është çështje dëshire apo vullneti i prokurorit, por detyrim ligjor për të cituar provat ku bazohet e dhëna për identifikimin e autorit të veprës penale. Subjekti ka referuar edhe vendimin unifikues nr. 3, datë 27.9.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë unifikuar praktikën gjyqësore dhe ku referohet se: “... *figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale që nga momenti i njoftimit të saj tek prokurori e deri në momentin e përfundimit të hetimeve (neni 327) evoluon nga “person të cilit i atribuohet vepra penale” në “person ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe se fundi në “i pandehur”, pavarësisht se çështja pushohet (neni 328) apo dërgohet për gjykim (neni 331)”*”.

46.26 Sipas subjektit, në momentin që ka bërë kallëzim penal shtetasi R.B nuk ka pasur persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale, vetëm ka pasur të dhëna në lidhje me personat që mund të kishin dijeni mbi faktin, pasi kishin punuar në banesën pronë e tij, ku ishin vjedhur paketa. Vetëm me mendimin e shtetasit R.B që personat që kanë punuar në banesën e tij mund edhe të kenë bashkëpunuar me persona të tjerë për të realizuar vjedhjen, nuk është mjaftueshëm në kuptim të ligjit për të regjistruar emrin e personave në regjistrin e njoftimit të veprave penale si autorë të veprës penale. Dyshimet e kallëzuesit R.B ishin me imagjinatë për personat që kishin punuar në banesën e tij, pa pasur një të dhënë konkrete që të bënin të besueshme sa ai pretendonte. Në subjektet ku ai pretendonte se mund të gjendej malli i vjedhur është ushtruar kontroll i menjëhershëm. Kollitë me paketa janë sekuestruar. Dokumentacioni tatimor që kanë paraqitur subjektet ku është bërë sekuestrimi i kolive (me dyshimin se mund të jenë bashkëpunëtorë në vjedhje) kanë treguar mbi origjinën e mallit çfarë diktonte nevojën për kryerje ekspertimesh doganore.

46.27 Lidhur me konstatimin tjetër të Komisionit për këtë çështje, subjekti ka parashtruar se shtetasit R.B, me cilësinë e viktimës, nuk i është mohuar e drejta për t’u njohur me aktet e procedimit dhe gjendjen e procedimit. Që është njohur me aktet e procedimit penal, si dhe gjendjen në të cilën ndodhej procedimi e provon më së miri përmbajtja e deklarimeve që shtetasi R.B ka bërë në periudha të ndryshme përpara organit procedues. Me cilësinë e viktimës R.B, sikurse

⁹² Subjekti ka referuar nenin 277 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.

parashikon neni 58 i Kodit të Procedurës Penale, i është dhënë mundësia për të marrë informacionin në çdo kohë, të njihet me aktet, si dhe t'i drejtohet prokurorisë me kërkesa për të marrë prova, ku për sa është kërkuar nga shtetasi R.B është vlerësuar dhe këto prova janë marrë. Sikurse kam shpjeguar në përgjigje të pyetësorëve, kërkesat e denoncuesit nëpërmjet avokatit të tij mbrojtës janë bazuar në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale, që lidhen me të drejtat e viktimës për t'u njohur me aktet dhe jo kërkesa të bëra në bazë të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, ku në rast të kërkesave memorie, sikurse e parashikon neni 110 i Kodit të Procedurës Penale, prokurori del me vendim për pranimin ose jo të kërkesave të tij. Për këtë arsye, ka shpjeguar subjekti, për këto kërkesa kallëzuesi nuk ka marrë përgjigje me shkrim.

46.28 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se referuar përmbajtjes së deklarimeve të shtetasit R.B në datat 12.1.2018, 15.1.2018, 16.1.2018, 17.1.2018, 19.1.2018, 27.2.2018, 5.7.2018 dhe 27.11.2018, mësohet se nga ana e organit procedues viktimës R.B i është bërë me dije se hetimet vazhdojnë dhe ai është njohur me aktet që nuk përbëjnë sekret hetimor dhe i janë marrë deklarime mbi të dhënat që nga ana e organit procedues vlerësoheshin se janë në ndihmë të hetimit. Kodi i Procedurës Penale njej të drejta për viktimën dhe këto të drejta të viktimës janë respektuar. Kodi i Procedurës Penale nuk e barazon viktimën me prokurorin duke i bërë bashkëhetues, pasi përndryshe do të kishim të bënim me shkelje procedurale të nxjerrjes së sekretit hetimor.

46.29 Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të saj, ka depozituar: (i) vendimet për aktet e ekspertimit të pamjeve dhe ato doganore, që sipas saj provojnë se nuk ka pasur prova që japin të dhëna për autorët e veprës penale, në mënyrë që t'u regjistrohej emri në regjistër; (ii) deklaratimet e shtetasit R.B në datat 12.1.2018, 15.1.2018, 16.1.2018, 17.1.2018, 19.1.2018, 27.2.2018, 5.7.2018 dhe 27.11.2018.

46.30 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, në raport me ligjin e zbatueshëm në këtë çështje objekt shqyrtimi, arsyeton si vijon:

46.30.1 Sa i takon çështjes së njohjes së viktimës me aktet e procedimit dhe gjendjen e tij, trupi gjykues, nga verifikimi i akteve në dosje e, konkretisht kërkesave të shtetasit B. përmes avokates, ka konstatuar se kërkimet për aktet në dosje/fashikull dhe gjendjen në të cilën ndodhej procedimi penal, kanë qenë me reference te neni 58 i Kodit të Procedurës Penale. Për sa është pretenduar nga denoncuesi e kërkuar gjatë këtij procedimi, trupi gjykues nga aktet konstatoi se ky denoncues në cilësinë e viktimës:

- Ka depozituar kërkesë në datën 1.2.2018 për pajisjen me kopje të akteve dhe nuk rezulton që të jetë pajisur me kopje të akteve apo përgjigje të kërkimit të tij.
- Ka depozituar kërkesë në datën 16.2.2018 për pajisjen me kopje të akteve dhe kryerjen e veprimeve hetimore dhe nuk rezulton që të jetë pajisur me kopje të akteve apo përgjigje mbi kërkimin e tij.
- Në datën 26.5.2018 ka kërkuar zëvendësimin e subjektit, me objekt kërkimi se nuk merrte aktet e nuk kishte reagim nga ana e subjektit, kërkesë që nuk është pranuar nga drejtuesi i Prokurorisë.
- Ka ridepozituar dy kërkesa në datën 27.9.2018 për pajisjen me kopje të akteve dhe kryerjen e veprimeve hetimore dhe nuk rezulton që të jetë pajisur me kopje të akteve apo përgjigje mbi kërkimin e tij.

Rezultoni se drejtuesja e Prokurorisë, në datën 20.3.2019, ka pranuar kërkesën e shtetasit në fjalë për zëvendësimin e subjektit me arsyetimin se: *“Në rastin konkret konstatohet se besimi i palës është thyer, pikë së pari nga mungesa e përgjigjeve mbi kërkesat që bën ky shtetas për kryerje*

veprimesh hetimore, të cilat duhet të kishin një përgjigje qoftë negative apo pozitive, në respektim të neneve 58, 105 dhe 110 të Kodit të Procedurës Penale dhe nën dritën e parimit që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet por edhe të duket..”

46.30.2 Në vlerësim të dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale, nga të dhënat e përfituara në aktet e dosjes, në raport me kërkimet e shtetasit R.B, trupi gjykues çmon se duket se ky shtetas ka drejtuar kërkesat e tij bazuar në ligj dhe jo në mënyrë të gabuar, për sa kohë ai nuk ka cilësinë e palës sikurse e kërkon neni 110 i këtij Kodi, por ka cilësinë e viktimës si kallëzues i veprës penale. Bazuar në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka përmbushur kërkesat e viktimës në kohë, sipas kërkimit⁹³ të bërë nga ana e tij. Kjo mangësi, në vlerësimin e trupit gjykues, cenon anën profesionale të subjektit, pasi nuk ka respektuar të drejtat e viktimës, parashikuar në nenin 44, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

46.30.3 Lidhur me konstatimin e Komisionit se dukej se afati për përfundimin e hetimeve në datën 25.3.2018 nuk është zbatuar dhe njëkohësisht nuk rezulton ndonjë e dhënë për të cilën subjekti i rivlerësimit të ketë ndërmarrë veprime për moszbatimin e afatit nga OPGJ-ja dhe, për pasojë, dukej se zgjatja e hetimit deri në zëvendësimin e subjektit mbetej e pajustificuar edhe pse çështja ka qenë regjistruar pa autor, trupit gjykues, pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, i rezultoi:

i. Veprimet hetimore në tërësinë e tyre, duket se janë kryer, sipas urdhrit të subjektit për kryerjen e hetimeve. Shpjegimi i subjektit se kishin mbetur disa veprime hetimore që, sipas saj vareshin nga dinamika, duket bindës dhe, për rrjedhojë, nuk evidentohen mangësi që të mund të cenojnë veprimtarinë profesionale të subjektit.

ii. Lidhur me konstatimin e Komisionit se dukej se personat të cilëve iu atribuohet vepra penale ishin të qartë që në aktet e hetimit fillestar dhe, për rrjedhojë, dukej se në mënyrë të pajustificuar, nuk ishte regjistruar emri i tij/tyre, trupi gjykues, në analizë të të dhënave të përfituara në këtë çështje dhe dinamikës së ngjarjes, ku aktualisht rezulton se një subjekt tjetër rivlerësimi ka pezulluar hetimin e këtij procedimi dhe dërgimin e tij pranë Drejtorisë së Policisë për gjetje autori, çmon të argumentuara shpjegimet e subjektit dhe, për pasojë, nuk konkludon në ndonjë rrethanë që ndikon në vlerësimin e aftësisë profesionale të tij.

47. Denoncim⁹⁴ i shtetasës S.T

47.1 Shtetasja S.T, vajza e shtetasve N. dhe F.T, në denoncimin e saj akuzon subjektin e rivlerësimit për moskryerje të procesit hetimor dhe pushim të padrejtë të procedimit penal nr. ***, datë 25.1.2018, regjistruar ndaj shtetasit XH.T për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, nën dyshimin se këto veprime kanë ardhur si rezultat i marrjes së ryshfetit.

47.2 Shtetasja T sqaron në denoncimin e saj se nëna e saj N ka një konflikt të hapur me shtetasin XH.T, i cili në vitin 2000 ka marrë një kredi në lekë në një institucion financiar dhe pa dijeninë e saj ka vendosur garanci apartamentin që ajo ka në bashkëpronësi me bashkëshortin e saj.

47.3 Denoncuesja sqaron ndër të tjera se apartamentin e ka përfituar nga ligji nr. 7652/1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në vitin 1992, konfirmuar me vendimin nr. ***, datë 15.2.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

47.4 Me formularin e denoncimit shtetasja T ka bashkëngjitur kallëzimin e saj, bërë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 17.1.2018, njoftimin për përfundimin e hetimeve nga subjekti

⁹³ Ky vlerësim duket se përkon edhe me vendimin nr. ***, datë 28.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese dhe nr. ***, datë 13.9.2022, të Gjykatës së Lartë.

⁹⁴ Nr. *** prot., datë 27.7.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

i rivlerësimit, datë 3.7.2018, kërkesën drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për pushimin e çështjes, procedimin penal nr. ***, datë 25.1.2018.

47.5 Komisioni e ka pyetur subjektin⁹⁵ lidhur me pretendimet e denoncuesit. Në përgjigjen e dhënë subjekti ka deklaruar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan mbi bazën e materialit kallëzues nr. *** sek., datë 17.1.2018, të paraqitur nga shtetasja N.T dhe të regjistruar me nr. *** regj., datë 17.1.2018, më 25.1.2018 ka bërë regjistrimin e procedimit penal nr. *** për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

47.6 Procedimi penal është regjistruar vetëm për veprën penale, pa emër personi nën hetim. Për hetimin e kësaj çështjeje janë kryer një sërë veprimesh hetimore⁹⁶, veprime këto që janë cituar edhe në kërkesën për pushimin e çështjes së përpiluar nga subjekti.

47.7 Subjekti ka deklaruar se ndaj vendimit nuk është bërë ankim⁹⁷ dhe se vendimi ka marrë formë të prerë në datën 6.11.2018.

47.8 Subjekti ka sqaruar se afati tremujor i përfundimit të hetimeve përkon vetëm në rastin e procedimit penal të regjistruar me autor, duke referuar në këtë mënyrë nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret, ka theksuar ajo, procedimi është regjistruar pa autor.

47.9 Subjekti ka sqaruar se në këtë çështje veprimet kanë qenë dinamike, nuk ka pasur zvarritje hetimi dhe me përfundimin e të gjitha veprimeve hetimore, në kuadër të planit hetimor, është dhënë edhe zgjidhja përfundimtare e çështjes.

47.10 Subjekti ka depozituar kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, bashkëlidhur së cilës është edhe vendimi nr. ***, datë 19.9.2018, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pushimin e procedimit penal së bashku me shënimet përkatëse.

47.11 Në analizë të fakteve dhe rrethanave të lartpërmendura, Komisioni⁹⁸ i kaloi subjektit barrën e provës, pasi dukej se: (i) nuk ishin nxjerrë akte të arsyetuara për shtyrje, për shkak të mungesës së regjistrimit të emrit, ndonëse emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale ishte i qartë nga aktet e hetimit fillestar; (ii) nuk ishte hetuar ndër vite, për përdorimin e dokumentit nga i kallëzuar, duke qenë se çështja objekt shqyrtimi i përket veprës penale të falsifikimit të dokumenteve; (iii) nuk ishte hetuar përgjegjësia e institucionit financiar (Fondacioni Besa) dhe/ose zyrtarëve të Kadastrës, pavarësisht vendimit gjyqësor të vitit 2005 (i cili kishte marrë formë të prerë dhe ishte

⁹⁵ Me pyetësin nr. 2, datë 10.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹⁶ Subjekti ka sqaruar se më konkretisht me shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2018, është kërkuar dokumentacion pranë Fondit Besa, dokumentacion i cili është vënë në dispozicion me shkresën nr. *** prot., datë 2.2.2018. Me shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2018 është kërkuar informacion dhe dokumentacion pranë ZVRPP-së Elbasan, dokumentacion i cili është vënë në dispozicion me shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2018, ardhur në datën 8.2.2018. Me shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2018 është kërkuar informacion dhe dokumentacion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan lidhur me faktin objekt hetimi, dokumentacion i cili është vënë në dispozicion me shkresën nr. *** prot., datë 1.2.2018. Në datën 27.6.2018 është marrë dokumentacion nga shtetasja A.B, përbaruese private, nga oficeri i policisë gjyqësore G. Në datën 2.7.2018 nga oficeri i policë gjyqësore G është marrë dokumentacion lidhur me faktin objekt hetimi edhe pranë ZVRPP-së Elbasan. Janë marrë deklarime shtetasish më 3.4.2018, 23.4.2018, 3.5.2018, 27.6.2018 dhe 2.7.2018 si persona që kanë treguar rrethana hetimi. Në datën 2.7.2018 është përpiluar relacioni përfundimtar nga oficeri i policisë gjyqësore. Pas dorëzimit të dosjes, më 2.7.2018, prej saj më 3.7.2018 është bërë përfundimi i hetimeve dhe është përpiluar kërkesa për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2018. Kjo kërkesë, për shkak të llojit të veprës penale dhe në respektim të Kodit të Procedurës Penale, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁹⁷ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 15.11.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan rezulton se me vendimin nr. ***, datë 19.9.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2028, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale”.

⁹⁸ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

bërë detyrues në vitin 2012), për pronësinë e banesës në emrin e shtetases N.T. Kjo edhe për faktin se këto subjekte nuk kishin marrë masa për heqjen e hipotekës së paligjshme të banesës deri në vitin 2018, kur kishte nisur hetimi penal nga prokuroria; (iv) subjekti i ishte referuar vetëm një dokumenti të lëshuar në qershor të vitit 2018 nga zyra e Kadastrës, sipas të cilit hipoteka ishte hequr përfundimisht.

47.12 Në qëndrimin e saj subjekti ka parashtruar se sipas shkresës nr. *** prot., datë 15.11.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, rezulton se me vendimin nr. ***, datë 19.9.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2028, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale”. Ndaj vendimit nuk është bërë ankim dhe se vendimi ka marrë formë të prerë në datën 6.11.2018. Sikurse kemi shpjeguar dhe më lart, afati tremujor i përfundimit të hetimeve përkon vetëm në rastin e procedimit penal të regjistruar me autor, duke referuar në këtë mënyrë në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret procedimi është regjistruar pa autor.

47.13 Sipas subjektit, për të regjistruar emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale në regjistrin e njoftimit të veprave penale, nuk është e mjaftueshme që të përmendet një emër nga kallëzuesi i veprës penale dhe pikërisht ai është personi që ka kryer veprën penale. Pasi sigurohen të dhëna të mjaftueshme se duhet hetuar për konsumim të elementeve të një apo disa veprave penale (pasi hetimi nuk mund të jetë i pakufizuar, ka një objekt hetimi që fokusohet tek të dhënat që bëjnë njoftimin për kryerjen e një vepre penale të caktuar) bëhet regjistrimi i procedimit penal. Në rastin e veprës penale të falsifikimit nuk është i mjaftueshëm vetëm sa kallëzuesi pretendon, ku pretendimi për falsitetin dhe personin që e ka kryer atë nuk bazohet në të dhëna të bazuara shkencore apo prova të natyrave të tjera që provojnë dyshimin. Duhet një konkluzion shkencor nëse vërtet kemi të bëjmë me falsifikim dhe kohën e përdorimit të dokumentit, nëse dokumenti rezulton i falsifikuar. Sa referonte kallëzuesja në kallëzimin penal, bëhej fjalë për veprime të ndërmarra përpara vitit 2000 dhe ku aktet përkatëse ishin bërë pjesë e gjykimit civil, ku pasojat ishin zgjidhur në vitin 2005. Parashkrimi penal, pra mosushtimi i ndjekjes penale për shkak të plotësimit të afatit të parashkrimit, nuk cenon asnjë të drejtë të personit që në proces civil pretendon falsitetin e dokumentit, për të cilin nuk mund të ushtrohet ndjekje penale.

47.14 Subjekti ka shpjeguar se nga aktet e grumbulluara në kuadër të këtij procedimi penal nuk ka pasur të dhëna që të krijonin dyshim për konsumim vepre penale nga punonjës të Zyrës së Kadastrës Elbasan apo institucioni financiar “Besa”. Bëhej fjalë për marrëdhënie të natyrës administrative, ku mosmarrëveshjet në këtë kuadër zgjidhen duke iu drejtuar gjykatës administrative apo civile. Megjithatë, duke iu referuar rastit konkret, pretendohet për veprime të kryera në vitin 2000. Në këtë vit ishte vendosur kontrata hipotekore. Me vendime gjyqësore të formës së prerë janë zgjidhur pasojat e kontratës së shitblerjes së apartamentit. Kontrata e shitblerjes është bërë e pavlefshme. Ashtu sikurse janë zgjidhur pasojat për lirimin e pronës, duhej vepruar edhe për detyrimin e ZVRPP-së për heqjen e barrës hipotekore. Ligji për regjistrimin e pasurive të paluajtshme parashikon procedurë administrative për vendosjen dhe heqjen e hipotekave. Në rast zbatimi gabim të ligjit nga ana e ZVRPP-së, kjo vendimmarrje kundërshtohet në gjykatë. Punonjësit e ZVRPP-së mbajnë përgjegjësi penale kur kryejnë veprime me dashje në shkelje të hapur të ligjit, por jo për veprime në kuadër të të cilit kërkojnë zbatimin e procedurës administrative, plotësimin e dokumenteve për të nxjerrë aktin administrativ.

47.15 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se brenda afatit të parashkrimit të ndjekjes penale nuk rezulton që të kemi kryerje të asnjë veprimi. Vendosja e hipotekës, regjistrimi i kontratës së shitjes janë bërë në vitin 2000. Procesi gjyqësor, që ka rivendosur të drejtat duke shpallur të pavlefshme

kontratën e shitblerjes, daton në vitin 2005. Rregullimi i pasojave civile dhe administrative në lidhje me këtë vendimmarrje të gjykatës nuk është pjesë e procesit penal. Pra, hetimi mbi faktin e kallëzuar ka qenë i plotë. Këto rrethana ka mbajtur në konsideratë edhe gjykata, që me vendimin nr. ***, datë 19.9.2018, ka vlerësuar të drejtë dhe të bazuar në prova e ligj kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Elbasan.

47.16 Trupi gjykues në këtë çështje konstaton se subjekti nuk ka qartësuar plotësisht në hetime pozitën e të kallëzuarit si bashkëpronar dhe jo titullar i vetëm i pasurisë që ai i ofroi institucionit financiar si kolateral dhe që u vendos si e tillë në kontratën e kredisë, duke sjellë pasoja në vijim. Por, pavarësisht këtij konkluzioni, në rrethanat konstatuese të faktit se pretendimet e denoncueses/kallëzueses⁹⁹ lidhur me bashkëpronësinë e pasurisë kanë marrë zgjidhje në rrugë gjyqësore dhe administrative, ku dhe nuk duket të identifikohen të dhëna lidhur me falsifikim dokumenti e, për pasojë, as edhe me përdorim të tij, çmon se në këtë rast nuk konstatohen mangësi të atij niveli që mund të përbëjnë shkaqe thelbësore apo të mjaftueshme për cenimin e kriterit profesional të subjektit.

48. Denoncim¹⁰⁰ i shtetasit P.B

48.1 Shtetasi P.B, në cilësinë e pronarit të shoqërisë së ndërtimit “S” sh.p.k., bën me dije se për shkak të marrëdhënies kontraktuale të ndërlikuar me shoqërinë turke “****”, dega Shqipëri (i referuar si L***), ka kërkuar zgjidhje të mosmarrëveshjeve të tyre në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të prishjes së marrëdhënieve kontraktuale midis dy shoqërive, punonjësit e shoqërisë “S” sh.p.k., me pronar shtetasin B, kanë mbetur pa punë dhe pa paguar. Shtetasi B në denoncimin e tij thekson se nga kjo situatë ndihet i kërcënuar për jetën e tij dhe të familjes, si nga personat që u detyrohet financiarisht, ashtu edhe nga punonjësit e shoqërisë së tij. Nisur nga kjo situatë, shtetasi B në datën 1.2.2016 ka depozituar kallëzim penal për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Ai qartëson se është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 9.3.2016. Prokuroria e Rrethit Tiranë e ka përcjellë çështjen në Prokurorinë e Rrethit Elbasan për moskompetencë të hetimit, e cila në datën 20.4.2016 ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

48.2 Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetim dhe ka marrë vendim për pushim të çështjes penale për veprën penale “Vetëgjyqësia”. Me formularin e denoncimit ai ka bashkëlidhur disa dokumente¹⁰¹.

48.3 Komisioni, bazuar në dokumentin e depozituar “Vendim për pushimin e procedimit penal”, nr. ***, datë 20.4.2016, konstaton se hetimi është kryer për 8 muaj, tregues ky që duket se pasqyron tejkallim të afatit kohor të hetimit nga ana e subjektit, referuar nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale.

48.4 Komisioni e ka pyetur subjektin¹⁰² lidhur me pretendimet e denoncuesit. Në përgjigjen e dhënë, subjekti ka deklaruar se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mbi bazën e akteve të procedimit penal nr. ***, datë 9.3.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për të cilin është shpallur moskompetenca e hetimit, me shkresën nr. ***, datë 11.3.2016, të kësaj Prokurorie,

⁹⁹ Në dallim nga rasti i trajtuar më sipër me denoncues shtetasin S, ku pretendohet përdorimi i një dokumenti të falsifikuar në procese gjyqësore.

¹⁰⁰ Nr. *** prot., datë 27.6.2018.

¹⁰¹ Vendimi datë 16.12.2016 për pushimin e çështjes; deklaratë e dhënë në Policinë e Elbasanit, datë 14.9.2015, nga shtetasja J.B, e bija e denoncuesit; deklaratë me shkrim dore e shtetasit P.B datë 25.8.2015, ku deklaroi se do të shlyejë 2 pagat e prapambetura për punonjësit e shoqërisë së tij; letër datë 5.9.2015, nga një vajzë drejtuar Kryeministrit për mos pagesën e babait të saj; kontratë individuale pune e shtetasës J.B (vajza e denoncuesit), datë 23.6.2015.

¹⁰² Me pyetësin nr. 2, datë 10.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

të regjistruar me nr. *** regj., datë 14.4.2016, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në datën 20.4.2016 ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

48.5 Kallëzuesi ishte administrator i shoqërisë së ndërtimit “S” sh.p.k. dhe me shoqërinë e kallëzuar kishte lidhur një marrëveshje nënkontraktuese, në bazë të së cilës kishte marrë përsipër kryerjen e disa punimeve në ndërtimin e dy projekteve të hidrocentraleve HPP B dhe HPP M. Marrëveshja kishte nisur të zbatohet që nga muaji nëntor i vitit 2013 deri në datën 16.11.2015. Për këtë qëllim, kallëzuesi kishte kryer një sërë punimesh nëpërmjet makinerive të blera prej tij, për të cilën ai kishte edhe fatura tatimore shitjeje. Pas kësaj date, sipas tij, shoqëria e tij ishte larguar prej të kallëzuarit nga puna pa i dhënë asnjë lloj shkak, veprim për të cilin ata i ishin drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë përkatëse, me objekt “Zgjidhje kontrate në mënyrë të njëanshme dhe shpërblim dëmi”. Kallëzuesi pretendonte në kallëzim se për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me caktimin e çmimit për punën e kryer, atij i ishin mbajtur dhe nuk i ishin kthyer makineritë pronë e tij. Sipas tij, edhe për shkak të motit të keq, këto pajisje po shkatërroheshin dhe personat e autorizuar prej tij nuk ishin lejuar të merrnin makineritë. Për shkak se pajisjet pronë e kallëzuesit ndodheshin në kompaninë e HEC-it të B së qarkut Elbasan është bërë edhe shpallja e moskompetencës së hetimit të këtij procedimi penal dhe materiali është përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

48.6 Subjekti sqaron se, pasi janë studiuar aktet, është hartuar plani i hetimit, i dokumentuar me urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, datë 20.4.2016. Pas regjistrimit janë kryer një sërë veprimesh hetimore, marrje dokumentacionesh dhe pyetje personash si persona që tregojnë rrethana hetimi.

48.7 Subjekti ka referuar kërkimet dhe korrespondencat e mbajtura me institucionet e tjera për këtë çështje, përfshirë edhe gjykatën. Nga korrespondenca e mbajtur me gjykatën, subjekti sqaron se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndodhej për gjykim çështja civile me nr. *** akti, datë 9.10.2015 dhe datë regjistrimi 12.10.2015, me palë paditëse “S” sh.p.k. dhe të paditur “****” (i referuar si L), me objekt “Shlyerjen e detyrimeve për prishje të kontratës jashtë çdo pike të përcaktuar në kontratë; detyrimin e L. për kryerjen e pagesave të prapambetura jashtë çdo afati; detyrimin për shpërblim dëmi me pasojë shkaktimin e dëmit financiar dhe prishjen e imazhit të “S” sh.p.k., si dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve të prapambetura”.

48.8 Ajo ka konfirmuar se gjatë hetimit të çështjes nga ana e oficerit të policisë gjyqësore i është marrë deklaram në datën 6.5.2016 shtetasit P.B si person që tregon rrethana hetimi. Në datën 9.5.2016 kanë dhënë deklaram shtetasit A.B dhe A.B si persona që kanë dijeni për rrethana hetimi. Në datën 6.6.2016 janë pyetur si persona që tregojnë rrethana hetimi shtetasit M.K, avokat i shoqërisë “L” dhe M.K, drejtor finance i po kësaj shoqërie. Në datën 27.9.2016 është pyetur shtetasi B.K si person që tregon rrethana hetimi. Pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe administrimit të akteve shkresore është përpiluar relacioni nga oficeri i policisë gjyqësore në datën 16.12.2016 dhe nga subjekti po në këtë datë është marrë vendimi i pushimit për procedimin penal nr. ***, viti 2016.

48.9 Subjekti ka deklaruar se kallëzuesi është njoftuar me shkresën nr. *** prot., datë 17.1.2017, për vendimin e pushimit dhe nuk rezulton të ketë ushtruar ankim brenda afateve ligjore.

48.10 Subjekti ka shpjeguar se referuar akteve të procedimit penal veprimet hetimore kanë qenë në vijimësi. Ajo ka evidentuar faktin që prokuroria për të administruar përgjigje nga institucionet shtetërore apo subjekte private, komunikon në rrugë shkresore, ku për të dërguar dhe për të marrë përgjigje, një afat mbi tri javë nuk është i mundur. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, është vijuar me kryerjen e veprimeve hetimore shtesë, te diktuar nga studimi i

dokumentacionit, ku ndër to është edhe pyetja e shtetasve si persona që tregojnë rrethana hetimi. Procedimi penal nr.***, viti 2016, është regjistruar pa emër personi nën hetim dhe nën këtë konfirmim subjekti vijon të referojë si në rastet e tjera të sipërcituara se nuk ka qenë detyrim i organit të akuzës të nxjerrë akte për shtyrje të afatit të hetimit.

48.11 Subjekti ka sqaruar se në kuadër të hetimeve për këtë procedim penal veprimet kanë qenë dinamike, nuk ka pasur zvarritje hetimi. Me përfundimin e te gjitha veprimeve hetimore në kuadër të planit hetimor, është dhënë edhe zgjidhja përfundimtare e çështjes.

48.12 Subjekti ka konfirmuar se shkak për kohëzgjatjen e hetimit ka qenë mungesa e informacionit të kërkuar nga shoqëria “L”, me gjithë këmbënguljen e tyre me shkresa të njëpasnjëshme. Përgjigjja e tyre është depozituar vetëm në datën 13.12.2016 dhe, menjëherë, me depozitim e akteve nga ana e shoqërisë, është dalë me vendimmarrje në datën 16.12.2016.

48.13 Subjekti ka sqaruar edhe lidhur me statusin e çështjes¹⁰³, si dhe ka depozituar dokumentacion mbështetës¹⁰⁴.

48.14 Në analizë të fakteve dhe rrethanave të lartpërmendura, Komisioni¹⁰⁵ i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit, pasi dukej se: (i) nuk ishte kryer asnjë hetim gjatë periudhës qershor 2016 – dhjetor 2016 (periudhë e cila shkon përtej kufirit standard kohor 3-mujor për hetim); (ii) ishte e pajustificuar vonesa e kthimit të përgjigjes mbi kërkesën e adresuar shoqërisë turke “L” për informacion, për sa kohë nuk ishte ndërmarrë asnjë masë për të shmangur këtë vonesë; (iii) ishte kryer një hetim sipërfaqësor në kundërshtim me kërkesat e nenit 73/2,3 të ligjit nr. 96/2016; (iv) nuk ishte bërë përpjekje për të pyetur punëtorët për faktet dhe rrethanat e rastit, të cilët ishin të shumtë në numër, rreth 100; (v) ishte mjaftuar në hetim vetëm me disa informacione nga persona që përfaqësonin të denoncuarin, shoqërinë turke me degë në Shqipëri, denoncuesin dhe 2 shoferët e tij, pasi marrja në pyetje e personave që dyshohet se kanë punuar për autorin/shoqërinë për 2 vjet mbi dinamikën e çështjes, mund të kishte hedhur dritë mbi faktet dhe rrethanat dhe do të kishte lejuar një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës.

48.15 Në qëndrimin e saj, subjekti ka parashtruar se afati tremujor i përfundimit të hetimeve përkon vetëm në rastin e procedimit penal të regjistruar me autor, duke referuar në këtë mënyrë nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale. Referuar akteve të procedimit penal, veprimet hetimore kanë qenë në vijimësi. Administrimi i dokumentacionit të nevojshëm dhe pyetja e personave kanë diktuar kryerjen e veprimeve hetimore shtesë. Përgjigjja e kërkuar nga shoqëria turke “L” është pritur në kuadër të vazhdimësisë së hetimeve dhe nuk ka qenë e vetmja provë që pritej për të bërë zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Hartimi i planit hetimor, delegimi i veprimeve hetimore, kontrolli i

¹⁰³ Subjekti ka shpjeguar se në datën 29.5.2019 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në seancë gjyqësore ka marrë në shqyrtim çështjen administrative-penale me palë kërkues “S” sh.p.k., me administrator P.B, me objekt “Rivendosjen në afat të së drejtës për të paraqitur ankim ndaj vendimit për pushimin e çështjes, datën 16.12.2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan”. Kjo gjykatë me vendimin nr. ***, datë 29.5.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit, shoqëria “S” sh.p.k. me objekt “Rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit” si të pabazuar në ligj. Sipas ankimit të paraqitur nga ankuesi, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nr. ***, datë 29.5.2019, ka marrë formë të prerë në datën 26.6.2019, pasi me vendimin nr. ***, datë 26.6.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës, është vendosur “Lënia në fuqi e vendimit nr. ***, datë 29.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”. Sipas rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me vendimin nr. ***, datë 27.1.2023, të Gjykatës së Lartë, është vendosur “Mospranim i rekursit të paraqitur nga shoqëria “S” sh.p.k. kundër vendimit nr. ***, datë 26.6.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës”. Pra, kërkesa për “Rivendosje në afat të ankimit”, e paraqitur në vitin 2019, nuk është pranuar nga gjykatat në të gjitha shkallët e saj. Subjekti ka konfirmuar se vendimi përkatës i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan i është vënë në dispozicion me shkresën nr. ***, datë 15.11.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

¹⁰⁴ Kopje të fashikullit të njësuar me origjinalin, vendim i pushimit të përpiluar prej saj; shkresë nr. ***, datë 15.11.2023, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, bashkëlidhur së cilës është edhe vendimi nr. ***, datë 29.5.2019, i kësaj Gjykate, me kërkues shoqërinë “S” sh.p.k. dhe objekt “Rivendosje në afat të ankimit” me shënimet përkatëse.

¹⁰⁵ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

hetimit, mbledhja e provave të nevojshme dhe të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes janë kryer nga prokurori me përgjegjësi dhe profesionalizëm.

48.16 Subjekti ka shpjeguar se nuk janë pyetur të gjithë punëtorët, pasi me provat e grumbulluara konkludohej plotësisht se nuk kishim të bënim me një fakt penal dhe se çështja penale duhej pushuar. Kodi i Procedurës Penale në mënyrë të shprehur parashikon se në çdo kohë mund të hiqet dorë nga marrja e provave të planifikuara, pasi në vijimësi të hetimit apo gjykimit duken se janë haptazi të panevojshme, ngaqë rrethanat e faktit janë të qarta. Janë pyetur persona që përfaqësonin të denoncuarin dhe denoncuesit, pra nga të dyja palët. Thëniet e tyre kanë qenë të mjaftueshme për të konkluduar mbi sa kallëzohej penalisht dhe mbi faktin nëse kishim të bëjmë apo jo me vepër penale.

Subjekti ka konkretizuar objektin e marrëveshjes¹⁰⁶ së çështjes civile në gjykatë dhe ka deklaruar se hetimi provoi se kishim të bënim me një marrëdhënie juridiko-civile, ku pretendimet e palëve rridhnin nga marrëdhëniet e punës dhe kontratat e lidhura ndërmjet palëve, por nuk kishim të bënim me elemente të veprës penale të vetëgjyqësisë.

48.17 Subjekti ka listuar datat e kryerjes së veprimeve hetimore sipas akteve në dosje¹⁰⁷ dhe nën këtë konfirmim ka sqaruar se nuk qëndron fakti që nga muaji qershor deri në muajin dhjetor nuk ka pasur veprime hetimore.

48.18 Subjekti ka parashtruar se veprimtaria e organit procedues në kuadër të hetimit mbi faktin lidhet me kërkimin e informacionit dhe studimin e tij. Për shoqërinë private është kërkuar informacion, duke respektuar afatin 30-ditor për kthimin e përgjigjes. Nga ana e shoqërisë është kthyer përgjigje. Por, në rast se do të refuzonte kthimin e përgjigjes, nga ana e Prokurorisë do të zbatoheshin parashikimet e Kodit të Procedurës Penale mbi mënyrën e marrjes së dokumentit tek të tretët. Subjekti ka depozituar akte të këtij procedimi penal nr. ***.

48.19 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, në raport me ligjin e zbatueshëm në këtë çështje objekt shqyrtimi, arsyeton si vijon:

48.20 Nga aktet e dosjes të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues konstatoi se subjekti në periudhën qershor – dhjetor 2016 ka kryer veprime hetimore dhe konkretisht rezultoi të jenë mbajtur procesverbale në muajt qershor dhe shtator 2016, me persona që kanë dijeni për veprën penale, si dhe ka mbajtur korrespondencë me shoqërinë “L***”, në muajt qershor, korrik e tetor për kërkim dokumentacioni dhe në datën 16.12.2016 është përgatitur relacioni për përfundimin e hetimeve të këtij procedimi nga oficeri i policisë gjyqësore, i miratuar nga subjekti në të njëjtën datë, duke disponuar me vendim për pushimin e çështjes.

48.21 Lidhur me vonesën e pajustificuar të kthimit të përgjigjes mbi kërkesën për informacion dhe dokumentacion, adresuar shoqërisë turke “L***”, trupi gjykues nga aktet në dosje, në raport me shpjegimet e subjektit se kërkesat janë përsëritur, vlerëson se ato nuk janë bindëse, pasi nga të dhënat e dosjes rezultoi se subjekti është mjaftuar vetëm me dërgim shkresash në mënyrë të përsëritur ndaj të kallëzuarve, duke mbetur për muaj të tërë në pritje të përgjigjes, pa marrë masat e duhura për zbatimin e detyrave të konkretizuara në shkresat e përsëritura. Më konkretisht, subjekti nuk ka mundur kryerjen e veprimeve hetimore të tilla si, administrim dokumentesh apo kërkim për paraqitje pranë organit procedues, me mënyrat që njeh ligji, brenda afateve ligjore,

¹⁰⁶ Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ndodhej për gjykim çështja civile me nr. ** akti, datë 9.10.2015 dhe datë regjistrimi 12.10.2015, me palë paditës “S” sh.p.k. dhe të paditur “L***”, me objekt “Shlyerjen e detyrimeve për prishje të kontratës jashtë çdo pike të përcaktuar në kontratë; detyrimin për kryerjen e pagesave të prapambetura jashtë çdo afati; detyrimin për shpërblim dëmi me pasojë shkaktimin e dëmit financiar dhe prishjen e imazhit të “S” sh.p.k., si dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve të prapambetura”.

¹⁰⁷ Nga aktet e dosjes rezultoi se ka veprime hetimore në datën 6.6.2016, 7.6.2016, 27.6.2016, 19.7.2016, 27.9.2016, 19.9.2016, 26.9.2016, 3.10.2016, 4.10.2016, 14.10.2016, 16.12.2016.

të personit të cilësuar në shkresën drejtuar shoqërisë. Po nga aktet në dosje rezulton se përgjatë periudhës së pritjes së informacionit nga shoqëria e lartpërmendur nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera hetimore në kuadër të këtij procedimi penal. Nga aktet nuk rezulton të jetë pyetur shtetasi M.S, për të cilin në korrespondencën e organit të akuzës me shoqërinë turke “L****” është kërkuar njoftimi i tij për t’u paraqitur, por nga hetimi rezulton se subjekti është mjaftuar vetëm me konfirmimin e shoqërisë në përgjigjen e dhënë se ky shtetas nuk ndodhej në Shqipëri. Po ashtu, nuk rezultoi të ishin bërë përpjekje për të pyetur punëtorët të cilët rezultonin të shumtë në numër, për sa kohë pretendohet se kishin mbetur pa marrë pagesat e tyre për shkak të prishjes së kontratave të punës të lidhura drejtpërdrejt me kallëzuesin.

48.22 Në këtë çështje objekt vlerësimi, trupi gjykues çmon se nga ana e subjektit nuk janë ndërmarrë veprime hetimore të logjikshme, gjithëpërfshirëse, të plota dhe me efikasitet, të cilat mund të kishin hedhur dritë mbi rrethanat e faktit penal të kallëzuar, sipas nenit 72, pikat 2 e 3, si dhe nenit 74, pikat 4 e 5 të ligjit nr. 96/2016.

49. Denoncim¹⁰⁸ i shtetases SH.M

49.1 Shtetasja SH.M pretendon se subjekti i rivlerësimit ka marrë ryshfet 15.000 euro nëpërmjet avokatit për të ndihmuar nipin e saj A.M. Denoncuesja akuzon subjektin e rivlerësimit se ka ndryshuar vendngjarjen, ka ndryshuar akuzën nga plagosje me armë zjarri, në person i kapur me lëndë narkotike në automjetin e tij. Në denoncim, shtetasja M cilëson se me kërkesë të saj e ka rihapur çështjen 2 herë. Ajo ngre pretendimet se subjekti i rivlerësimit e ka mbyllur çështjen në bashkëpunim me dy subjekte të tjera nga Gjyqësori. Bashkëngjitur denoncimit, shtetasja M ka depozituar artikuj nga media e shkruar lidhur me ngjarjen e ndodhur.

49.2 Fillimisht Komisioni konstatoi se ankesa dhe kërkitimi i denoncueses (gjithnjë referuar përmbajtjes së shkruar) nën pretendimet e saj duken kontradiktore, por, pavarësisht kontekstit të denoncimit, Komisioni administroi kopje të fashikullit penal¹⁰⁹.

49.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje konstatohet se:

Subjekti dhe të tjerë prokurorë kanë regjistruar e ndjekur veprimet hetimore të procedimit penal nr. ***, datë 6.9.2004, për veprat penale të parashikuara nga nenet 78/1-22-25, 278/2 e 238 të Kodit Penal ndaj personave nën hetim L.M, R.T, S.K, A.M e B.K. Nga dokumentacioni i administruar duket se çështja ka qenë komplekse, e identifikuar kryesisht për konflikte me armë mes dy grupeve, ku në njërin prej tyre ka qenë i përfshirë edhe shtetasi A.M (nipi i denoncueses).

49.4 Sipas të dhënave të administruara, personat hetoheshin nën masën e sigurimit “Arrest në burg”. Në datën 7.3.2005, subjekti i rivlerësimit dhe një tjetër prokuror kanë vendosur pushimin e çështjes dhe lirimimin e menjëhershëm, pasi nga hetimi nuk është bërë i mundur identifikimi i autorëve të ngjarjes si për akuzën e vrasjes me paramendim, edhe për atë të trafikimit të lëndës narkotike.

49.5 Në datën 10.5.2005¹¹⁰, subjekti dhe një tjetër prokuror kanë vendosur pezullimin e hetimeve për shkak të moszbulimit të autorëve. Ky pezullim është shfuqizuar pas verifikimit të kryer nga drejtoria e luftës kundër krimit të organizuar në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm Tiranë dhe njëkohësisht është bërë edhe urdhërimi i kalimit të çështjes për kompetencë në Prokurorinë për Krimet e Rënda Tiranë.

¹⁰⁸ Nr. ***prot., datë 2.2.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹⁰ Sipas informacionit nr. ***, datë 23.6.2008, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, administruar në dosjen penale numërtuar 2/1.

49.6 Më tej, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (subjekti i rivlerësimit)¹¹¹ në datën 4.5.2006 ka vendosur bashkimin e disa procedimeve të viteve 1994, 2000, 2001, 2002 dhe 2003 në një të vetëm, në procedimin penal nr. ***.

49.7 Në datën 5.5.2006, subjekti i rivlerësimit ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve Prokurorisë për Krimet e Rënda Tiranë. Kjo e fundit ka regjistruar procedimin penal nr. *** dhe pas hetimeve të kryera në datën 23.7.2008 ka vendosur pezullimin e hetimeve të këtij procedimi penal dhe dërgimin e akteve të fashikujve policisë.

49.8 Me vendimin nr. ***, datë 8.1.2009, të Prokurores së Përgjithshme, është vendosur shfuqizimi i pjesshëm i vendimit të pezullimit të hetimeve të procedimit penal nr. ***, regjistrimi i procedimit të ngjarjes së datës 3.9.2004 (pra, i procedimit nr. ***) si një procedim i veçantë dhe vazhdimi i hetimeve.

49.9 Rezulton se në vendimin e shfuqizimit arsyetohet se për ngjarjen e vitit 2004 nuk janë kryer hetime të plota dhe se lind e nevojshme kryerja e më shumë veprimeve hetimore, të cilat gjithashtu janë renditur kronologjikisht. Po në këtë vendim cilësohet se vendimet e pushimit të dhëna nga subjekti janë të pambështetura në ligj e në prova, pasi nga studimi i akteve ka rezultuar se ka pasur të dhëna për autorët e dyshuar të kësaj ngjarjeje. Lidhur me këtë konstatim, Komisioni¹¹² i kaloi subjektit barrën e provës për të shpjeguar dhe dokumentuar të kundërtën.

49.10 Gjithashtu, në vendim thuhet se për sa kohë për procedimet e mëparshme (të bashkuara në një të vetëm) nuk ka të dhëna lidhur me autorët e mundshëm të ngjarjeve, çështja që i përket ngjarjes së datës 3.9.2004 duhet veçuar e vijuar me hetime, ndërsa për procedimet e tjera vendimi nuk shfuqizohet. Pas kësaj vendimmarrjeje, drejtuesi i organit të akuzës ka regjistruar procedimin nr. ***, datë 27.1.2009, në ngarkim të personave të lartpërmendur, akuzuar për të njëjtat vepra penale si më lart cituar, përfshirë edhe dispozitën e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, duke caktuar hetimet që duhet të kryheshin, si dhe afatin e kryerjes së tyre brenda datës 30.3.2009.

49.10.1 Komisioni, në analizë të të dhënave të dala, i kërkoi subjektit shpjegime, pasi dukej se ky afat nuk është zbatuar ndërsa kanë rezultuar shtyrje tremujore të njëpasnjëshme (sikurse do të referohen/arsyetohen në vijim).

49.11 Pas këtij regjistrimi rezulton se për këtë çështje është zgjatur afati i kryerjes së hetimeve (me vendime të subjektit të rivlerësimit dhe të tjerë prokurorëve) katër herë me nga 3 muaj.

49.12 Mbi ankimin e personave të akuzuar¹¹³, të cilët kanë provuar se edhe për vendimet e zgjatjes së hetimeve janë njoftuar përtej çdo afati të mundshëm ligjor (pas 10 muajve) dhe, po ashtu, kanë kërkuar pavlefshmërinë e vendimeve të zgjatjes së afateve të hetimit, si dhe papërdorshmërinë e tyre pas datës 27.4.2009¹¹⁴ deri në datën 27.4.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin e saj nr. ***, datë 22.2.2010, ka pranuar kërkesën e të akuzuarve dhe ka vendosur sipas objektit të saj. Ky vendim ka mbetur në fuqi deri në Gjykatën e Lartë pas mospranimit të rekursit.

49.13 Ndërkohë, në datën 5.2.2010, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për shtetasit R.T, S.K dhe B.K, akuzuar për vepra të

¹¹¹ Sipas informacionit nr. ***, datë 23.6.2008, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, administruar në dosjen penale numërtuar 2/1.

¹¹² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹¹³ Referuar arsytimit dhe fakteve të përmendura në vendimin nr. ***, datë 26.7.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, administruar në dosjen penale, numërtuar si vëllimi 4, nuk rezulton që të ketë ushtruar ankim shtetasi A.M, i cili sipas procesverbalit datë 13.11.2006¹¹³, i mbajtur në Ambasadën Shqiptare në Greqi, rezulton se është larguar për në këtë shtet si rezident i atjeshëm që në momentin e pushimit të çështjes dhe liritimit nga arresti me burg në datën 7.3.2005.

¹¹⁴ Deri në këtë datë ka qenë tremujori i parë nga regjistrimi i procedimit, kohë kur duhej të vendosej mbi çështjen, sipas nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale.

ndryshme penale dhe në datën 9.2.2010 subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për marrjen e shtetasit L.M si të pandehur dhe për njoftimin e akuzës.

49.14 Ndonëse vendimi i gjykatës për pavlefshmërinë e akteve të nxjerra pas tremujorit të parë nga regjistrimi i procedimit penal nr. *** ka qenë i formës së prerë, përsëri subjekti i rivlerësimit në datën 21.4.2010¹¹⁵ ka marrë vendim për zgjatjen e afateve të hetimeve dhe ka vendosur zgjatjen edhe me 3 muaj të tjerë, deri më 21.7.2010, vendim i cili rezulton i njoftuar në datën 19.7.2010.

49.14.1 Në analizë të fakteve të dala, Komisioni¹¹⁶ i kaloi subjektit barrën e provës për të shpjeguar lidhur me faktin se njoftimi i shtyrjes së vendimeve të zgjatjes së hetimeve dukej se ishte bërë në tejkalim të çdo afati të mundshëm.

49.15 Në datën 14.7.2010, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njëkohësisht ka njoftuar edhe akuzën (për tre personat e lartpërmendur, R.T, S.K dhe B.K), ndërsa vendimi i zgjatjes së afateve i datës 21.4.2010 u është njoftuar të akuzuarve në datën 19.7.2010.

49.15.1 Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime dhe dokumentacion për të provuar të kundërtën e konstatimit, ku dukej se njoftimi i vendimit të datës 21.4.2010 për zgjatjen e afatit të kryerjes së hetimeve ishte i pabazë apo i pavlerë në raport me vendimin e marrë katër ditë më parë, në datën 14.7.2010, për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës.

49.16 Pas njoftimit të akuzës mbi kërkesën për gjykimin e çështjes, datë 20.7.2010 dhe vendimin e subjektit të rivlerësimit dhe një prokurori tjetër, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjiqësor Elbasan¹¹⁷ me vendimin e saj nr. ***, datë 19.12.2012, ndër të tjera ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të gjithë të pandehurve, përfshirë edhe të akuzuarin A.M, vendim i ankimuar nga subjekti i rivlerësimit dhe një tjetër prokuror.

49.17 Sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit për gjykimin e çështjes, janë referuar kryesisht veprimet hetimore të kryera në vitin 2004, për të cilën subjekti në vitin 2005 kishte rezultuar në pushimin e çështjes, lirimin e të dyshuarve dhe vijimin e hetimeve, për të cilën subjekti iu kërkuan¹¹⁸ shpjegime, si dhe të depozitonte vendimin nr. ***, datë 19.12.2012, dhe dokumentacion vërtetues lidhur me statusin aktual të çështjes.

49.18 Në qëndrimin e saj në funksion të barrës së provës për këtë çështje, subjekti ka parashtruar se kjo denoncuese ngre pretendime të paqena *“Nisur nga fakti që unë kam qenë një nga prokurorët që kam hetuar nipin e saj, duke iu nënshtruar masës së sigurimit “Arrest në burg”, si dhe mbi faktin që në kuadër të grupit hetimor të krijuar nga drejtuesi i Prokurorisë kam vendosur për rifillimin e hetimeve, në kuadër të bashkimit të procedimeve penale. Në momentet e regjistrimit të këtij procedimi penal nuk kam qenë ajo prokurorja që ka ndjekur hetimet, por është bërë pjesë e grupit hetimor, me përcaktim të drejtuesit të Prokurorisë, sipas legjislacionit të kohës, pasi hetimet kishin filluar në lidhje me këtë ngjarje dhe pasi ishin kryer të gjitha veprimet e papërsëritshme, përfshirë dhe vendngjarjen, ku këto veprime ishin kryer në kuadër të drejtimit të veprimeve hetimore nga prokurorë të tjerë”*.

49.19 Subjekti ka shpjeguar se kjo çështje ka qenë tepër komplekse, ku personat e dyshuar janë hetuar edhe nën masa sigurimi, me kufizim lirie. Në përfundim të hetimeve nuk arrihej të provohej se personat nën hetim kishin konsumuar veprat penale për të cilat dyshoheshin. Ndaj personave të

¹¹⁵ Datë që është marrë edhe vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Elbasan, nr. ***.

¹¹⁶ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹¹⁷ Sipas shtesë ankimit të administruar në vëllimin nr. *** të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Elbasan.

¹¹⁸ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

dyshuar është vendosur pushimi i hetimeve dhe çështja penale është pezulluar duke kaluar për vazhdimin e hetimeve pranë Drejtorisë së Policisë Elbasan. Vendimmarrja është kryer pas bërjes së analizës dhe vlerësimit të provave të mundshme për t'u grumbulluar mbi faktin nga prokurorët që përbënin grupin hetimor, si dhe grupi i oficerëve të policisë gjyqësore, të ngarkuar me kryerjen e veprimeve hetimore. Oficerët e policisë gjyqësore mendimin e tyre e kanë dokumentuar nëpërmjet relacionit për përfundimin e hetimeve, ndërsa prokurorët me vendimmarrjet përkatëse. Me provat e mundshme për t'u grumbulluar mbi faktin nuk arrihej të provohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësia e personave ndaj të cilëve ishte zbatuar dhe masa e sigurimit.

49.20 Subjekti ka shpjeguar se përpara se të pezulloheshin hetimet, dosja është dërguar për vlerësim në Drejtorinë e Krimit të Organizuar në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm Tiranë. Me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2005, kjo zyrë ka dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan fashikullin e procedimit penal nr. *** të vitit 2004, me udhëzimin që procedimi penal të pezullohet dhe kalohet për zbulim të autorëve në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Elbasan. Drejtoria e Luftës kundër Krimit të Organizuar në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm Tiranë, e cila e kishte studiuar edhe më parë dosjen nr. *** dhe e kishte orientuar për pezullimin e hetimeve, nuk ka urdhëruar vetëm rifillimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. *** të vitit 2004. Kjo drejtori, pasi ka kërkuar informacion nga drejtoritë e policive vendore, ku gjendeshin dosjet penale të pezulluara, mbi të dhënat shtesë që kishte siguruar Policia e Shtetit gjatë kësaj kohe, është vendosur rifillimi i hetimeve për një grup dosjesh, bashkimi i këtyre procedimeve dhe, për shkak të krijimit të Gjykatës për Krime të Rënda si një gjykatë speciale, është vendosur kalimi i akteve të këtyre procedimeve penale pranë kësaj gjykate. Prokurorët pranë Gjykatës për Krime të Rënda në përfundim të hetimeve kanë vendosur që mbi bazën e provave të grumbulluara nuk mund të ngrihej akuzë, ndaj është vendosur pezullimi i hetimeve. Pra, edhe një grup tjetër i specializuar prokurorësh ka vlerësuar se nuk provohej autorësia e personave të dyshuar, ndaj ka pezulluar hetimet.

49.21 Sipas subjektit: *“Prokurori i Përgjithshëm ka shfuqizuar vendimin e pezullimit të hetimeve të marrë nga Prokuroria për Krime të Rënda, si dhe vazhdimin e hetimeve në lidhje me ngjarjen e datës 3.9.2004. Në vendimin e Prokurorit të Përgjithshëm vlerësohet se lind e nevojshme kryerja e veprimeve hetimore shtesë, përveç atyre veprimeve hetimore të kryera. Për sa i përket autorëve të dyshuar, ata iu nënshtruan masave të sigurimit bazuar në ato të dhëna që krijonin dyshimin për ta, por me nivelin e provueshmërisë së atyre provave të grumbulluara nuk mund të ngrihej akuzë, kjo vlerësuar edhe nga Drejtoria e Krimit të Organizuar në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm. Vendimmarrja për pushimin dhe pezullimin e hetimeve ka qenë e bazuar në ligj dhe në prova. Nuk ka të bëjë vetëm me një vendimmarrje personale timen, si një prokuror i vetëm. Ky konkluzion nuk ka qenë vetëm vlerësimi im, por edhe i grupit të oficerëve që kryen veprimet hetimore, Prokurorëve që përbënin grupin hetimor në Prokurorinë Elbasan, prokurorëve në Prokurorinë për Krimet e Rënda dhe në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm. Vazhdimi i hetimeve në vitin 2009 lidhet me sigurimin e të dhënave shtesë nga ana e oficerëve të Policisë së Shtetit të ngarkuar me hetimin”.*

49.22 Në vijim, subjekti parashtroi se në vitin 2009, krahas saj, grupi hetimor kryesohej nga drejtuesi i Prokurorisë, po kështu pjesë e grupit hetimor ka qenë edhe zëvendësdrejtuesi i Prokurorisë. Vendimmarrja ka qenë kolektive, pasi studioheshin provat e grumbulluara dhe hartohej plani hetimor. Zgjatjet e hetimeve përtej afatit 3-mujor kanë qenë më se të domosdoshme. Kemi pasur të bëjmë me hetim kompleks dhe përdorim të metodave hetimore proaktive, si përgjime apo vëzhgime ambientale. Veprimet hetimore të kryera dhe aktet procedurale të përgatitura në kuadër të këtij hetimi dëshmojnë për kompleksitetin e hetimeve. Ka qenë e pamundur që hetimet të përfundonin brenda tre muajve. Nga sa ka rezultuar nga përgjimet e komunikimeve telefonike të lejuara me vendim gjyqësor, duhej verifikuar. Po kështu, janë marrë akte procedurale nëpërmjet letërporosisë etj., veprime hetimore këto që nuk mund të kryheshin brenda një afati 3-mujor. Neni

279 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se aktet hetimore janë sekrete, derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Në rast nevojë për vazhdimin e hetimeve, prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve. Për shkak të rëndësisë së hetimit, veprimet hetimore kanë qenë sekret. Kodi i Procedurës Penale parashikon se në rastet kur prokurori çmon se nga dorëzimi në sekretari i akteve të përgjimit mund të dëmtohen hetimet, ai i kërkon gjykatës shtyrjen e depozitimit të akteve deri në përfundimin e hetimeve, neni 223/3 i Kodit të Procedurës Penale. Në çështjen objekt gjykimi, referuar përmbajtjes së vendimeve që kanë lejuar përgjimet e komunikimeve telefonike, gjykata ka urdhëruar depozitimin e akteve të përgjimit në sekretari në përfundim të hetimeve. Sipas subjektit, njoftimi i zgjatjeve nuk është bërë në tejkallim të afateve, por për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor komunikimi i zgjatjeve është realizuar në momentin e duhur procedural, procedurë kjo plotësisht në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

49.23 Sipas subjektit, grupi hetimor ka vlerësuar se çështja penale duhej dërguar për gjykim, pavarësisht mosmiratimit të afatit të zgjatjes së hetimeve nga ana e gjykatës me provat e grumbulluara deri në fazën pa u marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve. Gjukata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka shfuqizuar zgjatjet e afatit hetimor, por kjo ligjërisht nuk çonte automatikisht në mosvazhdimin e procedurave në lidhje me hetimet që po kryheshin. Pas shfuqizimit të vendimit për zgjatjen e afatit hetimor nuk mund të kryheshin më veprime për grumbullimin e provave, por akte procedurale si njoftimi i akuzës, përfundimi i hetimeve, dërgimi i çështjes për gjykim nga prokurori mund të bëhej pasi veprimet hetimore për të siguruar prova dhe hartimi i akteve procedurale nga ana e Prokurorit janë dy gjëra të ndryshme. Grupi hetimor pas shfuqizimit të vendimeve për zgjatjen e afatit hetimor ka hartuar vetëm akte procedurale dhe nuk ka kryer veprime hetimore për të marrë prova. Në kohën që është bërë zgjatja e fundit e hetimeve, nuk ka pasur një vendim përfundimtar në dosje në lidhje me qëndrimet që do të mbanin gjykatat më të larta për faktin e vlefshmërisë apo jo të zgjatjeve të mëparshme. Në kërkesën për gjykim referohen kryesisht veprimet hetimore të kryera deri në zgjatjen e parë të hetimeve, që nuk është miratuar me vendim gjyqësor.

49.24 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, në raport me ligjin e zbatueshëm në këtë çështje objekt shqyrtimi, arsyeton si vijon:

49.25 Rezultoi se ky procedim penal është regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 6.9.2004 për veprat penale të parashikuara nga nenet 78/1-22-25, 278/2 e 283 të Kodit Penal dhe, në mars të vitit 2005, në lidhje me shtetasit e akuzuar, të cilët hetoheshin nën masën e sigurimit “Arrest në burg”, është vendosur pushimi i çështjes në ngarkim të tyre, si dhe lirimi i menjëhershëm i tyre duke vazhduar hetimet për ngjarjen. Mbi bazën e shfuqizimit të këtij vendimi nga drejtuesi i Prokurorisë në vitin 2009, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të personave të dyshuar dhe akuzuar për të njëjtat vepra penale si në vitin 2004.

49.26 Rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe një prokuror tjetër pas regjistrimit të këtij procedimi në vitin 2009 për këtë çështje kanë zgjatur afatin e kryerjes së hetimeve katër herë me nga tre muaj, akte të cilat u janë njoftuar personave të akuzuar përtej çdo afati të mundshëm ligjor (pas 10 muajve) e, për pasojë, ata kanë kërkuar pavlefshmërinë e vendimeve të zgjatjes së afateve të hetimit, si dhe papërdorshmërinë e tyre pas datës 27.4.2009¹¹⁹ deri në datën 27.4.2010. Gjukata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. ***, datë 22.2.2010, ka pranuar kërkesën e të akuzuarve

¹¹⁹ Deri në këtë datë ka qenë tremujori i parë nga regjistrimi i procedimit, kohë kur duhej të vendosej mbi çështjen sipas nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale.

dhe ka vendosur sipas objektit të saj. Ky vendim ka mbetur në fuqi deri në Gjykatën e Lartë pas mospranimit të rekursit.

49.27 Trupit gjykues për këto konstatime, të konfirmuara edhe nga gjykata, i rezultoi se subjekti, ndonëse në të gjitha vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve në pikën 2 të dispozitivit parashikonte të drejtën e ankimit nga të pandehurit dhe e dëmtuara brenda 10 ditëve nga njoftimi, ato u janë njoftuar palëve pas dhjetë muajsh. Rezulton se edhe pse vendimi i gjykatës për pavlefshmërinë e akteve të nxjerra pas tremujorit të parë nga regjistrimi i procedimit penal nr. *** ka qenë i formës së prerë, përsëri subjekti i rivlerësimit në datën 21.4.2010¹²⁰ ka marrë vendim për zgjatjen e afateve të hetimeve dhe ka vendosur zgjatjen edhe me tre muaj të tjerë deri më 21.7.2010, vendim i cili rezultoi i njoftuar në datën 19.7.2010, veprim ky i kryer në kundërshtim me nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale. Në këto rrethana, trupi gjykues çmon se aktet procedurale janë disponuar në kundërshtim me detyrimin për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka kryer interpretim të saktë të zbatimit të nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: *“Kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund të kalojë dy vjet dhe vendimi për zgjatje të afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit”*. Në vlerësimin e trupit gjykues, kjo dispozitë duhet parë në harmoni me nenin 323¹²¹, sipas të cilit afati i hetimeve paraprake nuk lidhet me datën e regjistrimit të procedimit penal apo të reregjistrimit në vitin 2009, por me datën në të cilën regjistrohet emri i personit nën hetim në regjistrin e njoftimeve të veprës penale, çka do të thotë se është e lidhur ngushtë me subjektin e veprës penale.

49.28 Trupi gjykues, shpjegimet e subjektit se *në këtë çështje ka qenë e nevojshme kryerja e një sërë veprimesh të tjera hetimore, ndaj dhe zgjatjet e hetimeve përtej afatit 3-mujor kanë qenë më se të domosdoshme, pasi hetimi ka qenë kompleks dhe se për të janë përdorur metoda hetimore proaktive*, vlerëson se ato nuk janë të përligjura në raport me detyrimin e subjektit për kryerjen e veprimtarisë hetimore konform rregullave procedurale që diktojnë parashikimet e ligjit procedural penal.

49.29 Po ashtu, pretendimi i subjektit se njoftimi i zgjatjes së afateve nuk është bërë në tejkalim të afateve, por për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor, komunikimi i tyre është realizuar në momentin e duhur procedural, procedurë kjo plotësisht në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, nuk gjendet nga trupi gjykues i materializuar në veprimtarinë hetimore të kryer, sikurse as në qëndrimin e saj përpara gjykatës.

49.30 Lidhur me këto rrethana, trupi gjykues konstaton se nga subjekti i rivlerësimit dhe një tjetër subjekt janë ndërmarrë akte procedurale tej afatit ligjor në kundërshtim me nenet 324 , 325 , 327 e 331 të Kodit të Procedurës Penale, nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, neni 6/3 (a) i saj, duke i çmuar ato si shkelje të parashikimeve të ligjit procedural penal.

49.31 Trupi gjykues në këtë çështje objekt vlerësimi çmon se:

i. Moskryerja e veprimeve hetimore të plota e gjithëpërfshirëse që në vitin 2004, sikurse është konfirmuar edhe me vendimin e shfuqizimit nga drejtuesi i prokurorisë në atë kohë, ku arsyetohet se për ngjarjen e vitit 2004 nuk janë kryer hetime të plota dhe se lind e nevojshme kryerja e më shumë veprimeve hetimore, pasi nga studimi i akteve ka rezultuar se ka pasur të dhëna për autorët e dyshuar të kësaj ngjarjeje.

¹²⁰ Datë që është marrë edhe vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës për lënien në fuqi të vendimit nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

¹²¹ Afati i përfundimit të hetimeve është 3 muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale, është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale...

ii. Moszbatimi korrekt i parashikimeve procedurale penale, që passolli pavlefshmërinë dhe/ose papërdorshmërinë e akteve.

iii. Procesimi i subjektit me kërkesën për gjykim, duke ngritur akuzën ndaj shtetasve në fjalë, duke përdorur të njëjtin hetim të kryer në vitin 2004 dhe veprimet hetimore që u shpallën të pavlefshme nga gjykata, janë rrethana që tregojnë mangësi domethënëse profesionale të subjektit.

49.32 Në përfundim, trupi gjykues, për sa ka rezultuar nga hetimi i Komisionit, vlerëson se moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, moszbatimi korrekt i parashikimeve procedurale penale, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, dhe duhen të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

50. Denoncim¹²² i shtetasit F.K

50.1 Shtetasi F.K ankohet për shumë subjekte rivlerësimi si në organin e akuzës, edhe në atë të gjyqësorit, ndër ta edhe për subjektin e rivlerësimit. Në denoncimin e tij, shtetasi K pretendon se subjekti i rivlerësimit, në bashkëpunim me të tjera subjekte dhe OPGJ-në XH.M, ka ndryshuar dhe falsifikuar provat dhe faktet në mbrojtje të krimit të organizuar, si dhe kanë shpërdoruar detyrën.

50.2 Denoncuesi sqaron se në datën 12.2.2007 është depozituar prej tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan kallëzimi penal për krim të organizuar, bazuar në nenin 186 të Kodit Penal. Në kallëzim cilësohet se shkak i konfliktit për pronësinë e tij është bërë ligjshmëria e një kontrate noteriale, hartuar në vitin 2004. Kontrata noteriale e shitjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë 2.3.2004, për shitjen e truallit nën banesë, me palë shitëse shtetasen A.SH, banuese në Amerikë, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shtetasi B.P, banues në Elbasan, palë blerëse shtetasi R.E, sipas pretendimeve të denoncuesit është bërë në kundërshtim të ligjit nga notere N.GJ. Në hartimin e saj është përdorur një prokurë e përkthyer, e falsifikuar dhe e palegalizuar. Kjo kontratë noteriale shitjeje është përdorur për të nxjerrë një dokument hipotekor nga punonjësit e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive. Denoncuesi në kallëzimin e tij shpreh se pala blerëse kontratën noteriale të shitjes e ka përdorur në institucione shtetërore dhe private dhe nga përdorimi i saj ai dhe familja e tij ka pësuar humbje të banesës dhe një dëm prej 50 milionë lekësh. Denoncuesi ngre pretendimin se për shkak të miqësisë dhe njohjeve me noteren GJ, subjekti i rivlerësimit në bashkëpunim me të tjera subjekte, gjatë hetimit qëllimisht dhe me dashje kanë falsifikuar provat dhe faktet, si dhe fillimisht në datën 2.3.2007 ka marrë vendim për mosfillim të procedimit penal, më pas në datën 17.12.2007 ka marrë vendim për pushimin e çështjes. Të dyja këto vendime janë rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe i janë kthyer Prokurorisë për vazhdim të hetimit. Ndodhur përpara këtij fakti, denoncuesi ka kërkuar përjashtimin e subjektit nga hetimi i çështjes dhe ka bërë kallëzim penal në datën 12.2.2007 për të dhe OPGJ-në XH.M për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

50.3 Me formularin e denoncimit ai ka bashkëlidhur disa dokumente mbi procesin hetimor ndër vite për këtë çështje¹²³.

50.4 Në bazë të dokumentacionit të depozituar, Komisioni konstatoi se shtetasi F.K ka një konflikt pronësor, nga i cili ka humbur banesën e tij. Konflikti ka ardhur nga shitja e tokës në të cilën ishte ngritur banesa e tij, përfituar nga sektori i privatizimit në vitin 1999, shitje e bërë nga shtetasja A.SH në cilësinë e pronares së truallit me banim në Amerikë, përfaqësuar me prokurë të posaçme

¹²² Nr. ***, datë 13.12.2017, administruar në dosjen e Komisionit.

¹²³ Konstatohet se në materialin informues nga denoncuesi për subjektin e rivlerësimit me nr. ***, datë 7.12.2007, janë 26 fletë, por të depozituara vetëm 4 fletë.

nga shtetasi B.P. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka gjykuar këtë çështje civile dhe ka vendosur në favor të shtetases A.SH. Nga ky vendim shtetasi K ka humbur banesën e tij, e cila është prishur nga blerësi i truallit.

50.5 Në lidhje me hetimin e materialit kallëzues, rezultoi se në datën 12.2.2007 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar materialin hetimor nr.*** lidhur me kallëzimin e shtetasit F.K. Në kallëzimin e tij, shtetasi K pretendon se tjetërsimi i pasurisë, shitje e truallit ku ndodhej e ndërtuar banesa e tij, është bërë në kundërshtim me ligjin nga përdorimi i një dokumenti prokurë e posaçme, e falsifikuar dhe e palegalizuar.

50.6 Në datën 2.3.2007, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillim të procedimit penal. Për këtë vendim shtetasi K ka bërë ankim. *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan në arsyetimin e saj ka cilësuar të ligjshme ankesën dhe ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetim të plotë.* Për sa i përket dokumentit prokurë e posaçme, gjykata shprehet se nga aktet e dosjes së hetimit është konstatuar që dokumenti është i hartuar në gjuhën angleze pranë një noteri në Amerikë, përkthyer në Shqipëri, është dokument i palegalizuar dhe në kundërshtim të ligjit¹²⁴ dhe VKM-së¹²⁵ datë 7.3.2003. Ky dokument është përdorur për llogari të shtetases Sh nga shtetasi B.P si për tjetërsimin e pronës në kontratën e shitjes, hartuar nga notere N.GJ, ashtu edhe për regjistrim të saj, të ndryshuar në ZVRPP-në Elbasan. Gjykata me vendimin nr. *** , datë 18.5.2007, ka vendosur prishjen e vendimit “Për mosfillim të procedimit penal”, datë 2.3.2007, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, kthimin e çështjes për vazhdim dhe plotësim të hetimit të saj. Gjykata nuk ka pranuar kërkesën e shtetasit F.K për kalimin e materialit hetimor në një prokurori tjetër. Vendimi i Gjykatës nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë në datën 28.5.2007.

50.7 Në datën 7.6.2007 është bërë regjistrimi i procedimit penal në ngarkim nr. *** , për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal.

50.8 Në datën 17.12.2007, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes. Konstatohet se në vendimin për pushimin e çështjes subjekti i rivlerësimit ka kryer hetim për detyrat e lëna nga gjykata në vendimin nr. *** , datë 18.5.2007.

50.9 Është bërë akti i ekspertimit nr. *** , datë 17.7.2007, ku konstatohet se dokumenti prokurë e posaçme i përket muajit tetor 2001 dhe është përkthyer e noterizuar në vitin 2002.

50.10 Subjekti shprehet në vendimin e saj të pushimit të çështjes se dokumenti prokurë e posaçme është përpiluar dhe lëshuar nga një autoritet i huaj edhe pse është përdorur në kundërshtim me ligjin si për hartimin e kontratës së shitjes nga notere N.GJ, ashtu edhe në dokumentacionin e ZVRPP-së Elbasan, nuk ka cenuar të drejtat e shtetasit K. Subjekti i rivlerësimit në datën 17.12.2007 ka dhënë vendimin për pushim të çështjes.

50.11 Komisioni e ka pyetur subjektin¹²⁶ lidhur me pretendimet e denoncuesit. Në përgjigjen e dhënë, subjekti ka deklaruar se shtetasi F.K ka paraqitur kallëzimin penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me nr. *** sekretarie, datë 12.2.2007, ku ka depozituar edhe akte. Shtetasi F.K në datën 12.2.2007 ka paraqitur kallëzim për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në lidhje me ligjshmërinë e prokurës dhe veprimeve të kryera në bazë të saj pranë organeve shtetërore apo noteres N.GJ.

¹²⁴ Ligji nr. 9060, datë 5.8.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”.

¹²⁵ VKM nr. 134, datë 7.3.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja për përdorim brenda vendit”.

¹²⁶ Me pyetësin nr. 2, datë 10.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

50.12 Lidhur me këtë kallëzim penal, pas verifikimeve përkatëse është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 2.3.2007. Ky vendim i është njoftuar shtetasit F.K, i cili e ka ankimuar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Gjykata me vendimin nr. ***, datë 18.5.2007, ka vendosur “Pranimin e kërkesës ankimore të shtetasit; Prishjen e vendimit për mosfillimin e procedimit penal, datë 2.3.2007, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”, duke e urdhëruar atë për vazhdimin e hetimeve lidhur me këtë procedim penal. Prishja e vendimit të mosfillimit është bërë nisur nga fakti që prokura që ishte bërë pjesë e dosjes së verifikimit të kallëzimit penal, ishte pa vulë apostile, ndërsa në lidhje me pretendimet e ankuesit gjykata në përmbajtjen e vendimit shprehet tekstualisht se: *“Pretendimeve të ngritura nga ankuesi për kallëzimet e mëparshme, me vendimet përkatëse të Prokurorisë, Gjykatës së Faktit dhe Gjykatës së Apelit i është dhënë rrugë ligjore”*.

50.13 Pas marrjes formë të prerë në datën 28.5.2007, ky vendim i është dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2007, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Mbi këtë bazë, në datën 7.6.2007 është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me prokuror hetimi Pranvera Stafa dhe oficer të policisë gjyqësore XH.M.

50.14 Mbi kërkesën e paraqitur nga shtetasi F.K në datën 18.6.2007, në të cilën ka kërkuar që ky procedim të mos hetohet nga prokurorja Pranvera Stafa dhe oficer XH.M, me arsyetimin se ato e kanë dhënë një herë mendimin për këtë çështje, nga ana e drejtuesit të Prokurorisë së asaj kohe, me vendimin datë 22.6.2007 është vendosur mospranimi i kërkesës së paraqitur nga shtetasi F.K.

50.15 Shtetasi F.K ka bërë kallëzime penale për të njëjtin fakt herë pas here në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, të cilat janë hetuar nga prokurorë të ndryshëm të kësaj prokurorie dhe mbi vendimmarrjen e tyre ky shtetas ka pasur pretendime, edhe pse gjykata vendimmarrjen e prokurorisë e ka gjetur të drejtë. *“Pavarësisht këtyre vendimeve, pas regjistrimit të procedimit penal nr. ***, datë 7.6.2007, nga ana jonë janë kryer një sërë veprimesh hetimore për hetimin e plotë dhe të gjithanshëm të çështjes. Pas përpilimit të relacionit në datën 14.12.2007, nga oficeri i policisë gjyqësore dhe dorëzimit të akteve në datën 17.12.2007, është vendosur pushimi i hetimeve për procedimin penal nr. ***, viti 2007”*.

50.16 Lidhur me përfundimin e hetimeve është vënë në dijeni shtetasi F.K. Dosja ka kaluar kontrollin sipas rregullit që ishte në atë kohë, duke u miratuar nga drejtuesi i prokurorisë i atëhershëm dhe është arkivuar.

50.17 Shtetasi F.K ka paraqitur ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe çështja është pushuar, pasi ky shtetas nuk është paraqitur. Për këtë rast është marrë vendimi nr. ***, datë 17.4.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

50.18 Lidhur me ankimin e paraqitur nga shtetasi F.K ka edhe korrespondencë me Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë, ku me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2008, njoftohet kjo Prokurori se ky shtetas ka paraqitur ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. *** të vitit 2007, si dhe i është kthyer përgjigje këtij shtetasi për ndjekjen e problemit të tij në gjykatë.

50.19 Pas përfundimit të gjykimit në datën 17.4.2008, nga ana e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 18.4.2008, është njoftuar Prokuroria e Përgjithshme Tiranë.

50.20 Rezulton se shtetasi F.K ka paraqitur përsëri ankim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ndaj vendimit të pushimit për procedimin penal nr.***, viti 2007 dhe në seancë gjyqësore

ka hequr dorë nga kjo kërkesë. Për këtë rast është marrë vendimi nr. ***, datë 9.12.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

50.21 Nga aktet rezulton se në datën 6.1.2009 nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Elbasan në atë kohë është marrë vendim për shfuqizimin e vendimit të pushimit në datën 17.12.2007 lidhur me procedimin penal nr. *** të vitit 2007, me arsyetimin se ndaj këtij vendimi ka paraqitur pretendimet e tij shtetasi F.K, duke kërkuar kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, depozituar kjo kërkesë në Prokurorinë e Rrethit Elbasan me nr. *** prot., datë 18.12.2008. Për hetimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje, nga ana e drejtuesit të Prokurorisë në këtë vendim është caktuar prokuror dhe oficer tjetër.

50.22 Në përfundim të hetimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në datën 8.11.2019 ka disponuar me kërkesë për pushimin e çështjes. Kërkesa për pushim i është përcjellë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 22.11.2019. Çështja është ende në gjykim pranë kësaj gjykate.

50.23 Subjekti ka depozituar akte të marra nga procedimi penal nr. ***, viti 2018, i bashkuar me procedimin e mëparshëm¹²⁷.

50.24 Për sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kërkoj subjektit shpjegime, pasi dukej se në këtë çështje nuk ka vepruar në përputhje me nenin 72 pika 3 e ligjit nr. 96/2016 dhe, për pasojë, ka ardhur prishja e përsëritur e vendimeve të marra mbi Mosfillimin e çështjes – në datën 2.3.2007 dhe më tej mbi pushimin e saj – në datën 17.12.2007.

50.25 Në qëndrimin e saj lidhur me këtë konstatim, subjekti ka parashtruar se Gjykata me vendimin nr. ***, datë 18.5.2007, ka vendosur prishjen e vendimit “Për mosfillim të procedimit penal”, datë 2.3.2007, me argumentin se prokura e posaçme është konstatuar që është dokument i hartuar në gjuhën angleze pranë një noteri në Amerikë, përkthyer në Shqipëri, është dokument i palegalizuar dhe është në kundërshtim të ligjit dhe VKM-së datë 7.3.2003. Ky dokument është përdorur për llogari të shtetases SH nga shtetasi B.P si për tjetërsimin e pronës në kontratën e shitjes, hartuar nga notere N.GJ, ashtu edhe për regjistrim të saj, të ndryshuar në ZVRPP-në Elbasan. Ky konstatim i gjykatës nuk dëshmon për ekzistencën e një vepr penale. Në gjykatë nuk u soll ndonjë e dhënë që të krijonte bindje për gjykatën se kemi të bëjmë me një prokurë të falsifikuar.

50.26 Sipas subjektit, fakti që një prokurë është noterizuar nga noteri pa pasur vulë apostile, nuk përbën vepër penale. Noteri vërteton vetëm nëse dokumenti që po noterizon është apo jo i njëjtë me origjinalin. Fakti që nuk ka vulë apostile nuk ndalon noterizimin e dokumenteve. Personi që paraqet dokumentin për noterizim mban përgjegjësi për vërtetësinë e dokumentit. Është detyrë e gjykatës që të mos pranojë administrimin e dokumenteve që nuk janë në formën e kërkuar nga ligji. Gjykata Civile nuk ka konstatuar mungesën e vulës apostile.

50.27 Subjekti ka shpjeguar se vendimi i mosfillimit është marrë duke u bazuar edhe në faktin që pretendimet e ngritura nga ankuesi ishin parashtruar edhe në kallëzime të mëparshme të

¹²⁷ Kërkesë për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. *** të vitit 2018; kallëzimin e shtetasit F.K, datë 12.2.2007 dhe nr. ***, datë 19.9.2018; vendim mosfillimi të procedimit penal, datë 2.3.2007; vendim nr. ***, datë 18.5.2007, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; urdhër regjistrimi procedimi penal nr. *** të vitit 2007; vendim datë 22.6.2007 për mospranimin e kërkesës së paraqitur nga shtetasi F.K; vendim pushimi për procedimin penal nr. ***, datë 17.12.2007; korrespondencë me Prokurorinë e Përgjithshme; urdhër regjistrimi procedimi penal nr. ***, viti 2018; vendim për bashkimin e procedimeve penale, datë 25.7.2018; shkresë nr. ***, datë 15.11.2023, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, bashkëlidhur së cilës janë edhe vendimet nr. ***, datë 9.12.2008, nr. ***, datë 18.5.2007, nr. ***, datë 17.4.2008 dhe nr. ***, datë 22.9.2006, të kësaj Gjykate, lidhur me vendimmarrje për këtë procedim penal; shkresën nr. ***, datë 17.11.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, sipas së cilës kërkesa e paraqitur nga ana e organit të akuzës për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. *** të vitit 2018 është ende në gjykim.

verifikuara. Vendimet që kishin marrë prokurorët e mëparshëm, ishin kontrolluar nga gjykata dhe ishin gjetur të drejta. Po kështu, kjo vendimmarrje bazohet në vendimet përkatëse të Prokurorisë, Gjykatës së Faktit dhe Gjykatës së Apelit, të cilat i kishin dhënë rrugë ligjore për sa pretendohet nga kallëzuesi. Megjithatë, për sa kohë gjykata urdhëroi kryerjen e veprimeve hetimore, është regjistruar procedim penal dhe janë kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga Gjykata. Në përfundim të hetimeve nuk ka rezultuar konsumim i elementeve të ndonjë vepre penale dhe është vendosur pushimi i çështjes. Ndaj vendimit të pushimit F.K ka bërë ankim në gjykatë dhe ka hequr dorë nga ankimi.

50.28 Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Elbasan në datën 6.1.2009 ka marrë vendim për shfuqizimin e vendimit të pushimit datë 17.12.2007, me argumentin se shtetasi F.K ka paraqitur pretendime, duke kërkuar kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, depozituar kjo kërkesë në Prokurorinë e Rrethit Elbasan me nr. *** prot., datë 18.12.2008. Pra, shtetasi F.K ka pretenduar për të dhëna shtesë. Hetimet janë ndjekur nga prokuror dhe oficer tjetër, ku përfundimi ka qenë i njëjtë, pushimi i çështjes penale, pasi nuk kishte elemente të ndonjë vepre penale.

50.29 Në përfundim, subjekti ka shpjeguar se argumentet e mësipërme tregojnë që vendimmarrja e saj ka qenë e drejtë dhe se ka vepruar plotësisht në përputhje me nenin 72, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016.

50.30 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, në raport me ligjin e zbatueshëm në këtë çështje objekt shqyrtimi arsyeton si vijon:

50.31 Nisur nga rrethanat konkrete të kësaj çështjeje, në raport me shpjegimet e subjektit, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka kryer hetime të plota në drejtim të faktit të kallëzuar, për më tepër që i ka disponuar të dhënat mbi të cilat duhej të bënte hetime, konkretisht zarfin ku ndodhej prokura, i cili mbante mbishkrimin datë 29.10.2004, ku përkthimi në gjuhën shqipe datonte në shkurt 2002, çka do të thotë se subjekti duhet të kishte hetuar mbi faktin se si u krye përkthimi i një dokumenti në kohën kur zarfi nuk kishte mbërritur ende. Moskryerja e këtij veprimi hetimor, sipas vlerësimit të trupit gjykues, mënyra jo e saktë e vlerësimit të fakteve dhe provave, bien ndesh me kriteret e parashikuara për vlerësimin e aftësisë profesionale, parashikuar në nenin 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

50.32 Ndërsa, lidhur me shfuqizimin e vendimit të pushimit të subjektit, Komisioni duke konstatuar se referuar aktit të drejtuesit të prokurorisë evidentohet paraqitja e fakteve të reja nga kallëzuesi, i çmon bindëse shpjegimet e subjektit për këtë çështje, duke mos konkluduar në ndonjë problematikë.

Të dhëna të tjera nga aksesimi në media¹²⁸

51. Nga të dhënat në median e shkruar, ish-Kryeministri S.B, bazuar në informacionin e mbërritur në adresë të tij, ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për lirimin e shtetasit SH.H pas arrestimit të tij, e ndikuar nga ndërhyrja e dhëndrit të kreut të Bashkisë së Elbasanit (Q.S).

51.1 Lajmi në media pasqyron faktin se shtetasi SH.H është një person i dyshuar si atentator i shtetasit F.Ç dhe është arrestuar nga Policia e Elbasanit më 22.6.2016 për drejtim të motorit pa lejedrejtim.

51.2 Komisioni administroi kopje të fashikullit penal¹²⁹, ku nga aktet e administruara vërejtë se kjo çështje është hetuar nga një tjetër subjekt rivlerësimi. Çështja i përket procedimit penal nr. *** në

¹²⁸ https://www.c***

¹²⁹ Me shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, nr. *** prot., datë 22.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

ngarkim të të dyshuarit SH.H, akuzuar për veprën penale “Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Gjetje e vëzhguesit ndërkombëtar

52. Lidhur me çështjen penale që i përket procedimit penal nr. ***, pas pranimit nga Komisioni të gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar me nr. *** prot., datë 20.2.2024¹³⁰, Komisioni konstaton rrethanat ku bazohet gjetja, të cilat referojnë të dhëna si më poshtë:

52.1 Çështja penale që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar ndaj të pandehurit A.B, akuzuar për veprën penale “Vjedhja”, bazuar në nenin 134/2 të Kodit Penal, hetuar nga subjekti i rivlerësimit, ka rezultuar nga një denoncim¹³¹ i mbërritur në Komision nga avokate S.S.

52.2 Denoncimi është bërë nga avokatja e të pandehurit të arrestuar, me pretendimin se ajo (avokatja) nuk është lejuar nga efektivet e policisë të takojë klientin e saj në ambientet e paraburgimit të Komisarariatit të Elbasanit. Punonjësit e policisë e kanë penguar avokaten të takohet me klientin e saj, pasi sipas tyre është dashur të ketë një autorizim nga prokurori përkatës i çështjes.

52.3 Vëzhguesi ndërkombëtar pas marrjes së dosjes përkatëse¹³², të cilën e ka bashkëngjitur me materialin e përcjellë, bazuar në informacionin e përmbajtur, ka paraqitur këtë gjetje/konstatim për kryerjen e një vlerësimi sa më të plotë, gjithëpërfshirës, objektiv dhe në kohë, të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

52.4 Gjetja synon gjithashtu mbrojtjen e të drejtave, parimeve dhe vlerave kushtetuese, të cilat janë thelbësore në procesin e rivlerësimit kalimtar.

52.5 Në mendimin e tij, vëzhguesi ndërkombëtar ka konfirmuar se Komisioni duhet të vlerësojë nëse veprimet e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të procedimit penal nr. ***, janë zbatuar në përputhje me dispozitat e procedurës penale dhe në përputhje me të drejtat/mbrojtjen, të njohura për të pandehurin/shtetasin e arrestuar/kategoritë e tjera të ngjashme procedurale, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe rrethanat specifike të çështjes.

Rrethanat e çështjes

52.6 Subjekti i rivlerësimit ka hetuar një rast vjedhjeje (neni 134/2 i Kodit Penal), pas kallëzimit penal në datën 26.11.2017 ndaj personit të dyshuar A.B nga z. T, pronar i një dyqani.

52.7 Z. T ka pretenduar se z. B i ka vjedhur dy palë gërshtë brenda tri javëve të fundit (nga data 6-26 nëntor 2017). Ngjarjet janë regjistruar edhe nga kamerat e sigurisë. Në të njëjtën ditë të kallëzimit penal, policia e gjeti z. B rrugës për në shtëpi. Z. B mbante në xhep një palë gërshtë të ngjashme me ato të raportuara si të vjedhura. Në shtëpinë e tij iu gjetën edhe një palë gërshtë të tjera.

52.8 Në të njëjtën ditë të regjistrimit të kallëzimit penal, OPGJ-ja ka kryer disa veprime hetimore, duke përfshirë lëshimin e urdhrat të shërbimit, kallëzimin e arrestit në flagrancë, kontrollin në banesën e të dyshuarit, sekuestrimin e gërshtëve të gjetura në shtëpi, sekuestrimin e gërshtëve të gjetura në xhep, sekuestrimin e kamerave të sigurisë, fotografitë, marrjen në pyetje të të dyshuarit (i cili ka pranuar gjithçka). Në të njëjtën ditë, subjekti i rivlerësimit i ka caktuar të dyshuarit një avokat mbrojtës *ex officio* (kryesisht) nga Prokuroria sipas detyrës zyrtare. Ndër disa veprime hetimore të kryera më 26.11.2017 citohen:

¹³⁰ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.2.2024.

¹³¹ Nr. *** prot., datë 28.5.2018, administruar në dosjen e Komisionit.

¹³² Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2024, të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, administruar në dosjen e Komisionit.

52.9 Procesverbali për kontrollin e shtëpisë së z. B (12:20 – 13:00). Nga përmbajtja e procesverbalit thuhet se ai është ndërmarrë me iniciativën e OPGJ-së, në një rast *kapjeje në flagrancë (flagrante delicto)*. *Procesverbali nuk përmbante asnjë shpjegim/justifikim nëse ky kontroll është bazuar në vendim të prokurorit/gjyqtarit apo shkaku për një emergjencë të tillë, që justifikon iniciativën e OPGJ-së.* Në procesverbal ndodhet edhe një deklaratë e shkruar me dorë nga i pandehuri se nuk kishte nevojë për një avokat mbrojtës gjatë kontrollit në ambientet e shtëpisë së tij. Në përmbajtje përfshihet gjithashtu edhe një deklaratë me shkrim dore se *gërshërët e gjetura janë blerë disa javë më parë...* Procesverbali është firmosur nga z. B, babai i tij dhe 4 punonjës policie.

52.10 Procesverbali për sekuestrimin e gërshërëve dhe regjistrimet video (ora 16:30), firmosur nga OPGJ-ja dhe z. B. Në përmbajtje është përfshirë një fjali që lexon si vijon: *“Këto gërshërë i vodha sot në dyqanin... në Elbasan”*.

52.11 Vendimi i subjektit të rivlerësimit (nuk shënohet data/koha) për caktimin e një avokati mbrojtës kryesisht *ex officio*, pasi z. B do të merrej në pyetje nga OPGJ-ja në cilësinë e personit ndaj të cilit po zhvillohet hetimi, siç parashikohet në nenin 296 të Kodit të Procedurës Penale.

52.12 Procesverbali i OPGJ-së (ora 17:00) për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit po zhvillohet hetimi, i nënshkruar nga avokati mbrojtës i caktuar *ex officio*, vetë z. B dhe OPGJ-ja. Sipas përmbajtjes së këtij dokumenti, OPGJ-ja i ka shpjeguar z. B të drejtën e heshtjes, arsyet pse po merrej në pyetje, të dhënat ndaj tij, kartën e të drejtave të të pandehurit. OPGJ-ja ka pyetur *“...Ju akuzoheni për vjedhje...”*. Z. B e ka pranuar se ishte i informuar për të drejtat e tij, ishte njohur me arsyet *pse akuzohej* në prani të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe ka pranuar veprën penale në dy raste. Procesverbali është nënshkruar nga avokati i tij i caktuar *kryesisht* pa kundërshtime. Duhet theksuar se në dosje nuk ka asnjë procesverbal që vërteton zgjedhjen e z. B për t’iu caktuar një avokat kryesisht dhe jo sipas zgjedhjes së tij personale për një avokat mbrojtës siç e kërkon ligji.

52.13 Procesverbal (ora 19:30) për arrestimin në flagrancë, firmosur nga z. B dhe OPGJ-ja. Sipas këtij dokumenti, OPGJ-ja ka njoftuar të arrestuarin se në bazë të nenit 255 të Kodit të Procedurës Penale, ai kishte të drejtë të zgjidhte një avokat, të heshtte dhe, çfarëdo që do të deklaronte, do të përdorej kundër tij në gjykim. Me pëlqimin e të arrestuarit, OPGJ-ja ka njoftuar familjarët për arrestimin. Ky dokument përmbante edhe alternativën që i arrestuari të zgjidhte vetë një avokat mbrojtës ose, në të kundërt, mund t’i caktohej një avokat kryesisht. Vlen të theksohet se njoftimi i z. B për mundësinë e zgjedhjes vetë të një avokati mbrojtës është bërë pas marrjes në pyetje të tij si nën akuzë nga OPGJ-ja. Kjo është me rëndësi të theksohet, pasi përgjigjet ndaj OPGJ-së në këtë seancë marrjeje në pyetje në këtë datë përbëjnë bazën për të gjithë procedimin penal, akuzat dhe përfundimisht dënimin e z. B.

- Më 27.11.2017 janë ndërmarrë disa akte shkresore, të cilat shfaqen me rëndësi për t’u renditur:

52.14 Një raport i OPGJ-së (pa datë të përcaktuar) për çështjen penale dhe rrethanat e çështjes, referuar marrjes në pyetje të z. B dhe rezultatit përkatës. *Ky dokument nuk përmban asnjë referencë për praninë e një avokati mbrojtës ose për një zgjedhje nga B të një avokati të pandehur ose, alternativisht, për një kërkesë të OPGJ-së drejtuar subjektit tonë të rivlerësimit për të caktuar një avokat kryesisht për të, sipas kërkesave ligjore të neneve 255, 256, 296 e 34/a të Kodit të Procedurës Penale.*

52.15 Urdhri i subjektit të rivlerësimit (nuk ka datë) për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, si dhe emri i B si *person të cilit i atribuohet vepra penale (në hapje të urdhrit)*, si dhe nën hetim, në pjesën vendimmarrëse. Përmbajtja e urdhrit referon kryesisht kallëzimin penal të OPGJ-së për

veprimet/hapat e ndërmarrë një ditë më parë, veçanërisht në lidhje me marrjen në pyetje të të dyshuarit. Theksohet se subjekti i rivlerësimit i referohet shtetasit të dyshuar si të pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit po kryhet hetimi, duke anashkaluar kualifikimin e tij si i akuzuar të përdorur nga OPGJ-ja gjatë marrjes në pyetje. Subjekti i rivlerësimit i referohet edhe pranisë së avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht gjatë marrjes në pyetje.

Urdhri i prokurorit (subjektit të rivlerësimit) për të vërtetuar kontrollin në shtëpi (ora 21:00). Subjekti i rivlerësimit i referohet përputhshmërisë nga OPGJ-ja me nenin 298/1/2 të Kodit të Procedurës Penale. *Subjekti i rivlerësimit nuk bën asnjë referencë se si mungesa e ndonjë specifikimi nga ana e OPGJ-së, nëse gërshërët do të humbisnin ose zhdukeshin, apo për urgjencën e kontrollit në shtëpi pa një urdhër specifik për ta bërë këtë, janë në përputhje me kërkesat e nenit 298/1/2 të Kodit të Procedurës Penale.*

52.16 Caktimi i një avokati mbrojtës nga familjarët e të arrestuarit. Avokatja e caktuar nga familjarët ka tentuar të kontaktojë me B në të njëjtën ditë, por në mënyrë arbitrare nuk është lejuar nga punonjësit e policisë, me arsyetimin se i arrestuari ka takuar tashmë një avokat të pandehur dhe se për këtë i është dashur autorizimi nga prokurori i çështjes.

52.17 Në datën 28.11.2017 janë ndërmarrë disa akte të rëndësishme për ngjarjen objekt hetimi, të cilat renditen në vijim:

- i) Një procesverbal i marrjes në pyetje të z. B nga subjekti i rivlerësimit, në prani të avokatit të zgjedhur prej tij, duke përfshirë deklaratën e shkurtër të shkruar me dorë të z. B që pranon krimin.
- ii) Njoftimi i akuzës kryesisht bazuar në raportin e OPGJ-së, datë 26.11.2017.
- iii) Karta e të drejtave të të pandehurit/personit të arrestuar, siç parashikohet nga neni 34/a i Kodit Penal.
- iv) Përfundimi i hetimeve. Për t'u theksuar, ky dokument duket se përfaqëson vetëm një *copy paste* (përsëritje) të raportit të OPGJ-së të datës 27.11.2017, drejtuar subjektit të rivlerësimit për ngjarjet e datës 26.11.2017, përfshirë marrjen në pyetje të z. B dhe rezultatin përkatës.
- v) Kërkesa drejtuar gjykatës për të vërtetuar arrestin në flagrancë të këtij shtetasi, për të caktuar masën e sigurisë “Arrest me burg” dhe për gjykimin e menjëhershëm të çështjes.

Analiza e veprimeve të organit të akuzës në kuadër të dispozitave të procedurës penale

52.18 Sa më sipër, kronologjia dhe rëndësia e ngjarjeve dhe veprimeve duket se shfaq një procedurë hetimore shumë të nxituar të OPGJ-së, e kryer e tëra brenda më pak se 24 orëve, ku nuk janë respektuar masat mbrojtëse procedurale për shtetasin e dyshuar. Për shembull, referuar dispozitave ligjore sa më poshtë:

- Neni 255 “Detyrat e OPGJ-së në rast arrestimi ose ndalimi” për të drejtën e heshtjes, të drejtën e zgjedhjes së avokatit mbrojtës.
- Neni 256 “Pyetja e personit të arrestuar/ndaluar” për të drejtën për t'u pyetur në prani të një avokati mbrojtës të zgjedhur nga vetë i pandehuri ose të caktuar kryesisht nga Gjykata, si dhe për faktin se deklaratat e dhëna përpara takimit me avokatin nuk mund të përdoren. Duhet theksuar se në asnjë dokument në dosje nuk rezulton që të ketë pasur një takim paraprak (në seancën e pyetjeve) të avokatit mbrojtës me z. B.
- Neni 296 “Mbledhja e të dhënave nga personi ndaj të cilit kryhet hetimi”, ku kërkohet prania e detyrueshme e avokatit mbrojtës ose zgjedhja paraprake nga i arrestuari i një avokati dhe, vetëm në rast se avokati nuk paraqitet, zgjedhja e një avokati mbrojtës kryesisht nga ana e

organit të akuzës. Duhet theksuar se asnjë akt apo dokument në dosje nuk rezulton të dëshmojë /vërtetojë zgjedhjen e z. B për të pasur një avokat të caktuar kryesisht nga Prokuroria dhe jo atë të zgjedhur prej tij.

- Neni 296 “Për aplikimin e detyrueshëm nga oficeri i policisë gjyqësore (OPGJ) të kërkesave të nenit 34/a dhe nenit 38 të Kodit të Procedurës Penale, gjatë marrjes në pyetje të të arrestuarit”.
- Neni 298 “Kontrolli”, mbi kërkesat që duhen përmbushur gjatë sekuestrimit të artikujve të lidhur me veprën penale, si rreziku që mund të humbasin ose fshihen, ose nevojat specifike urgjente të OPGJ-së.
- Neni 34/a “Të drejtat e të pandehurit/personit nën hetim”, si e drejta për të mos folur/për të heshtur, për t’u mbrojtur ose për t’u përfaqësuar nga një avokat mbrojtës, për të pasur një avokat kryesisht kur nuk mund të sigurohet nga ai vetë, e drejta për t’u takuar privatisht dhe të komunikojë lirshëm me avokatin, të përgatisë në kohë mbrojtjen e tij etj.

52.19 Çështja në fjalë kishte të bënte me veprën penale “Vjedhja” e dy palë gërshërëve me vlerë shumë të parëndësishme monetare (minimale), e cila nuk është vepër e një rëndësie të jashtëzakonshme. I dyshuari e ka pranuar fajin në mënyrë të përsëritur brenda më pak se 24 orëve nga verifikimi i rrethanave nga OPGJ-ja dhe në një procedurë shumë të diskutueshme ligjore. Është gjetur në banesë, është i martuar dhe i papunë. Këto rrethana me logjikë tregojnë se nuk ka pasur rrezik të veçantë ikjeje/arratisjeje, pengimi të hetimeve apo përsëritje të veprës penale nga ana e të dyshuarit, gjë që shtron pyetjen nëse kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal të arrestit me burg, e kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, është e justifikuar ose proporcionale. Në thelb, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar masën e sigurisë “Arrest me burg” - në paraburgim, ndërsa i gjithë rasti ka të bëjë me vjedhjen e dy palë gërshërëve, që përbën një vepër penale mjaft të vogël dhe kjo pa një arsyetim ligjor, logjik dhe të qartë.

52.20 Për sa më sipër analizuar, Komisioni¹³³ i kaloi subjektit barrën e provës, pasi konstatoi se dukej se: (i) nuk kishte përmbushur dhe kundërshtuar dukshëm për të mbrojtur plotësisht të drejtat procedurale të personit të arrestuar, pasi dukej se ishin konsideruar veprimet e dukshme arbitrare të OPGJ-së, të miratuara pa vëzhgim/supervizim; (ii) nuk ishte kryer hetim i plotë, i logjikshëm, i bazuar në prova e ligj, në raport me:

- veprën penale;
- rrezikshmërinë që ajo sjell;
- të dhënat e evidentuara që përfaqësonin të akuzuarin, si fakti që pranoi fajin, veprën penale të vjedhjes së dy palë gërshërëve, me vlerë shumë të parëndësishme monetare (minimale), e cila nuk është vepër e një rëndësie të jashtëzakonshme;
- faktin që i akuzuari ishte i martuar dhe i papunë;
- praninë shumë të kufizuar të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht në një vepër të vetme, madje edhe sipërfaqësore, duke pasur parasysh mënyrën se si avokati u përball me marrjen në pyetje të B. si i pandehur në një moment procedural të destinuar si të tillë, në vend të personit ndaj të cilit po zhvillohet hetimi, ndërkohë që procedimi penal nuk ishte regjistruar ende, madje as emri i B. nuk ishte regjistruar si person nën hetim;
- vonesën e lejuar të avokatit mbrojtës i zgjedhur nga familjarët e të pandehurit që të paraqitej dhe të takonte klientin e tij për të ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve përmes një mbrojtjeje ligjore efektive dhe në kohë.

¹³³ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

52.21 Në qëndrimin e saj, subjekti ka parashtruar se ky procedim penal ka nisur mbi bazën e njoftimit që viktimja E.T ka bërë në sallën operative të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, se po ndjek një person që e ka vjedhur në dyqanin e tij. Salla operative ka njoftuar patrullën e policisë. Patrulla e policisë është vënë në ndjekje të autorit të vjedhjes dhe ka bërë të mundur kapjen e shtetasit A.B. Për këtë fakt është hartuar procesverbali i kapjes në flagrancë dhe, po kështu, është hartuar raporti i shërbimit nga patrulla e policisë, që ka bërë shoqërimin e personave në datën 26.11.2017, akte procedurale këto të hartuara në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale. Sipas subjektit, oficeri i policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan ka kryer veprimet e para hetimore¹³⁴ me iniciativë dhe me shkrësë përcjellëse nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan janë dërguar aktet në Prokurori dhe janë regjistruar në Prokurori me nr. *** prot., datë 27.11.2017. Aktet janë me sigël të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, pasi përdoret modeli i dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme.

52.22 Subjekti ka shpjeguar se veprimet hetimore të kryera me iniciativë nga OPGJ-ja në datën 26.11.2017 kanë qenë: marrja e kallëzimit penal të shtetasit E.T, bazuar në formatin e akteve të miratuara nga Prokuroria e Përgjithshme, duke i njoftuar përgjegjësini penale në rast kallëzimi të rremë; marrja e deklaramit të personit që ka dijeni mbi faktin – E.T, duke i njoftuar përgjegjësini penale në rast deklarimi të rremë; viktimës E.T i është komunikuar letra e të drejtave që ai ka në një proces penal, sikurse garanton neni 58, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale; procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale, datë 26.11.2017; procesverbal për sekuestrimin e provës materiale, datë 26.11.2017; procesverbal i kontrollit të vendeve, datë 26.11.2017; procesverbal për këqyrjen e pamjeve të regjistruara nga kamerat e sigurisë, datë 26.11.2017. Duke qenë se këto veprime hetimore ishin kryer në përputhje me sa garanton Kodi i Procedurës Penale, duke i garantuar të drejtat personit nën hetim, këto akte procedurale brenda afatit ligjor janë vleftësuar si të ligjshme nga ana e prokurorit të çështjes.

52.23 Pasi janë kryer veprimet e para hetimore me iniciativë të OPGJ-së dhe është konstatuar se kemi të bëjmë me vepër penale dhe identifikim të autorit të veprës penale, është bërë referimi tek prokurori i gatshëm. Me qëllim garantimin e të drejtave të personit nën hetim, nga ana e prokurorit është caktuar avokat kryesisht nga lista e avokatëve të gatshëm, për faktin se personi që kishte kryer veprimin e vjedhjes nuk kishte zgjedhur mbrojtës dhe nuk ka pretenduar për mbrojtës të zgjedhur nga familjarët e tij përpara oficerit të policisë gjyqësore.

52.24 Shtetasi A.B në datën 26.11.2017, ora 17:00, është pyetur si person nën hetim në prani të avokatit mbrojtës E.N. Avokati kryesisht në bazë të ligjit “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë”, ka të njëjtat të drejta dhe detyrime nga pikëpamja e përmbushjes së funksionit me profesionalizëm dhe besnikëri, sikurse dhe avokati i zgjedhur nga vetë personi në hetim. Oficeri i policisë gjyqësore tekstualisht shënon në procesverbalin e marrjes së të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime se shtetasi A.B është pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetime, që do të thotë se në momentin e pyetjes ky shtetas nuk ka qenë marrë i pandehur, pasi ndaj tij nuk ka qenë ngritur akuzë.

52.25 Subjekti ka sqaruar se fakti pse OPGJ-ja gabimisht në pyetjen e tij përdor termin “ju akuzoheni”, në vend të termit “ju dyshoheni”, nuk e bën procesverbalin e deklaramit të pavlefshëm si akt. Pavlefshmëria e akteve parashikohet në nenet 128 dhe 129 të Kodit të Procedurës Penale. Në përmbajtje të procesverbalit të deklaramit parashtrohet sa personi nën hetim ka deklaruar në prani të avokatit mbrojtës, pa pasur asnjë lloj pretendimi në lidhje me mënyrën në të cilën është proceduar gjatë marrjes së deklaramit të tij. Procesverbali është nënshkruar pa asnjë vërejtje.

¹³⁴ Sikurse Kodi i Procedurës Penale parashikon në Kreun IV, nenet 293 e vijues të tij.

52.26 Procesverballi për kontrollin e banesës së shtetasit A.B dokumenton se kontrolli është bërë në orën 12:20, kohë kjo brenda orarit të lejuar sipas nenit 206 të Kodit të Procedurës Penale. Kontrolli është ushtruar në banesën e një personi që ishte në gjendje flagrante, i cili ishte duke u ndjekur nga oficerët e policisë gjyqësore, pasi në trupin e tij kishte sende që tregonin se ai kishte kryer veprën penale të vjedhjes. Po kështu, kontrolli në banesë me iniciativën e policisë gjyqësore ishte i ligjshëm, pasi plotësoheshin kriteret e parashikuara nga neni 202, paragrafi 3, në lidhje me nenin 298 të Kodit të Procedurës Penale. Kishte arsye të bazuara që oficeri i policisë gjyqësore të mendonte se në banesën e A.B gjendeshin sende (gërshtërit e vjedhura 3 javë më parë) të siguruara nëpërmjet kryerjes së veprës penale, të cilat mund të humbisnin apo zhdukeshin, ndaj kjo urgjencë nuk mund të priste nxjerrjen e një vendimi kontrolli. Në përmbajtje të procesverbalit të kontrollit shënohet qartë se kontrolli është bërë bazuar në nenin 298 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë në gjendje flagrante, pra OPGJ-ja ka vepruar me iniciativë. Gjatë kontrollit të banesës, shtetasi A.B ka pasur njeri të besuar, babain e tij K.B (sipas nenit 205/1 të Kodit të Procedurës Penale). Shtetasi A.B nuk ka kërkuar praninë e ndonjë mbrojtësi (neni 205/2 i Kodit të Procedurës Penale).

52.27 Sipas subjektit, nëse nuk do të ushtrohej kontrolli urgjentisht, gërshtërit e vjedhura tri javë më parë rrezikonin të fshiheshin nga familjarët e A.B, ndaj policia gjyqësore ka ushtruar kontroll me urgjencë, pa i lënë mundësinë e marrjes dijeni mbi këtë fakt të tretëve dhe për të parandaluar fshehjen apo humbjen e provës materiale. Vendimi për caktimin e avokatit mbrojtës mban datën 26.11.2017, fakt që e provon akti përkatës që gjendet në dosje.

52.28 Në momentin e marrjes në pyetje si person nën hetim, shtetasit A.B i është garantuar prania e mbrojtjes, sikurse kërkon neni 296 në lidhje me nenin 256 të Kodit të Procedurës Penale. Nuk hartohet një procesverbal i veçantë në lidhje me dokumentimin e faktit nëse personi nën hetim do të mbrohet nga një avokat i zgjedhur prej tij ose familjarët e tij, apo nga avokat i caktuar kryesisht nga shteti. Nëse personi nën hetim nuk pranon të japë deklaratime në prani të një avokati të caktuar nga shteti dhe kërkon praninë e një avokati të zgjedhur prej tij, ky fakt përshkruhet në përmbajtje të procesverbalit të deklaramit të tij. Në rastin konkret, shtetasi A.B ka konfirmuar se është njohur me letrën e të drejtave dhe ka pranuar të japë deklaramit në prani të avokatit të caktuar nga shteti dhe nuk ka kërkuar prezencën e ndonjë avokati të sugjeruar prej tij apo familjare të tij.

52.29 Njoftimi i shtetasit A.B për mundësinë e zgjedhjes vetë të një avokati mbrojtës dhe që ka të drejtën e heshtjes, i është njoftuar që në momentet e shoqërimit dhe këtë fakt e provon edhe nënshkrimi i tij në deklaratën për njohjen me të drejtat e personit nën hetim. Në procesverbalin e pyetjes si person nën hetim, shtetasit A.B i është njohur letra e të drejtave të tij, në përmbajtje të së cilës shënohet tekstualisht edhe e drejta për të zgjedhur një mbrojtës.

52.30 Referimi i OPGJ-së nuk është akt që shërben si provë në procesin penal, por akt administrativ për referimin e materialit në Prokurori. Edhe ky akt mban numrin e protokollit dhe datën kur është dorëzuar në prokurori. Në përmbajtje të tij përshkruhen të gjitha veprimet hetimore dhe aktet procedurale të prodhuara prej tyre, që i bashkëlidhen këtij referimi. Urdhri i prokurorit për regjistrimin e procedimit penal nr. *** ka të shënuar datën e përpilimit të tij, si dhe emri i shtetasit A.B si person nën hetim shënohet në pjesën vendimmarrëse, me qëllim shënimin e emrit të tij në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Subjekti ka depozituar fletën nga regjistri i regjistrimit të veprave penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ku janë shënimet përkatëse lidhur me procedimin penal nr. *** të vitit 2017.

52.31 Subjekti ka parashtruar se avokati i zgjedhur nga familjarët është paraqitur, pasi shtetasi A.B ishte vendosur në dhomat e paraburgimit në Komisaratin e Policisë Elbasan, pra pasi ishin kryer veprimet e para procedurale dhe ishte hartuar procesverballi i arrestimit në flagrancë. Këtë fakt e

provon më së miri pretendimi i avokates S.S, që pretendon se nuk është lejuar të takojë klientin e saj nga përgjegjësi i dhomave të paraburgimit dhe jo nga oficeri i policisë gjyqësore, pasi ky i fundit i kishte mbaruar veprimet procedurale. Në datën 28.11.2017, kur është vijuar kryerja e veprimeve hetimore me shtetasin A.B, ai është mbrojtur nga avokati që i kanë zgjedhur familjarët e tij, duke iu garantuar në këtë mënyrë një e drejtë absolute, efektive për t'u mbrojtur, si dhe duke iu garantuar një proces i rregullt ligjor. Subjekti ka depozituar dokumentin “Deklaratë e të drejtave të personit nën hetim”, gjendur edhe në faqen 55 të fashikullit hetimor.

52.32 Lidhur me konstatimin e Komisionit se çështja në fjalë kishte të bënte me veprën penale “Vjedhja” të dy palë gërshërëve, me vlerë shumë të parëndësishme monetare, e cila nuk është vepër e një rëndësie të jashtëzakonshme, subjekti ka shpjeguar se në këtë rast autori tregon për një shkallë të lartë rrezikshmërie, i cili ka pranuar fajësinë, pasi ka qenë i detyruar nisur nga fakti që kishte të bënte me pamje të regjistruara nga kamerat e sigurisë, pasi në momentin e konstatimit të faktit, fillimisht për vjedhjen e parë, ka tentuar ta mohojë, pra në këtë rast kemi të bëjmë me vjedhje të hapur dhe në mënyrë të përsëritur, duke thënë se i ka blerë gërshërët. Subjekti ka shpjeguar se shtetasi A.B nuk është pyetur si i pandehur apo si i akuzuar në datën 26.11.2017, por si person nën hetim dhe kjo del nga tërësia e përmbajtjes së aktit. Një frazë e vetme nuk ndikon në tërë aktin, pasi në formatin dhe në përmbajtjen e tij ky akt vërteton pyetjen si person nën hetim, në prani të avokatit mbrojtës.

52.33 Nga ana e Prokurorisë është vlerësuar drejt rrezikshmëria e veprës, referuar marzheve të dënimit të parashikuar për veprën penale të konsumuar, si dhe rrezikshmëria e personit, ku kishim të bënim me një person që kryente një vepër penale në mënyrë të përsëritur, duke vepruar me paramendim, në dëm të të njëjtit person. Subjekti ka depozituar statistika të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ku kjo masë sigurimi “Arrest në burg” është kërkuar në rastet kur kemi të bëjmë me konsumimin e kësaj vepre penale.

52.34 Sipas subjektit, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, e kërkuar nga prokurori, është e justifikuar dhe proporcionale me veprën penale të konsumuar, të konfirmuar edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

52.35 Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, në analizë të rrethanave konkrete të saj dhe pretendimeve të subjektit, vlerëson se subjekti ka miratuar procedurën hetimore të ndërmarrë nga OPGJ-ja pa verifikuar e mbikëqyrur të dhënat e konstatuara, pasi vihet re se në procesverbalin e arrestimit të z. B në flagrancë nuk rezulton asnjë procesverbal që vërteton zgjedhjen e tij për t'iu caktuar një avokat kryesisht dhe jo sipas zgjedhjes së tij personale për një avokat mbrojtës, siç e kërkon ligji. Nga të dhënat e dosjes rezulton se këtij të akuzuari në të shumtën e rasteve i është marrë nënshkrimi pa u dokumentuar vullneti/zgjedhja e tij për të drejtat e tij në letrën e drejtave të pandehurit e, për rrjedhojë, duket se nga ana e subjektit nuk janë respektuar masat mbrojtëse procedurale për shtetasin e dyshuar.

52.36 Në analizë të çështjes konkrete, trupi gjykues konstaton se subjekti në caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” u është referuar përgjithësisht dispozitave të procedurës penale (neneve 228-230 të Kodit të Procedurës Penale), ndërkohë që nuk është mbajtur në konsideratë faktet që i akuzuari ishte i papunë, i padënuar më parë, rrezikshmëria e veprës penale, marrëdhënia shoqërore që ajo ka ndikuar, pasojat e ardhura prej kryerjes së saj, raporti/shkaqet e lidhura me veprimet e të dyshuarit, rreziku që autori mund të arratiset, i cili duhet thënë se pranoi fajësinë. Në vlerësimin e trupit gjykues, përmbushja e kushteve dhe kritereve në caktimin e masave të sigurimit në këtë rast duhej të përcaktohej nga vlerësimi objektiv i fakteve dhe rrethanave konkrete të çështjes, në harmoni dhe të udhëhequra nga parimet e sundimit të ligjit, sigurisë juridike,

proporcionalitetit, si dhe duke respektuar të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane¹³⁵.

53. Trupi gjykues çmon se konstatimet mbi këtë procedim penal duket se dëshmojnë mangësi domethënëse në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, e konkretisht si në mbikëqyrjen e punës së OPGJ-së, në ndërtimin e hetimit, si dhe në analizën dhe arsyetimin logjik (të prokurores) mbi aplikimin e masës së sigurimit, në raport me respektimin e parimeve juridike dhe të drejtave themelore të njeriut, që cenojnë në këtë mënyrë indikatorë të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, duke i vlerësuar ato në referencë të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Konkluzionet e trupit gjykues

a. Lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues çmon se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, të cilat janë çmuar në vlerësimin tërësor të procesit për këtë subjekt.

b. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se ndonëse subjekti mund të arrijë në një nivelin (minimal) kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, problematikat e konstatuara në këtë kriter, janë çmuar në vlerësimin tërësor të procesit për këtë subjekt.

ç. Nisur nga sa më sipër, lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues vlerëson se duke marrë në konsideratë problematikat lidhur me kriterin e pasurisë, si dhe mangësitë e evidentuara në vlerësimin e aftësisë profesionale dhe denoncimet nga publiku, si më lart janë arsyetuar, subjekti i rivlerësimit ka cenuar me sjelljen e saj besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se numri më i madh i problematikave të evidentuara e analizuara në këtë vendim janë nga ankesat dhe/ose denoncimet e publikut, ku pesha e mangësive në vlerësimin tërësor të subjektit është e tillë që e bën të pamundur riparimin e tyre nëpërmjet programit të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës dhe, si rrjedhojë, konkludoi se vazhdimi i ushtrimit prej saj të funksionit të prokurores do të ishte jo në përputhje me qëllimin dhe parashikimet e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe, për pasojë, ato çmohen në zbatim të nenit 61, pika 5 dhe pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 84/17, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në bazë të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Pranvera Stafa (Selita), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

¹³⁵ Shihni vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Simons v. Belgium, 2012, paragrafi 32.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 8.3.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka